



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Librazhd

**RAPORT PËRFUNDIMTAR
PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË
PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË
BASHKINË LIBRAZHD**

TIRANË, GUSHT 2023

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtime	1-3
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.	Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit	4-10
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionin e auditimit	
II.	HYRJA	
1.	Objekti i auditimit	11-13
2.	Qëllimi i auditimit	
3.	Identifikimi i çështjes	
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
5.	Përgjegjësitë e audituesve	
6.	Kriteret e vlerësimit	
7.	Standardet e auditimit	
8.	Metodat e auditimit	
9.	Dokumentimi i auditimit	
	III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
	-Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	14-14
	-Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit:	
1.	Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	14-25
	2.1-2.5 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	25-38
	2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre. Auditim mbi administrimin e aseteve	38-53
	3. Vlerësimi i raportimit financiar	53-68
	4.1- 4.3. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.	68-114
	4.4. Mbi zbatimin e kontratave të punëve dhe shërbimeve publike	114-118
	5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit	119-121
	6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)	121-124
	7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	124-143
	IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	144-157

Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NjA	Njësi Administrative.
ShA	Shoqëri Anonime.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.
TVSh	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.316/1, datë 18.04.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 19.04.2023 deri në datën 26.05.2023, në Institucionin Bashkia Librazhd u krye auditimi “Financiar dhe i Përputhshmërisë”.

Auditimi financiar mbuloi periudhën prej datës 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022.

Auditimi i përputhshmërisë mbuloi periudhën prej datës 01.01.2022 deri në datën 30.04.2023.

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, zbatimi i kontratave të punimeve, lejet e ndërtimit, aktiviteti i IMT, zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditime mëparshëm.

Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohej), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshti për aktet e konstatimit, por jo për projektraportin e auditimit. Subjekti nuk ka konfirmuar me shkresë për njohjen me projektraportin dhe nuk ka treguar interes për të zhvilluar takim përmbyllës në KLSH, për diskutimin mbi rezultatet e auditimit.

2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Librazhd nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim. Sektori i burimeve njerëzore nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit.</p> <p>Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurma e auditimit dhe rregullorja për parandalimin e konflikteve të interesit.</p> <p>Nuk është hartuar regjistër i rrishtit, duke mos marrë masa për evidentimin e rrishtit që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre.</p> <p>Nuk është hartuar Kodin e Etikës, duke mos pasur një dokument i cili të njihet dhe zbatohet nga institucioni lidhur me etikën e punonjësve në punë.</p>	14-25	E mesëme	<p>Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Librazhd, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve të marrin masa për hartimin e regjistrit të rrishtit të secilës strukturë dhe të gjithë institucionit. Të hartohet gjurma e auditimit për veprimtaritë kryesore të institucionit, kodi etikës rregullorja për parandalimin e konflikteve të interesit.</p> <p>Struktura e Burimeve Njerëzore, të evidentojnë nevojat e stafit për trajnime dhe të hartojë dhe zhvillojë programe trajnimi për ruajtjen dhe ngritjen profesionale të tij.</p>

<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se më datën 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore progresive për periudhën 2011-2022, janë krijuar debitorë në vlerën 96,164,783 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e planifikuar, por e pa arkëtuar nga Bashkia Librazhd. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 27,208,335 lekë nga 74 subjekte debitor të biznesit të madh, detyrimi prej 15,809,650 lekë nga 303 subjekte debitor të biznesit të vogël, detyrimi prej 3,924,422 lekë nga 96 ndërtesa social ekonomike, detyrimi prej 10,260,919 lekë nga 283 raste për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara, detyrimi prej 38,961,457 lekë nga taksapaguesit familjar.</p> <p>Vetëm për vitin 2022, vlera e detyrimeve të pa arkëtuar për taksat dhe tarifatat vendore është 29,754,569 lekë, ose 31% e totalit të detyrimeve progresive. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 18,646,196 lekë nga 46 subjekte debitor të biznesit të madh, detyrimi prej 3,594,774 lekë, nga 175 subjekte debitor të biznesit të vogël, detyrimi prej 1,948,955 lekë nga 92 ndërtesa social ekonomike, detyrimi prej 2,011,853 lekë nga 49 raste për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara, detyrimi prej 3,552,791 lekë nga taksapaguesit familjar. Ndaj subjekteve debitorë për asnjë rast nuk është zbatuar pika 2 e nenit 89, e ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave nuk është kërkuar kallëzim penal ndaj subjekteve problematike debitorë ndër vite dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.</p>	<p>38-53</p>	<p>E lartë</p>	<p>Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjek të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën 96,164,783 lekë, nga debitorët e privat dhe familjar.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të zërave të shpenzimeve të buxhetit për vitin 2022 u konstatuan diferenca midis vlerës së planifikuar dhe asaj të realizuar. Zërat e shpenzimeve buxhetore janë realizuar në vlerën 1,163,563 mijë lekë nga 1,399,989 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 83%.</p> <p>Peshën kryesore specifike në këtë mosrealizim e ka zëri 230-231 “Shpenzime për investime”, i cili është realizuar në masën 50%, i cili ka ardhur nga mos realizimi dhe finalizimi me kontratë i 11 projekteve të planifikuara, si dhe nga mos prokurimi i fondeve për 16 projekteve të tjera të planifikuara. Këto investime kanë kaluar për</p>	<p>25-38</p>	<p>E mesme</p>	<p>Rekomandim: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues, të marrin masa që gjatë hartimit dhe zbatimit të buxhetit për zërat e shpenzimeve, realizimi i shpenzimeve buxhetore të bëhet në përputhje me planifikimin e hartuar. Për kontratat e investimeve publike, të realizohet zhvillimi i procedurës, lidhja e kontratave dhe zbatimi i tyre në kohë, duke eliminuar vonesat të cilat sjellin mos realizimin e fondeve publike të planifikuara</p>

	realizim dhe financim me fonde të trashëguara në vitin 2023, me përjashtim të 4 projekteve jo prioritare dhe kalimi i fondeve të tyre për financimin e 1 investimi në rrugë rurale			
	Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,662,464 lekë, por për këtë llogari nuk ka analizë të detajuar se cilat janë aktivet që përfaqëson kjo llogari. Mungesa e analizës për vlerën 4,662,464 lekë ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale.	53-68	E mesme	Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar Kryetari i Bashkisë Librazhd të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 211 “Pyje, Plantacione”. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nëpërmjetë dokumentacionit të financiar të trashëguar, të nxjerrë të dhënat e nevojshme për aktivet e hyra e veprimet me to për llogarinë 211 “Pyje, Plantacione” në vite, për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerën e paraqitur në PF për këtë llogari.
	Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 26 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022 – 30.04.2023 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 21 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator, si mos argumentim i kriterit, mos lidhje e ngushtë e kriterit me natyrën dhe vlerën e kontratës, etj.,	68-114	E lartë	Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Librazhd, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publike, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.
	Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 26 procedurave të prokurimit publik të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022 – 30.04.2023, në 18 raste kualifikim i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pavarësisht se në përgjithësi është kualifikuar dhe lidhur kontratë me ofertën ekonomikisht më të favorshme, pra me vlerë më të ulët.	68-114	E lartë	Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Librazhd, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të kualifikimit të operatorëve ekonomik, në kushtet e mos plotësimit të kriterëve, edhe në rastet e ofertave me vlerën më të ulët.
	Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se punonjësit e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, për periudhën objekt auditimi ka funksionuar me punonjës të cilët nuk plotësojnë kriteret lidhur me formimin arsimor. Nga auditimi i vepritarisë së kësaj strukture u konstatua se në 3 raste nuk është aplikuar masa administrative dënim me gjobë për subjektet kundërvajtëse, si dhe nuk janë nxjerrë aktet e pezullimit. Në 4 raste mungojnë vendimet e prishjes për ndërtimet pa leje. Nuk disponohet	121-124	E mesme	Rekomandim: Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Librazhd, të marrë masa që rastet për nxjerrjen e vendimeve të gjobave për të gjitha rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje, ose në shkelje të lejes, të kryhet pezullimi i punimeve me aktin përkatës si dhe të nxirren vendimet për prishjen e tyre. Rekomandim: IMT të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse,

<p>asnjë akt kontrolli për objektet e ndërtuara me leje ndërtimi dhe mungon korrespondenca me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Kryeinspektori nuk ka miratuar plane mujore dhe vjetore të punës, nuk administrohen dosje për praktikantët e ndjekura nga IMT, si dhe nuk dokumentohen me foto praktikantët e mbajtura. Lidhur me gjobat e vendosura nga IMT për vitin 2022, rezultoi se asnjëra prej tyre nuk është arkëtuar dhe njëkohësisht nuk është bërë asnjë kërkesë në gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv</p>			<p>me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, si dhe të përgatitet në mënyrë periodike çdo 3 muaj informacioni drejtuar IKMT.</p> <p>Rekomandim: IMT Bashkia Librazhd, të hapë dosje individuale për secilën procedurë, duke shmangur praktikën e mbajtjes së dokumenteve nëpër blloqe dhe të dokumentojë në çdo rast praktikën e kontrollit apo kundërvajtjes me foto të situatës së konstatuar.</p> <p>Rekomandim: Kryeinspektori i IMT në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për hartimin e kërkesave drejtuar Gjykatës për kthimin e gjitha gjobave në titull ekzekutiv për të shmangur kalimin e afatit dhe parashkrimin e tyre.</p> <p>Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Librazhd, të marrë masa që struktura e IMT të përbëhet nga punonjës të cilët plotësojnë kriteret e formimit arsimor, sipas kërkeave të kuadrit ligjor në fuqi.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Bashkisë Librazhd ka në administrimin e saj rreth 4379 (katërmijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) pasuri të paluajtshme publike, në pronësi dhe në përdorim për të cilat Sektorit i Menaxhimit të Aseteve nuk ka kryer veprime për regjistrimin e të gjitha pronave dhe pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet; nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të asetëve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Librazhd; nuk ka rakordim me ZVRPP (ASHK) Librazhd, për asetet pronë e ish komunave, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e ish komunave; nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje; nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të asetëve, si dhe nuk është aplikuar në ASHK për regjistrimin e tyre.</p>	<p>47-53</p>	<p>E lartë</p>	<p>Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë masat që me specialistë të fushës të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, si dhe për krijimin e regjistrit të asetëve.</p> <p>Rekomandim: Sektorit i Menaxhimit të Aseteve si dhe Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, të marrë masa dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin duhur për regjistrim në ASHK të asetëve. Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, për periudhën janar-dhjetor 2022 konstatohet se ka lidhur 15 (pesëmbëdhjetë) kontrata për dhënie në përdorim të fondit pyjor me afat 10-vjeçar, për periudhën</p>	<p>47-53</p>	<p>E mesme</p>	<p>Rekomandim: Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit të marrin masa që në lidhjen e kontratave për dhënie në përdorim të fondit pyjor, së bashku me sipërfaqen e dhënë</p>

<p>2022-2032, sipas aneksit nr. 2/1 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Parcelat e dhëna me qira nga fondi pyjor e kullosor janë pjesë e listës së pronave të kaluara në pronësi Bashkisë librazhd, por nuk janë të shoqëruara me certifikatën e pronësisë, mungon plan rievimi, i cili përgatitur nga topograf i licensuar. Kontratat janë mjaftuar me një kopje harte nxjerr nga ASIG. Konstatohet se në të gjitha kontratat e lidhura, për distancën nga rruga kryesore për të hyrë në sipërfaqen e marr në përdorim, e cila është pjesë e fondit pyjësor/kullosor kombëtar, e administruar nga qiradhënësi dhe do t'i shërbejë qiramarrësit, nuk i nënshtrohet pagimit të detyrimeve për servitut kalimi.</p>		<p>me qira, të tarifohet edhe servituti e kalimit. Asetet e dhëna me qira, të jenë të pajisura me certifikatën e pronësisë.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Sipas kontratës “Ndërtim i Parkut Qendror, Bashkia Librazhd”, janë konstatuar mangësi si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga verifikimi në objekt rezulton se sipas zërit 14.15 “F.V puseta plastike 40 x 40 x 40 cm, kapak të fortë RC 1084+1086”, me çmim preventivi 3,200 lekë/copë, rezulton se pusetat janë furnizuar dhe vendosur me dimensione 30 x 30 x 30 cm. - Nga verifikimi sipas zërit 6.d.5 “F.V pemë dekorative Bli 16-18 cm”, rezulton se janë vendosur pemë me diametër 5 cm. Çmimi i preventivit dhe situacionit përfundimtar për këtë zë është 15,400 lekë/copë. Në kushtet e mos plotësimit të specifikimeve teknike, referenca e çmimit duhet të merrej bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, zëri 3. An164 “F.V fidanë pemë dekorative”, ku paraqitet çmimi 10,704 lekë/copë. Vlera 98,616 lekë [21 copë (15,400 lekë/copë – 10,704 lekë/copë)], është certifikuar më tepër kontraktorit BOE “E SHPK dhe L. K. SHPK”, vlerë e cila përbën dëm ekonomik. - Nga verifikimi sipas zërave 2.d.3, 6. d.3, 13.c.3 “F.V S.” u konstatua se janë vendosur 17 copë, ndërsa janë certifikuar 23 copë. Vlera 144,000 lekë (6 copë x 24,000 lekë/copë), i është certifikuar më tepër Kontraktorit BOE “E SHPK dhe L. K. SHPK” dhe përbën dëm ekonomik. - Nga verifikimi sipas zërave 4.b.5, 6.b.5, 7.d.6 dhe 8.b.5 “Rrafshim betoni me kuarc me ngjyrë”, është certifikuar sasia 1259.6 m² (201 m² + 912 m² + 50 m² + 96.6 m²). Nga verifikimi në objekt, rezulton se është realizuar rrafshim me kuarc me ngjyrë vetëm sipas zërit 8.b.5 (punime për rrugicën qendrore), në sasinë 96.6 m². Vlera 837,360 lekë (1163 m² x 720 lekë/m²), është 	<p>114-118</p>	<p>E mesme Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masa për zbritjen e vlerës 1,079,976 lekë, nga vlera e sigurimit të kontratës kontraktorit BOE “E SHPK dhe L. K. SHPK”, për punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike.</p>

certifikuar më tepër kontraktorit BOE “E SHPK dhe L. K. SHPK” dhe përbën dëm ekonomik.			
--	--	--	--

OPINIONI I AUDITIMIT

3. Konkluzioni dhe opinionit i auditimit

I. Opinionit i auditimit financiar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Librazhd për vitin ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një *opinion të pamodifikuar/pakualifikuar me theksim të çështjes* për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Librazhd, duke arritur në përfundimin se, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Pakualifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (pa anomali materiale), pozitën financiare të njësisë vendore më 31 dhjetor 2022, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes, janë adresuar disa çështje (jo thelbësore), të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes” dhe duhet të jenë në vëmendje të njësisë vendore për sistemin e tyre.

Baza për dhënien e opinionit financiar

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 - Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 - Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare - Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 9,065 mijë lekë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2022 kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh. Për këto arsye kemi dhënë opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në paragrafin e mëposhtëm:

“Theksimi i çështjes”

- Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,662,464 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 4,662,464 lekë. Për këtë gjendje nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës për vlerën 4,662,464 lekë ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale.

- Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 0, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se ka

14 kontrata projektesh që kanë mbetur pa u financuar për vlerën prej 6,221,225 lekë, pavarësisht që kanë përfunduar si punime, por likuidimi është shtrirë në 2-3 vite ushtrimore, për të cilat janë kryer pagesa pjesore sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Kjo vlerë duhet ti përkiste gjendjes debitore llog. 231 “Shpenzime për investime në proces” me datë 31.12.2022.

II. Opinion i auditimit të përputhshmërisë

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Librazhd, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar të përputhshmërisë.

Baza për dhënien e opinionit të përputhshmërisë

Mbi përcaktimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike për kualifikim, ku nga 26 procedura të audituara, në 21 raste janë konstatuar anomali në hartimin e kriterëve të veçanta të DT në procedurat e prokurimit publik, pasi janë vendosur kriterë të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën dhe madhësinë e kontratës, dhe në shpalljen fitues në 18 raste të operatorëve ekonomik jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve për kualifikim, të cilat nën gjykimin e audituesve nuk janë të përhapura. Në dhënien e këtij opinionit, vlerësohet fakti se pavarësisht mos përmbushjes së disa prej kriterëve, nga AK në përgjithësi është synuar kualifikimi dhe lidhja e kontratës me OE që kanë paraqitur ofertat ekonomikisht më të favorshme.

-Në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, konstatohen mangësi që lidhen me taksën e ndikimit në infrastrukturë e cila për 1 objekt është llogaritur gabim në vlerën **1,635,518 lekë**.

-Nuk janë marrë masat e duhura për arkëtimin e debitorëve dhe si rezultat evidentohet një vlerë progresive prej 96,164,783 lekë, nga e cila vlera prej 29,754,569 lekë, ose 31% e totalit të detyrimeve progresive i përket vitit 2022.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë.

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, zhvillimit të procedurave të prokurimeve publike dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Librazhd, mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të jap opinion për këtë.

Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe auditimin e përputhshmërisë për fushat e auditimit dhe, i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të programit të auditimit nr.316/1, datë 18.04.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 19.04.2023 deri në datën 26.05.2023, në Institucionin Bashkia Librazhd u krye auditimi “Financiar dhe i përputhshmërisë”.

Auditimi financiar mbuloi periudhën prej datës 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022.

Auditimi i përputhshmërisë mbuloi periudhën prej datës 01.01.2022 deri në datën 30.04.2023.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. B. M. (Përgjegjës Grupi)
2. I. Sh
3. Sh. H
4. K. H
5. J. G
6. E. V
7. A. T

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazë rrishtu.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit. Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

- Në auditimin e përputhshmërisë objektivi është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, si dhe opinionit mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.

2. Qëllimi i auditimit. Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

- Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit nga subjekti, të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar.

3. Identifikimi i çështjes.

Referuar analizës së rrishtut, në fazën e planifikimit të auditimit, u identifikuan fushat me rrisht të cilat përbëjnë drejtimit e auditimit, të miratuara me programin e auditimit, si më poshtë:

Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për pasqyrat financiare për vitin 2022.

4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).

7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

(Trajtuar në Opinionin mbi auditimin)

5.Përgjegjësitë e audituesve

(Trajtuar në Opinionin mbi auditimin)

6. Kriteret e vlerësimit. Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë vendore që auditohet) dhe kryesisht:

Standardet e Auditimit:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH;
- Manuali i Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve në KLSH;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

Akte ligjore:

- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, etj.
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

Akte nënligjore

- VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”;
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim.

Udhëzime, Urdhra dhe Rregullore:

- Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme” ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";
- Udhëzimi MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisë të vetëqeverisjes vendore” etj.;
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;
- Rregullore e Procedurat të Auditimit në KLSH;
- Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Librazhd, etj.

7.Standardet e auditimit

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI^t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;

- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
- Manuali i zbatimi të rekomandimeve të KLSH;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

8. Metodatat (Procedurat) e auditimit.

Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Audituesit përzgjedhin ato procedura auditimi të cilat sipas gjykimit të tyre profesional janë më të përshtatshme në varësi të rrethanave (ISSAI 300, 3.4.5).

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Duke qenë se thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë, së pari u vlerësua niveli i zbatimit të këtij ligji si dhe funksionimi i 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm nga njësia e audituar, si një prej elementëve kryesorë të vlerësimit të riskut të auditimit.

Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, grupi i auditimit ka kryer intervista verbale, ka kryer teste kontrolli.

Për arsye se në bazë të vlerësimit sistemi i kontrollit të brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur (risku në nivelin mesatar), grupi i auditimit u mbështet më shumë në procedurat thelbësore dhe më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e kontrollit të brendshëm. Siguria e auditimit është marrë më shumë nga procedurat thelbësore, si:

Kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi, intervistomi, raporte dhe informacione, pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm etj.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e auditimit. Janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar.

Bashkia Librazhd është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Bashkisë dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Librazhd.

Bashkia Librazhdi kufizohet në veri me Bashkinë Bulqizë, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me Bashkinë Përrenjas dhe në perëndim me Bashkitë Elbasan dhe Tiranë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Librazhdit.

Sipas Censurit të vitit 2011, Librazhdi ka një popullsi prej 31,892 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 44,181 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 793.36 km². Sipas regjistrimit civil, densiteti i popullsisë është 55.68 banorë/km² sipas ndërsa sipas censurit, densiteti është 40 banorë/km².

Bashkia e re e Librazhdit shtrihet në lindje të Shqipërisë, në një zonë me bimësi të pasur, hapësira të gjera pyjore dhe burime të shumta hidrike. Librazhdi u shpall qytet në vitin 1958 si një qendër e industrisë ushqimore dhe e shfrytëzimit të pyjeve. Parku kombëtar Shebenik-Jabllanicë përbën një ndër pasuritë e rralla natyrore dhe me biodiversitet të larmishëm të bashkisë së Librazhdit.

Kjo bashki përbëhet nga 7 njësi administrative, të cilat janë: Librazhd, Qendër Librazhd, Hotolisht, Lunik, Stërblevë, Polis dhe Orenjë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Librazhdit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 52 fshatra.

PËRSHKRIMI I AUDITIMIT SIPAS PIKAVE TË PROGRAMIT

Pika 1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

1. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

1. Auditimi mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Vepriariteti e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike:

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Vepriariteti e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Librazhd, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i Kontrollit”, “Menaxhimi i Riskut”, “Aktivitetet e Kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, sipas përcaktimit të nenit 19 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve,

aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

1. MJEDISI I KONTROLLIT

Mjedisi i kontrollit është bazë e menaxhimit të fondeve dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm i cili përmban:

1.1. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues:

Bashkia Librazhd ushtron funksionet e veta me Rregulloren e brendshme “*Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe procedurat për zbatimin e kompetencave vendore në administratën dhe njësitë administrative të Bashkisë Librazhd*”, hartimi dhe miratimi i të cilës është mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” neni 9 pika 1/1 germa b, në Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit Bashkiak të çdo viti “*Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe njësisve administrative*” si dhe në Vendimin e Kryetarit “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Librazhd*” të cilat janë paraqitur në pasqyrat **MFK1-MFK7** në anekset bashkëlidhur. Kjo Rregullore është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 20 datë 28.12.2020 dhe nr. 600 prot., datë 28.12.2020, e cila i përket strukturës organizative miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 978 datë 31.12.2021 “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Librazhd për vitin 2022*” me nr. 14 prot., datë 05.01.2022. Ndërsa Këshilli Bashkiak ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve: për vitin 2021 me VKB nr. 93, datë 06.12.2021, me nr. 6496 prot., datë 10.12.2021 “*Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Librazhd për vitin 2022*”. Struktura organizative është konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Konstatim: Bashkia Librazhd nuk ka hartuar Kodin e etikës në kundërshtim me ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “*Për rregullat e etikës në administratën publike*”, Ligjit nr. 139/2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, neni 9, pika 1/1 germa ‘b’, VKM nr. 306 datë 13.06.2000 “*Për disiplinën në shërbimin civil*”;

Konstatim: Bashkia Librazhd nuk ka hartuar “*Rregulloren e posaçme për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike*” në kundërshtim me Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*” i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” neni 9, pika 1/1 germa b, neni 46; Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*” i ndryshuar.

1.2. Politika menaxheriale dhe stili i punës:

Punësimi në Bashkinë Librazhd bëhet në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, Ligjit nr. 152/2013 “*Për nënpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7961 /1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, VKM nr. 243/2015 i ndryshuar me VKM nr. 746/2018 Kreu I pikat 1 dhe 2. Kjo procedurë rregullohet nga Strukturat e Bashkisë Librazhd:

- Drejtoria ligjore dhe burimeve njerëzore është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr. 152/2013 “*Për nënpunësin civil*”, i ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015 i ndryshuar Kreu II;

- Komiteti i Përhershëm i Pranimit në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015 i ndryshuar;

- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pikat e, ë, f dhe g të Ligjit nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”.

Për vitin 2022, Komiteti i Përhershëm i pranimit në Bashkinë Librazhd është ngritur me Urdhrin e Kryetarit nr. 965 datë 28.12.2021 me nr. 6809 prot., datë 28.12.2021, konform VKM

nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr. 746/2018, Kreu III pikat 2 dhe 3.

Struktura përgjegjëse e bashkisë harton në fillim të çdo viti “Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 “Për nënpunësin civil” neni 18 dhe 69, VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, si edhe të atyre me kontratë pune konform Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Librazhd”. Nga verifikimi i dokumentacionit që iu vu në dispozicion grupit të auditimit, rezultoi se për vitin 2022 struktura organizative është miratuar me Vendim të Kryetarit të bashkisë nr. 978 datë 31.12.2021 dhe nr. 14 prot., datë 05.01.2022, gjithashtu është hartuar Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil, i cili bazohet mbi nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor, duke detajuar emërtimin e pozicionit dhe të njësisë përbërëse në strukturë. Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për vitin 2022 në Bashkinë Librazhd është miratuar nga titullari i institucionit me shkresën nr.1931 datë 19.04.2022 Publikimi i vendeve vakante nga ana e Bashkisë Librazhd, bëhet në faqen zyrtare të saj si dhe në, Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, konform Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19, pika 1, 2; VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” pika 13; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar Kreu II, pika 6.

- Për vitin 2022 nga Bashkia Librazhd është hartuar dhe miratuar plani vjetor i pranimit në shërbimin civil me datë 19.04.2022 dhe me nr. 1931 prot., me 63 vende vakante.

- Nga punonjësit e larguar nga puna me motivacion shkarkim me masë disiplinore apo largim nga detyra, për vitin 2022 nuk ka asnjë padi dorëzuar në Komisionerin e Nëpunësit Civil apo në Gjykatë.

Nga Bashkia Librazhd me shkresën nr 1134 prot., datë 27.02.2023 janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Harmonizimit dhe Menaxhimit Financiar, Kontrollit Pyetësorët e Vetëvlerësimit dhe Deklaratën për Cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2022. Bashkia Librazhd nuk shpreh qartë mangësitë në aktivitetet e kontrollit, në moszbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Konstatim: Bashkia Librazhd ka miratuar me urdhër të titullarit “Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2022” në tejkallim të afateve, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 152/2013 “Për nënpunësin civil”, neni 18; VKM nr. 108/2014 pika 11;

Konstatim: Nga auditimi rezultoi se “Formularët e përshkrimit të pozicioneve të punës” nuk janë bërë pjesë e dosjes së personelit, apo shtojcë në kontratën e punës për ata punonjës që marrëdhëniet e punës me bashkinë iu rregullohen me Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në kundërshtim kjo me VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

1.3. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit:

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Librazhd funksionon me një strukturë të bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Nga auditimi rezulton se Strukturat Organizative nuk shoqërohen edhe me organigramën përkatëse për t’u miratuar nga Këshilli Bashkiak, por janë miratuar pa to.

- Në Vendimet e Kryetarit të Bashkisë Librazhd është miratuar struktura organizative në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8 pika 1. 1/c. Struktura organizative

për vitin 2022 është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 978 datë 31.12.2021 dhe me nr. 14 prot., datë 05.01.2022. Strukturat organizative nuk janë shoqëruar me organigramën përkatëse. Organigrama si një paraqitje grafike e strukturës organizative, pasqyron një informacion të qartë dhe të kuptueshëm për të gjithë, mbi pozicionet, klasifikimin por edhe mbi numrin e personelit të planifikuar dhe atë faktik. Organigrama është një mjet informues dhe administrativ, pasi përfaqëson njësitë e strukturës (departamente, drejtori e sektorët e tyre) shpërndarjen e tyre, funksionet dhe kompetencat. Organigrama institucionale, paraqet një informacion statistikor në kohë reale mbi kategoritë e proceseve të punës, por edhe numrin e personelit (faktik apo vakant) që u përket. Përsa më lart në zbatim të “Manualit të MFK-së” të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, nr. 108, datë 17.11.2016 dhe atë nr.; Ligjin nr. 152/2013 “Për nënpunësin civil”; Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 21 pika 1,2.

1.4. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore:

Bashkia Librazhd aktivitetin e saj funksional e mbështet në Rregulloren e Brendshme, e miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 20 datë 28.12.2020 me nr. 600 prot., datë 28.12.2022. Rregullorja e Brendshme përmban bazën ligjore dhe fushën e zbatimit, strukturën organizative, funksionet menaxheriale, rregulla të përgjithshme, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e çdo njësie dhe pozicioni, të drejtat dhe detyrat e personelit, trajnimet, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, etj. Bashkia Librazhd deri më sot nuk disponon “Organigramën” ku të jenë pasqyruar të gjitha proceset e punës dhe “Gjurmët e auditimit” për njësitë kryesore të Strukturës.

1.5. Aftësitë profesionale të punonjësve:

Për të audituar dosjet e personelit, përzgjedhëm dosjet e të punësuarve për vitin 2022 në aparatin e bashkisë dhe në ndërmarrjet e varësisë për kategoritë: ngritje në detyrë, pranim në shërbimin civil me kod pune si dhe dosjet e punonjësve të larguar nga Bashkia Librazhd. Emërimet/largimet i janë nënshtruar, Ligjit 152/2013 “Për nënpunësin civil” dhe Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”.

Mbi rregullsinë dhe plotësinë e dosjeve të personelit: Kërkuam një kampion nga dosjet e punonjësve të emëruar në bashkinë Librazhd për vitin 2022 për të gjitha kategoritë, lëvizjeve të personelit/ngritjet në detyrë si dhe të punonjësve të larguar të periudhës nën auditim.

Konstatim: Nga testimi me zgjedhje i dosjeve të personelit, (kampioni që përzgjedhëm), emëruar/larguar në vitin 2022, rezultoi se përgjithësisht dosjet e personelit përmbanin dokumentacionin përkatës të dosjeve, por u konstatua:

- Në dosjet e personelit mungonin vlerësimi 6 dhe 12 mujor dhe përshkrimi i punës i firmosur nga punonjësit në kundërshtim me Ligji nr. 152/2013 i ndryshuar “Për nënpunësin civil” neni 17 pika 1,4; VKM nr. 117, datë 5.3.2014, Lidhja 1 dhe 2.

Konstatim: Nëpunësi Autorizues dhe struktura përgjegjëse e Bashkisë Librazhd (DBNJ), nuk kanë hartuar dhe miratuar plane dhe programe vjetore efektive për trajnimin e detyrueshëm të punonjësve, në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për t’i kryer me efikasitet ato dhe kryesisht për njohjen nga stafi dhe menaxherët e njësisë mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 64, pika h, Ligjit nr. 10296 /2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kapitulli III, pika 3.1

3.2. MENAXHIMI I RISKUT

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative e veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes.

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij. Analizimin dhe rifreskimin e kontroleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut.

Në përmbushje të përgjegjësisë së tij, nëpunësi autorizues mund ti delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinimin e riskut, punonjësve që janë pjesë e strukturës së financës konkretisht nëpunësit zbatues.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.

Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë dhe më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

Kordinator i riskut për Bashkinë Librazhd është emeruar z. B.P me urdhër nr.55 datë 21.01.2022 të titullarit të institucionit.

Kryetari i Bashkisë Librazhd me urdhër nr.54, datë 21.01.2022, “Mbi ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik për vitin 2022” ka caktuar personat përgjegjës.

GMS ka hartuar dhe miratuar “Regjistrin e Riskut” me shkresën pa nr. protokollin të datës 10.01.2022 i cili nuk është në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 21, pika 2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, Aneksi 2, “Regjistri dhe matrica e riskut” si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.2, “Menaxhimi i riskut”.

Konkluzione:

1.Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk ka hartuar strategjinë e riskut në Bashkinë Librazhd në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016 , Kapitulli III, pika 3.2, “Menaxhimi i Riskut”.

2.Rregjistri i Riskut është hartuar nga GMS duke marrë në konsideratë vetëm raportet e auditimit të kontrollit të brendshëm, dhe kontrollit të jashtëm (Kontrolli i Lartë i Shtetit), drejtoritë dhe sektorët e Bashkisë Librazhd nuk kanë identifikuar riskun që mbartin objektivat e përcaktuara në Bashkinë Librazhd në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016 , Kapitulli III, pika 3.2, “Menaxhimi i Riskut”

3.3. AKTIVITET E KONTROLLIT

Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, urdhër-shërbimet dhe kryerja e pagesave, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit

financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesa.

Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për rregjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit.

Likuidimet e transaksioneve nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të cilët janë konfirmuar nga MFE për autorizimin/kryerjen e veprimeve me Degën e Thesarit.

Është i miratuar sistemi me dy firma me shkresën nr.2702/1 prot, datë 02.03.2016.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme.

Përveç kësaj gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurmëve të auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Duke u bazuar në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike” përcaktohet se, “Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës.

Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duhet të përfshijë hapat kryesorë të vlerësuar të rëndësishme për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit: Përgatitja e Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës”.

Bazuar në Udhëzimin nr. 16, date 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Riskut në njësitë publike” në rolin e Koordinatorit të MFK në Bashkinë Librazhd me shkresë nr. 431 prot., datë 26.01.2022 të Kryetarit të Bashkisë Librazhd është caktuar z. B. P. me detyrë “Sekretar i Përgjithshëm”.

Titullarët e njësive kanë përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi. Procedurat antikorrupsion, përfshijnë:

- Kontrollet parandaluese;
- Një sistem për investigim të brendshëm të paralajmërimeve të hershme për korrupsion, mashtrime dhe parregullsi;
- Një sistem për zbulimin e mashtrimeve dhe parregullsi;
- Një sistem për raportimin e parregullsi të gjetura, që duhet të përshkruajë qartësisht linjën e brendshme dhe të jashtme të raportimit, pa rënë ndesh me të drejtën kushtetuese të individit;
- Procedurat e sinjalizimit;

Konkluzione:

1.Bashkia Librazhd nuk ka hartuar procedurat antikorrupsion dhe antimashtrim të cilat duhet të bazohen në Ligjin nr. 9508, datë 03.04.2006 “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër

korupsionit”, Ligjin për MFK-në, i ndryshuar, si dhe Ligjin Nr.10294, datë 01.07.2010 “Për Inspektimin Financiar Publik”, i ndryshuar me ligjin nr.112/2015 e të tjera akte ligjore në fuqi. 2.Për vitin 2022 Bashkia Librazhd nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmën e auditimit në kundërshtim me Ligjin Nr.110/2015 datë 15.10.2015 neni 16 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.3 “Aktivitetet e Kontrollit.

3.4. INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjësi të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
- Një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.
- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.
- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.

Menaxhimit duhet t’i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet.

Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përbushjes së objektivave si në nivel aktiviteti ashtu edhe objektivave të përgjithshme të mbarë njësisë publike. Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin.

Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Librazhd dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

3.5. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura.

Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundur vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës.

Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të Brendshëm.

Procedura nëpërmjet vetëvlerësimit, një përdorues i buxhetit ka nevojë për të përcaktuar nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me rregullat dhe procedurat që sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive.

Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit bëhet duke plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit. Çdo nëpunës autorizues për çdo vit duhet të përgatisë një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai do të deklarojë se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës.

Në deklaratë, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar.

Qëllimi i kësaj deklarate është për të rritur llogaridhënien e menaxhimit dhe për të inkurajuar përpjekjet për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm. Raporti vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi të nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

Me shkresën nr. 134 prot., datë 27.02.2023, nga Bashkia Librazhd është hartuar dhe dërguar pranë Ministrisë së Financave, Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, Raporti Vjetor për Funksionimin e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm, Pyetësorin e Vetëvlerësimit për Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm dhe Plani i Veprimit për ngritjen e sistemit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar në ligjin 115/2015 datë 15.10.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 18, pika 1, dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, pika 15 dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 Aneks Nr.6 “Pyetësori i vetë vlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

Gjithashtu është hartuar plani i veprimit për ecurinë e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.6, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.108, datë 17.11.2016, Kapitulli III.

Titulli i gjetjes: KLSH ka konstatuar se, në Bashkinë Librazhd funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ka shfaqur mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe

Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregojnë se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, gjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

“Mjedisi i kontrollit”:

- Bashkia Librazhd nuk ka hartuar “Kodin e etikës”
- Bashkia Librazhd nuk ka hartuar “Rregulloren e posaçme për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
- Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.
- Nuk janë përcaktuar objektivat konkret, të matshëm, për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.
- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

“Menaxhimi i Riskut”:

- Nuk ka strategji të menaxhimit të riskut sipas nenit 21 i ligjit nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Proçesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezultoi të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, si dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”. Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

- Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.
- Nuk është hartuar një regjistër kompleks për gjithë bashkinë, ku të identifikoheshin dhe të bëhej vlerësimi i risqeve për të gjitha Drejtoritë e NJA si dhe një plan-menaxhimi të risqeve në nivel bashkie për përcaktimin e veprimeve për të adresuar mangësitë.
- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

“Aktivitetet e Kontrollit”:

- Për vitin 2022 Bashkia Librazhd nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmën e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

- Nuk ka hartuar procedurat antikorrupsion dhe antimashtrim të cilat rregullojnë procesin për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Ndikimi/Efekt: Mosnjohje e plotë dhe sa duhet e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të

MFK, duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Shkakuj: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E mesme

1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm:

Në zbatim të programit të auditimit sa i përket çështjes mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së kësaj njësie, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të NJAB Bashkia Librazhd.
2. Plani strategjik për vitet 2022-2024 dhe pasqyrat shoqëruese.
3. Planifikimi vjetor për vitin 2022 dhe pasqyrat shoqëruese.
4. Dosjet e përhershme dhe koherente të subjekteve të audituara.
5. Projekt Raportet dhe Raportet Përfundimtare të realizuara nga NJAB Bashkia Librazhd.
6. Rekrutimi i punonjësve në NJAB si dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik” si dhe sipas Vendimit nr. 93, datë 10.12.2021, të Këshillit Bashkiak Librazhd është miratuar struktura organizative e Bashkisë Librazhd ku pjesë e saj është dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm (në vijim NJAB) e përbërë nga tre pozicione konkretisht, 1 përgjegjës njësie dhe 2 specialist auditit. Përgjatë periudhës objekt auditimi pjesë e NJAB kanë qenë punonjësit si më poshtë:

Periudha: 01.01.2022-31.12.2022:

- Z. R.H me detyrë përgjegjës i njësisë së auditit të brendshëm.
- Znj. M.T me detyrë specialiste auditit.

Struktura e njësisë AB për periudhën 2022, është paraqitur në **Pasqyrën AB1**, në Anekset bashkëlidhur.

1.3. Vlerësimi i veprimtarisë të njësisë së auditit të brendshëm:

Gjatë periudhës 2022, nga sektori i auditit të brendshëm pranë Bashkisë Librazhd, janë kryer gjithsej 5 auditime, ndarë si më poshtë vijon:

- Planin Vjetor për vitin 2022, për auditimet të cilat do të realizohen nga NJAB është miratuar me shkresën nr. 5492 prot., datë 18.10.2021, i ndryshuar me shkresën nr. 719/1 prot., datë 15.02.2022 sipas të cilit janë planifikuar për t’u audituar, e paraqitur në **Pasqyrën AB2**, në Anekset bashkëlidhur.

- Plani Strategjik për periudhën 2023-2025 nuk është përgatitur dhe dërguar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” për vitet 2023-2025 në kundërshtim me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III.

- Raporti Vjetor i Veprimtarisë Audituese për vitin 2022 nuk është dërguar, në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në kundërshtim me Manualin i Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, Pika 3.6.

- Dosjet koherente të NJAB për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi nuk janë mbajtur të plotësuara në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI,

- Karta e Auditimit të Brendshëm për NJAB të Bashkisë Librazhd është miratuar me datë 02.06.2015 nr 758 prot., në përputhje me nenin 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015, e cila nuk

është dërguar ne Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në kundërshtim me Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli II, pika 2.5.

Titulli i Gjetjes: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik.

Situata: Struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, sa i përket numrit të punonjësve nuk ka qenë në përputhje përcaktimet ligjore sipas VKM nr 83 datë 03.02.2016.

- Nuk janë kryer auditime të zbatimit të rekomandimeve, të teknologjisë së informacionit dhe prokurimeve.

- Në raste të caktuara nuk janë zbatuar planet e auditimit;

- Nuk është kryer vlerësimi i riskut sipas fushave të aktivitetit në Bashkinë Librazhd.

- Nuk është kryer raportimi vjetor në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

- **Më hollësisht si vijon:**

- Karta e auditimit të brendshëm nuk është sipas formatit të miratuar në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm”, miratuar me urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016” dhe nuk është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit.

- Për periudhën 2022 numri i punonjësve në sektorin e auditit të brendshëm nuk është sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës, ndërkohë kanë qenë dy të punësuar;

- Plani Strategjik për periudhën 2023-2025 nuk është përgatitur dhe dërguar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” për vitet 2023-2025 në kundërshtim me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III.

- Planifikimi vjetor i auditimeve për vitin 2022, nuk është hartuar në përputhje me Formatin Standard 5: Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NJAB përcaktuar në MAB, konkretisht jepet informacion vetëm për fushat që do të auditohen, llojet e auditimit dhe numrin e tyre, pra jo për zhvillimet aktuale të NJAB, objektivi (at) kryesore për vitin, sigurimi i brendshëm i cilësisë;

- Nuk është bërë raportimi mbi aktivitetin vjetor 2022 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me shkronjën “ç” të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik”.

- Në auditimet e kryera për periudhën e vitit 2022, konstatohet se Sektori i Auditit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. Kjo ka sjellë që titullari i njesisë të mos informohet mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera, në kundërshtim me neni 6 gërma “ç” e ligjit nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik”;

Auditimet e planifikuara dhe të realizuara për vitin 2022 janë paraqitur në **Pasqyrën AB2**, në Aneksat bashkëlidhur.

-Për vitin 2022 nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara, konkretisht janë planifikuar për tu kryer 8 auditime është rishikuar plani i auditimeve në datë 15.02.2022 dhe janë parashikuar të kryen 7 auditime dhe janë kryer 5 auditime gjithsej. Gjithashtu konstatohet se, nuk janë kryer auditime për sektorin e prokurimeve, drejtorinë e ujësjellës kanalizime,

Në dosjet e përzgjedhura për auditim, u konstatua se:

1. Drejtoria e të Ardhurave Vendore, nuk administrohet vlerësimi i riskut, nuk dokumentohen metodat e përdorura në auditim, nuk janë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit nga audituesit e programit të auditimit, nuk administrohet memorandum drejtuar Titullarit të Institucionit për raportin e auditimit.

2. Në auditimin e sektorit MZSH. Programi i Auditimit me nr 5590/2 prot., datë 12.12.2022 është firmosur nga Kryetari i Bashkisë por nuk është kryer auditimi në këtë sektor.

3. Në dosjen e auditimit Klubi i Futbollit “Sopoti” SH.A, nuk administrohet vlerësimi i riskut, nuk dokumentohen metodat e përdorura në auditim.

4. Në dosjen e auditimit Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit të Financave(Sektori i Financave dhe Buxhetit).

Nuk administrohet vlerësimi i riskut, nuk dokumentohen metodat e përdorura në auditim, nuk administrohet memorandum drejtuar Titullarit të Institucionit për raportin e auditimit.

Kriteri: Shkronja “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronjat “c” dhe “ç” në nenin 14, shkronja “e” në nenin 16 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3 të VKM nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”; Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016”; Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, Kapitulli II, pika 8, Kreu 2.2.2, shkronjat “a” dhe “d”, Kreu 2.4.4, Kapitulli III “Plani i auditimit duhet të përgatitet mbi bazë risku – e thënë ndryshe auditimi i brendshëm fokusohet në ato sisteme/fusha ku gjërat ka të ngjarë të mos bëhen siç duhet ose siç janë parashikuar”, Kapitulli III, pika 3.1.6; Kreu 3.1.3 Faza 3 “Strategjia e Auditimit (frekuenca e kryerjes së auditimeve)”, Kreu 3.5 “Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetorë të auditimit të brendshëm”, Kreu 4.1.2-Hapi 1, Kreu 4.1.8- Hapi 7, Kreu 4.1.12- Hapi 11, Kreu 4.1.13-Ndjekja e rekomandimeve, Kreu 4.1.13.1-Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit “Në qoftë se njësisia e audituar nuk përgjigjet me shkrim lidhur me pranimin dhe masat për zbatimin e rekomandimeve, drejtuesi i NjAB-së informon titullarin e njësisë publike, në fushën e përgjegjësisë shtetërore të të cilit bën pjesë njësisia e audituar që menaxheri i lartë nuk ka përmbushur përgjegjësitë e tij ligjore”, Kreu 6.1, 6.3, Format Standard 5: Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NJAB.

Ndikimi/Efekt: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga institucioni. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë.

Shkaku: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E mesme

Pika 2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.1. Programimi i PBA 2022-2024 dhe programimi i buxhetit vjetor ;

2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;

2.5. Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZSH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për auditimin e pikës 2 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Dokumenti i hartimit të PBA 2022-2024 dhe miratimi i tij dhe gjithë korespondenca me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

2. Dokumenti i programimit buxhetit vjetor për vitin 2022 të miratuara me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE dhe korespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë këtyre viteve buxhetore.

3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit Librazhd shpenzimet dhe të ardhurat.

4. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve si fatura të palikujduara dhe vendime gjyqësore.

6. Dokumentet e hartuara periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2022.

8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, per ditaret, shpenzimet te ardhurat etj.).

➤ ***Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin, e PBA dhe programimit të buxheteve vjetore***

● ***Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2022-2024***

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024 rezultoi se:

- Përrealizimin e fazave të përgatitjes ka dalë Urdhri i Titullarit nr.54 datë 21.01.2022 mbi bazën e të ciut është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) i përbërë prej 9 punonjësish dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP). Programi Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe buxheti i vitit 2022, si dhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara janë miratuar në Këshillin Bashkiak.

- Kryetari i Bashkisë nuk ka përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, i cili, është miratuar me VKB nr.100 datë 29.12.2021, i konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr. prot 1465/1 datë 10.01.2022 në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33/1.

- Programi Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 është miratuar me VKB nr.75, datë 10.09.2021 nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së përgatitjes dhe hartimit të PBA rezultoi se në përgjithësi ishin respektuar kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024” dhe të Udhëzimit plotësues të MFE nr.20, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

- Në këtë programim është përgatitur dhe përfshirë Instrumenti të planifikimit financiar, shoqëruar me relacionin shpjegues, i cili është dërguar në MFE me shkresën nr. prot. 4788, datë 14.09.2021 dhe përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzime të viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashigimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogarija e ekonomike, vlerësimi i burimeve (të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme. (kostot direkte dhe të ardhurat e pritshme).

- Në dokumentin e PBA janë përcaktuar drejtimet e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, duke u bazuar në analizën e zërave të buxhetit në tre vitet e fundit dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin PBA-ja 2022-2023-2024.

- Janë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime për funksionet më të rëndësishme si në infrastrukturë, në funksionin e arsimit, në bujqësi për të thithur projekte investimi me financim nga FZSHH. Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe ka marrë rekomandimet e Ministrisë së Financave;

- Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”, ku për të cilat ishin mbajtur relacionet dhe protokollat përkatëse.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2022-2024 dhe buxheteve vjetore, rezulton se janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Njësitë Administrative

dhe nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Librazhd në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, si dhe kërkesa nga sektorë të ndryshëm, që mbulojnë këto programe

-Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investime dhe të ardhurat.

- Kërkesat buxhetore për PBA janë dërguar në MFE me shkresën nr.prot.4788, datë14.09.2021. Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”.

• Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2022

Për vitin 2022, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 101, datë 29.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1466/1 date 10/01/2022, i paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2022	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	153,610	
2	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar	287,603	
3	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	147,542	
4	Te ardhura te trasheguara nga programi “Tungjatjeta Jete”	1,680	
8	Paga (600)		244,797
9	Sigurime shoqërore (601)		40,038
10	Shpenzime operative (602)		135,117
11	Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë		31,135
12	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike		99,883
13	Investime ne proces		39,464
Totali i buxhetit		590,435	590,435

Me Vendim të KB nr.3 datë 31.01.2022është miratuar edhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguarave nga viti paraardhës, i cili ështëkonfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr.1271 datë 11.02.2022, konkretisht këto fonde të trashëguar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Diferencë nga transfertat e pakushtëzuar	3,400	
2	Grant i pashperndare(detyrimet e prapambetura)	757	
3	Të ardhurta të trashëguara	23,131	
4	Të çelura të papërdorura	6,518	
5	Grant i trashëguar	87,028	
6	Transferte e pakushtezuar sektoriale e paperdorur	15,281	
8	Paga (600)		27,862
9	Sigurime shoqërore (601)		6,072
10	Shpenzime operative (602)		39,704
11	Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë		8,547
12	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike		1,920
13	Investime ne proces		52,010
Totali i buxhetit		136,115	136,115

Sipas tabelës së mësipërme buxhetii vitit 2022 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite,kutë ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 992,939mijë lekë dhe me trashëgimet e fondeve në vlerën 726,550 mijë lekë.

- Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

	Emërtimi	Plan fillestar 2022	Sipas PBA 2022-2024	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakush e spec)	284,835	283,155	1,680
2	Shpenzime (602.shp Op.+604 nd.ek.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	166,252	165,056	1,196
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	139,347	139,347	0
4	Investime nga FZHSH			
	Total i planit fillestar	590,434	587,558	2,876
	Shtesat nga Pushteti Qendror	322,094	588,516	-266,422
5	Investime grant i kushtëzuar			
6	Shpenzime për pagat (600+601)	5,996	6,035	-39
7	Shpenzime (602.604.609)	300,281	582,481	-282,200
8	Grant i kushtëzuar (230-231)	15,817	0	-15,817
0	Gjithsej	912,528	1,176,074	-263,546

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave nga KLSH sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Referuar tabelës së mësipërme, nga krahasimi i planit fillestar të buxhetit 2022 me vitin e parë të planit buxhetor afatmesëm 2022-2024, rezulton se ka diferencë prej 266,422 mijë lekë nëntavanin e përcaktuar në PBA. Diferenca prej 266,422 mijë lekë rezultuar nga krahasimi i planit fillestar me vitin e parë PBA (2022) i përket shpenzimeve në llogarivtë 602,604,609 dhe 231), e cila është vlere e shtuar nga akordimi i fondit të kushtëzuar për financimin e ndihmës ekonomike gjatë vitit dhe investimeve të fituara nga Ministritë e Linjës. Këto fonde nuk janë planifikuar saktë, por është bërë planifikim i përafërt, pasi nuk dihej transferata.

- **Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.**

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet, që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Librazhd dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuar dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Librazhd dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxhetivjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Librazhd .

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.Ndryshimet buxhetoregjatë vitit ushtrimor 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Pakësuar/shtuar artikulli (me emër)			
	Nr./datë	Vlera	Nr./datë	Vlera	Shtesa art.	shuma	Paksime art.	Shuma
Viti 2022	Nr. 101, dt 29/12/2021	590,435,568	Nr.17-18/02/2022	3,027,620	231, investime	3,027,620	602-609, ShP. te tjera	3,027,620
			Nr.54/06/2022	44,347,989	231, investime	44,347,989	600-601-609, ShP. te tjera	11,024,871
			Nr. 70/08/2022	4,000,000	231, investime	4,000,000	231, investime 609 fond rezerve	33,323,118 4,000,000
			Nr.88/10/2022	35,432,404	231, investime	35,432,404	609 fond rezerve	837,087
			Nr.96-99/11/2022	7,297,858	606 nd.Financiare,e-civile	7,297,858	231, investime9kursim fond limit)	34,595,317
			Urdher titullari nr.1059dt.30.12.2022	4,970,000	606 nd.financiare	4,970,000	609- fond rezerve 230 stud.projek 600 paga personeli	4,400,000 2,897,858 4,970,000
				99,075,871				

Burimi: Nga të dhënat e buxheteve të hartuara nga Bashkia Librazhd

Konkluzion:Nga sa më sipër konstatojmë se janë kryer ndryshime të vazhdueshme, ku për vitin 2022 kanë ndodhur 8 ndryshime në vlerën 99,075,871lekë, të cilat tregojnë për planifikime optimiste, të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

➤ **Auditim mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.**

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Librazhd, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Librazhd, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv 2022, të miratuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. ng auditimi i shkresave, evidencave të celjeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Librazhd u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	2022		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	271,490	230,556	85
2	Sigurime shoqërore 601	46,998	38,328	81
3	ShP. Operat 602+ F. Rezervë	170,588	132,356	77
4	Transferime 604(Kësh.Qarkut,Reload,Sporti)	27,528	18,076	65
5	Nd/Ekonom invalid 606	601,630	590,821	98
6	Investime (230/231)	281,755	140,226	50
7	Mjete ne ruajtje 466		13,200	
	Totali	1,399,989	1,163,563	83

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërm, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit:

- Për **vitin 2022** janë realizuar 1,163,563 mijë lekë nga 1,399,989mijë lekë të planifikuara, ose në masën 83%.

Kjo tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Librazhd. Në këtë masë realizim ka ndikuar realizimi në masë të ulët në zërat e buxhetit:

- a. Shpenzimet operative llog.602 janë realizuar në masën 77%
- b. Transferime 604 (Këshilli i Qarkut,Sporti) janë realizuar në masën 65 %, realizimi në këtë masë ka ardhur si rezultat i mospagesës së kuotës ndaj këshillit të Qarkut për vitin 2022
- c. Shpenzimet për investime llog.231 janë realizuar në masën 50%. Në realizimin në masë të ulët të investimeve kanë ndikuar vonesat në prokurime dhe në lidhje kontratash, gjë që ka sjellë lënien e likuidimeve në fund të vitit, duke i bllokuar veprimet edhe nga MFE.

Konkluzion:Mosrealizimet në programet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumetuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që, programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale.

Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë transferimet tek individët për ndihmë ekonomike e invaliditeti, ndjekur nga shpenzimet për investime dhe shpenzimet për paga personeli ,tregues të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	EMËRTIMI	Përqindja ndaj totalit
		Viti 2022
1.	Transferime	43%
2.	Investime	20%
3.	Shpenzime për paga	19%

- Miratimi i realizimit faktik të buxhetit

Në fund të periudhës ushtrimore nga Bashkia Librazhd është miratuar buxheti vjetor, ku për vitin 2022 është miratuar me vendim të KB nr.101, datë29.12.2021.

- Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe i kontigjencës

Fondi rezervë për vitin 2022është në total në shumën 21,720 mijë lekë, i cili është miratuar që nga buxheti fillestar e deri në fund të vitit buxhetor me VKB dhe konfirmuar ngaPrefekti I Qarkut Elbasan.

- Miratimi fillestar me VKB nr. nr. 101, datë 29.12.2021në vlerën 10,935 mijë lekë

- Shtesë fondi rezervë me VKB nr.3, datë 31.01.2022 në vlerën 6,282 mijë lekë,

- Shtesë fondi rezervë me VKB nr.81, datë 30.09.2022në vlerën 4,503 mijë lekë,

Përdorimi i Fondit Rezervënëvlerën 21,625mijë lekë, konkretisht:

-V.K.B nr.17 dt.28.02.022 Hidroizolimi i shkollave Dragostunjë, Zdraj Katund ,Mirakë –Plane në vlerën 743 mijë lekë;

-V.K.B nr.17 dt.28.02.022 Rehabilitim për sheshet pranë ujesjellës-kanalizime,shkallëve përballë tregut në vlerën 1,078 mijë lekë;

-V.K.B nr.28 dt.29.03.022/konf.454/1 dt.07.04.022 Ndërtim varri dëshmori të Atdheut Sali Mehmet Alcani(Librazhd) në vlerën 36 mijë lekë;

-V.K.B nr.26 dt.29.03.022 /konf.456/1 dt.7.04.022 financimin e Marrveshjes ndërvendore Eco-ELB në vlerën 280 mijë lekë;

-V.K.B nr.25 dt.29.03.022 /konf 457/1 dt.07.04.022 financimi i rikualifikimit të qendrës së fshatit Fushë - Studën dhe ndërtim i shtegut të bicikletave në vlerën 4,142 mijë lekë;

-VKB nr.52 date 31.05.2022 /konfi nr.722/1 date 13.06.2022 Shtese fondi per 2 familje bonus strehimi Qershor -dhjetor 2022 në vlerën 84 mijë lekë;

-VKB nr.54 date 30.06.2022 /konfirmim nr.822/1 datë 15.07.2022 për “Rrugën Krastë Gizavesh” në vlerën 6,025 mijë lekë;

-V.K.B nr.70 datë 16.08.2022 /konfirmim nr.1004/1 datë 25.08.2022 "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara" në vlerën 4,000 mijë lekë;

-V.K.B nr.88 datë 28.10.2022/konfirmimnr.1250/1 datë 31.10.2022 “Blerje kosha basketbolli profesionale+sistem pikëzimi për palestrën e gjimnazit” në vlerën 837 mijë lekë.

-V.K.B nr.96 datë 14.11.2022/konfirmim nr.1359/1 datë 05.12.2022 për ndihmë financiare (Besnik Çota,Flori Alliu) në vlerën 1,400 mijë lekë.

-V.K.B nr.99 datë 14.11.2022/konfirmim nr.1362/3 datë 13.12.2022 emergjencë civile “Ndërtim i bazamenteve të urës në përroin e Rinasit, fshati Gurë Kuq” në vlerën 3,000 mijë lekë.

• Raportet e Monitorimit.

Për vitin 2022, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 6.Për vitin 2022 është dërguar “Raport monitorimi Buxhetit Janar – Prill” me shkresën nr.prot.2535date 25.05.2022,“Raport monitorimi Buxhetit Janar – Gusht” me shkresën nr.4303 prot date 27.09.2022,“Raport monitorimi Buxhetit Janar – Dhjetor” me shkresën nr.1041 prot date 24.02.2023.

Raportet e monitorimit janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit janë të plota me të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48.

➤ ***Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli realizimit të të ardhurave***

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

• Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të palikujduara

Me fondet e vitit buxhetor 2022, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara Basshkia, nga Ministritë e linjës apo FZSHH sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga viti paraardhës në buxhet respektivisht paraqitet si vijon:

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr. /datë	Llog 602	Llog. 230-231
Viti 2022	9,977,393	9,977,393	101 date 29.12.2021/ 3 datë 31.01.2022	360,000	9,617,393

Burimi: Nga të dhënat e subjekti sipas pasqyrave.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Detyrimet e prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2022:

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31.12.2021 (lekë)	Detyrimi I krijuar në periudhën 01/01/2022 - 31.12.2022 (lekë)	Total detyrime (lekë)	Shlyerja e detyrimeve 2022 (lekë)	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2022 (lekë)

a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministrinë e linjës e FZSHH	8,700,647	226,808	8,927,455	166,536	8,760,919
b. Investime nga Bashkia	10,778,051	856,474	11,634,525	10,778,051	856,474,
INVESTIME :					
Mallra dhe shërbime		60,000	60,000		60,000
Vendime gjyqësore	300,000		300,000		300,000
Totali :	19,778,698	1,143,282	20,921,980	10,944,587	9,977,393

Burimi: Nga të dhënat e subjekti sipas pasqyrave

Referuar shkresës nr.prot.433 datë 28.01.2022 “Mbi publikimin e detyrimeve të prapambetura” të Bashkisë Librazhd dërguar në MFE e për rrjedhojë dhe publikimit të detyrimeve të prapambetura në faqen e MFE në fund të vitit 2021 paraqitet në shumën 19,778,698 lekë dhe në fund të vitit 2022 referuar shkresës nr.prot.595 datë 31.01.2023 “Mbi publikimin e detyrimeve të prapambetura” në shumën 9,977,393 lekë. Gjatë vitit 2022 janë krijuar 1,143,282 lekë, por njëkohësisht është likuajduar vlera prej 10,944,587 lekë, duke ulur në msë të konsiderueshme detyrimet e prapambetura në vlerën 9,977,393 lekë.

Shënim : Detyrimet e raportuara në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vitin 2022 me shkresën nr.595 prot datë 31.01.2023 janë në vlerën 1,216,474 lekë, që i përkasin detyrimeve të krijuara vetëm brenda vitit 2022, ndërsa vlera 8,760,919 lekë janë detyrime nga Ministrinë e Linjës, FZSHH, të cilat nuk janë përfshirë në raportim, pasi likujdimi i tyre është i varuar nga alokimi i fondeve nga Pushteti Qendror.

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 nga analiza e këtyre detyrimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme rezultojnë që, në fund të vitit 2022 janë të palikujduara gjithsej 6 fatura me vlerë 9,677 mijë lekë dhe vendime gjyqësore 300 mijë lekë. Detyrimet e prapambetura të detajuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Nr .	Subjekti	Objekti i kontratës	Numri I faturës	Data e faturës	Gjendje me 31.12.2021	Pagesat gjatë vitit 2022	Shtuar gjatë vitit 2022	Gjendje në 31.12.2022
1	Z	Mbikqy "Furniz uje fsh Dorez, Gizavesh, Katund, Qender	64	5.12.2017	479,206	479,206		0
2	L.&CO shpk	Azhor -regjistri fillestar zones kadast fsh Qarrisht faza e II	48	30.11.2019	0		736,474	736,474
3	"M. shpk	Mbikqyr"Rik rruge te brendshme, fshatra komun viti 2014	17998804	23.12/2014	23,400	23,400		0
4	M.C	Kola. Rik.oborrit dhe punime holli ,shkoll mesme I.Muca	13	26.11.2020	13,200	13,200		0
5	L. B	Blerje material shtrim I rrugve rurale me inerte	4/2021	13.08.2021	300,150	300,150		0
6	V.K	Rikonstrukcion ne kanale vadites Kanali Joles etj	17/2021	06.08.2021	2,114,660	2,114,660		0
7	K	Rik.kanali vadites I Mesit	10/2021	10.06.2021	7,372,724	7,372,724		0
8	I.205	Rehabilitim perforcim banesash qendra fshati TogeZ	31	31.01.2020	474,711	474,711		0
9	E.L	Perkthim faqesh	14/2022	21.10.2022			60,000	60,000
10	A.P	Blerje materiale ,dyer dritare alumini dhe xhama	136/2022	09.08.2022			120,000	120,000
I.		Totali I			10,778,051	10,778,051	916,474	916,474
II		Fatura te palikujduara me financim nga FZHR						0
11	D. SH.P.K.	Kolaud"Rik rrug automobil fsh Dardhe " ish Kom Hotolish	189 53 31	17.06.2015	166,536	166,536		0
12	V.I	Rikualif urban Zona Perendim Qytet Librazhd,prita lumore	5	01.09.2018	8,534,111			8,534,111
13		Shtese anesore 3 kate ndertim palestre shkoll.9-vjec "V.B"					226,808	226,808
		TOTALI II			8,700,647	166,536	226,808	8,760,919
III		Vendimet gjyqesore te pa likujduara Vitit 2020						
	Objekti vendimit	Emri i personit/subjektit	Nr.vendi mit	Vlera/leke	Gjendje me 31.12.2021	Paguar gjatë Vitit 2022	Shtuar gjate vitit 2022	Pa likujduar 31.12.2022
3	Kontratë investimi	Shoqeria "RETO"shpk	1310	2,557,933	300,000			300,000
		TOTALI III			300,000			300,000
		TOTALI I Pergjithshem ME 31.12.2022 I+II+III			19,299,971	10,944,587	1,143,282	9,977,393
		5% tengurtesuar 31.12.2022			45,113,188	14,045,328	8,237,412	39,305,272
					64,413,159	24,989,915	9,380,694	49,282,665

Konkluzion: Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, në fund të periudhës ushtrimore 2021 Bashkia Librazhd ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në shumën prej 19,299,971 lekë, e cila ka ardhur duke u ulur. Nga auditimi i dokumentacionit të miratimit të buxhetit vjetor 2022 rezultoi se, është bërë planifikimi i fondeve të vecuara për financimin e detyrimeve të prapambetura në përputhje me kërkesat Udhëzimit të MFE nr.09, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit”.

Detyrimet e prapambetura për vitin 2022 të paraqitura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.595 prot datë 31.01.2023 jepen në tabelën si më poshtë :

NR	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	1,216,474		0.16%
a	Shpenzime korrente	60,000		
a,1	Mallra dhe shërbime	60,000		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale	856,474		
b,1	Insitucione buxhetore	856,474		
b,2	Subjekte private			
c	Vendime gjyqësore	300,000		
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime (kontraktuale)	300,000		
c,4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	1,216,474	752,455,166	0.16%

Analiza e vlerës së e detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2022 dhe raportuar në MFE paraqitet më poshtme:

a. Me financim nga Bashkia Librazhd

- Vendim Gjyqësor në vlerë të mbetur prej 300,000 lekë me objekt detyrime kontraktuale e trashëguar nga ish-Komuna Lunik, e cila ka përfunduar së likujduari në shkurt të vitit 2022
- Azhornim per rregjistrim fillestar te zonës kadastrale te fshatit Qarrisht , Nj.Qender në vlerën 736,474 lekë i krijuar me faturën të datës 30.11.2019 e lëshuar nga operatori ekonomik “L.C” shpk, detyrim i lënë nga KLSH dhe hapur proces gjyqësor.
- Shërbim “Perkthim faqesh” në vlerën 60,000 lekë me faturën e datës 21.10.2022, likujduar në 4-mujorin e parë të vitit 2023.
- Blerje materiale ,dyer dritare alumini dhe xhama në vlerën 120,000 lekë me faturën e datës 22.09.2022, likujduar në 4-mujorin e parë të vitit 2023.

b. Me financim nga Ministrinë e linjës dhe Fondi i Zhvillimit Shqiptar

- Rikualifikimi urban Zona Perendimore te Qytetit Librazhd ,Prita lumore me financim nga FSHZH me faturë të datës 01.09.2018 në vlerën 8,534,11 lekë, është në proces gjyqësor me objekt: për shkelje të afateve kontraktuale.
- Shtese anesore 3 kate dhe ndertim palestere per shkollen 9-vjecare "Vilson Blloshmi"me financim nga FSHZH me faturë të datës 01.09.2018 në vlerën 226,808 lekë (pjesore), nuk është likujduar për mungesë fondesh të alokuara nga FSHZH.

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	2022		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	271,490	230,556	85
2	Sigurime shoqërore 601	46,998	38,328	81
3	ShP. Operat 602+ F. Rezervë	170,588	132,356	77
4	Transferime 604(Kësh.Qarkut,Reload,Sporti)	27,528	18,076	65
5	Nd/Ekonom invalid 606	601,630	590,821	98
6	Investime (230/231)	281,755	140,226	50
7	Mjete ne ruajtje 466		13,200	
	Totali	1,399,989	1,163,563	83

Krijimi dhe akumulimi idetyrimeve të paguar në fund të vitit ushtrimor është në papajtueshmëri me Udhëzimi i MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Vështirësia Financiare

Nga auditimi është konstatuar se **detyrimet e papaguara (të akumuluar)** në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën **1,216,474lekë** dhe **fondet e miratuara** për shpenzime të këtij viti janë në vlerën **798,359,000 lekë** (1,399,989,000 lekë totali i planifikuar –601,630,000 lekë transferta e kushtëzuar ndihmë ekonomike & invaliditet). Peshat specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj ndaj palëve të treta është 0.15 % kundrejt fondeve të miratuara. Kjo situatë tregon se, Bashkia Librazhd nuk mund të konsiderohet në vështirësi financiare në fund të vitit ushtrimor 2022, pasi raporti i e detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është nën nivelin prej 25 %, sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

- Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta (minimale) të Bashkisë Librazhd.

- Për **vitin 2022** janë planifikuar fonde për investime në shumën **281,754,894lekë** (nga te cilat 231,642,747 leke janë nga grant i pakushtëzuar + transferta sektoriale + të ardhura dhe 50,112,147 leke transfertë e kushtëzuar M.linje), realizuar dhe likuiduar në vitin 2022 në vlerën 153,425,926. Realizimi në masën 46% i investimeve ka ardhur si rezultat i disa faktorëve si: nuk është prerë faturë nga operatori fitues dhe një pjesë e tyre nuk janë prokuruar brenda vitit.

Gjatë vitit ka pasur ndryshime si shtesa dhe pakësime, të cilat janë shqyrtuar nga GMS dhe ka vendosur miratimin e tyre dhe më pas janë miratuar me VKB për secilin rast.

Këto projekte me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Objekti i kontratës	Fond Planifikim	Kontrata me subjektin			Subjekti i kontraktuar	Paguar Viti 2022	Mbetja 31.12.2022	Komente
			Datë lidhjes se kontratës	Afati	Vlerë kontrate me TVSH				
1	Mbikqyrje kolaudime viti 2022	8,690,622			8,690,622		2,690,719	5,999,903	Lik.ne vazhdi
2	Furn. Vend. kof'I ♥ LIBRAZHDI"	500,000	07.11.2022	10 dite	499,200	E.M	499,200	800	Perfunduar
3	Blerje paisje elektronike	600,000						600,000	Pa prokurua
4	Studime projektive	4,102,142						4,102,142	Pa prokurua
5	Bashkëfin.permirsimi i banesave .21	8,311,197	02.11.2021	3 muaj	7,719,437	B. N	6,416,211	337,695	5% garanci
6	Instalim I programit te finances	72,000					72,000		Lik.2023
7	Rehabilitim, perforcimban..Togez 19		25.09.2019		39,151,871	E.Sh	450,975	23,736	5% garanci
8	Blerje dhe montim kondicioner	375,000	13.12.2021	5 dite	366,000	K. 200	366,000	0	Perfunduar
9	Blerje paisje kuzhinat e kopshteve	779,994	05.11.2021	7 dite	760,800	A.K	693,600	67,200	5% garanci
10	Detyrime te prapambetura	4,557,867						4,557,867	
11	Blerje mobilie per zyrat e bashkise	500,000	24.02.2022	5 dite	482,160	HB	457,007	42,993	Penalite
12	Riko.shkalleve hyrese te bashkise Lib	889,894	05.12.2022	7 dite	863,352	E Shpk		889,894	Lik.23 ll.pen
13	Blerje frigorifer per administraten	30,000			30,000		30,000	0	Perfunduar
14	Riku. qendFushe Studen, shteg. biciklet	3,655,072	30.08.2022	4 muaj	3,655,072	A. Shpk	2,678,270	976,802	5%.Proces
15	Permi. banesave .varfera te 2022	33,950,065	08.11.2022	80 dite	32,075,796	B.N	1,294,705	2,705,295	2 faza fin

16	Bashkefinancim tvsh Food Hub	4,937,486	06.12.2022		4,937,486	E Shpk		3,259,151	Pritjeafateve
17	Rikonstr. kanali Rine Dorez Qender	15,958,376	29.12.2020		15,575,610	V.K	3,396,731	178,879	5% garanc
18	Rikonstruksion kanale vaditese (Joleta)	9,360,000	08.06.2021	21 dite	9,192,060	V.K	2,008,927	105,733	5% garanc
19	Blerje tuba per kanalet vaditese	1,500,000	17.05.2022	12 muaj	1,407,048	H. shpk	1,407,048	92,952	5% garanc
20	Riparime te pjesshme ne kanale vadites	4,500,000	13.06.2022	30 dite	4,443,055	G. K	4,017,942	482,058	5% garanc
21	Rikonstruksion i kanaleve vaditese	12,000,000	05.10.2022	40 dite	11,428,050	A. CO	5,700,000	300,000	5% garanc
22	Ndertim Central Park (Parku Qendror)	43,595,531	22.09.2021	3 muaj	43,445,026	E	27,805,596	15,639,430	Proces likuj
23	Rik i rrugeve rurale dhe veprave te artit	9,987,415	29.04.2021	25 dite	9,933,109	G. K	4,698,409	247,285	5% garanc
24	Rehabilitim I shesheve	9,999,558	11.05.2021	1 muaj	9,699,402	M. SH.P.K	4,500,486	241,771	5% garanc
25	Blerje materiale ,shtrim i rrugeve rurale	712,800	30.07.2021	5dite	693,600	L. BL	300,150	6	Perfunduar
26	Instalim kamera sigurie ne rruget	15,000,000	02.11.2022	60 dite	14,636,280	I.S.S		5,000,000	fat dhjetor
27	Mbroj lumore pergjte lumit Shkumbin	2,160,000	12.09.2022	20 dite	1,854,672	M	1,761,938	92,734	5% garanc
28	Shpronetime	6,000,000						6,000,000	Pa realizuar
29	Rehabilitim i shesheve lagjia Sheja	7,905,116						7,905,116	Pa prokurua
30	Rehabilitim i shesheve lagjia Mirak Pla	10,000,000						10,000,000	Pa prokurua
31	Riparime te shtresave asfaltike	5,000,000	20.09.2022	5 dite	4,868,557	B. N	4,625,129	374,871	5% garanc
32	Zgjerim Miniparku Qershive	7,247,989						7,247,989	Pa prokurua
33	Rikonstruksion i rrugeve rurale	5,000,000						5,000,000	Pa prokurua
34	Blerje fadrome dhe autovinc	6,000,000	28.10.2022	10 dite	5,736,000	A Lb	5,736,000	264,000	Perfunduar
35	RikonstruI rrugeve rurale per vitin 2021	8,812,917	02.03.2022	30 dite	7,802,846	Z. K	7,412,703	1,400,214	5% garanc
36	RikonstruksI rruges Kraste -Gizavesh	118,206,786	08.11.2022		69,019,363	T shpk		20,710,011	Ft.28.12.22
37	Sistemim Asfaltim I rruges Cercan	49,376,842						9,308,357	Pa prokurua
38	Veshje me tartan e fushes se basketboll	1,575,000						1,575,000	Pa prokurua
39	Furnizim vendosje barriere mbrojtese	3,711,960						3,711,960	Pa prokurua
40	Zgjerim I trotuarit ne rrugen Arberia	7,146,247						7,146,247	Pa prokurua
41	Disiplinim I ujrave te bardha	4,003,230	30.07.2021	15 dite	3,913,386	K. shpk	3,717,717	195,669	5% garanc
42	Blerje mikrofon lavalier EËI-FI per inter	95,000			90,000		90,000	0	Perfunduar
43	Ndertim i kendit sportiv ne shk.Orenje	5,694,884						5,694,884	Pa prokurua
44	Blerje kosha basketbolli profesional	3,690,840						3,690,840	Pa prokurua
45	Pyllezime ne pyjet e Bashkise Librazhd	1,200,000						1,200,000	Pa prokurua
46	Pyllez ek. pyjore Neshte Prevalle	1,207,000						1,207,000	Pa prokurua
47	Blerje makiner per prerje carje dru zjarri	238,800						238,800	Pa prokurua
48	466 te likujduara						13,199,828		
	Totali grant i pakushtezuar + tarsnsferta sektoriale + të ardhura	448,837,630			312,969,860		106,027,291	138,815,284	
	Buxheti shtetit								
1	Permisbanesa ekzist per komunitet varfer e te pafavoriz (bashkefinanc)	33,244,788	02.11.2021	3 muaj	30,877,746	B. N	30,894,547	1,753,856	5% garanc
2	Ndertim ujesjellesi iPolis Gostime	79,467,648	11.10.2021	5 muaj	77,721,107	M	9,500,000	0	5% garanc
3	Mbikqyrje Ujesjellesi Polis	1,692,793	11.10.2021	5 muaj	1,537,538	N. S			Pa prer fatu
4	Rikonstruksion i kanalit vadites te Mesit	62,179,786	20.10.2020		59,995,025	K. SHPK	7,004,088	0	5% garanc
	Totali transfert e kushtezuar M.linje	176,585,015			170,131,416		47,398,635	1,753,856	
	Totali i vitit 2022	625,422,645			483,101,276		153,425,926	140,569,140	

- Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e investimeve në nivel projekti paraqiten si

më poshtë:

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e 27 projekteve të investimeve Bashkia Librazhd, rezultoi se janë realizuar dhe finalizuar me kontratë 11 projekte dhe nuk janë prokuruar 16 projekte në vlerën 74,628,335 lekë .

Projekte të pa prokuruar për vitin 2022:

1. Blerje paisje elektronike 600,000 lekë.
2. Studime projektive 4,102,142 lekë.
3. Shpronësime 6,000,000 lekë.
4. Rehabilitim i shesheve lagjia Sheja 7,905,116 lekë.
5. Rehabilitim i shesheve lagjia Mirak Plane 10,000,000 lekë.
6. Zgjerim Miniparku Qershive 7,247,989 lekë.
7. Rikonstruksion i rrugëve rurale 5,000,000 lekë
8. Sistemim Asfaltim i rruges Cercan 9,308,357 lekë.
9. Veshje me tartan e fushes së basketbollit 1,575,000 lekë.
10. Furnizim vendosje barriere mbrojtëse 3,711,960 lekë.
11. Zgjerim i trotuarit në rrugën Arberia 7,146,247 lekë.
12. Ndërtim i kështjës sportive në shk. Orenje 5,694,884 lekë.
13. Blerje kosha basketbolli profesional 3,690,840 lekë.
14. Pyllezime në pyjet e Bashkisë Librazhd 1,200,000 lekë.
15. Pyllez ek. pyjorë Neshtë Prevalle 1,207,000 lekë.
16. Blerje makineri për prerje çarje dru zjarri 238,800 lekë.

Si rezultat i moskryerjes së objekteve të investimit nuk janë realizuar dhe fondet e akorduara për mbikqyrje kolaudime në vlerën 5,999,903 lekë.

Të gjitha projektet e mësipërme janë trashëguar për vitin 2023 me përjashtim të :

- Veshje me tartan e fushes së basketbollit 1,575,000 lekë.
- Blerje paisje elektronike 600,000 lekë.
- Shpronësime 6,000,000 lekë.
- Blerje kosha basketbolli profesional 3,690,840 lekë.

në vlerën 11,865,840 lekë të cilat kanë shkuar për financimin e projektit të ri “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Spathar loti I .

- Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e **27** projekteve të investimeve Bashkia Librazhd, rezultoi se janë ndjekur hapat:

Për çdo procedurë prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe ka vulën/ datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Librazhd . Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Librazhd dhe të shtrira në kohë sipas financimit brenda vitit buxhetor koherent. Kontrata është regjistruar e plotë me qëllim pagesën e saj në afate mujore, pra nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në Degën e Thesarit është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit.

➤ Burimet e financimit të buxhetit vjetor

Realizimi i buxhetit për vitin 2022 sipas burimit të financimit paraqitet në tabelën e mëposhtme.

000/lekë

Nr	Emertimi	2022		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	271,490	230,556	85
	grant i kushtezuar	5,260	5,210	99
	grant i pakushtezuar + tarsnsferta sektoriale	259,596	220,205	85
	te ardhura	6,634	5,141	77
2	Sigurime shoqërore 601	46,998	38,328	81
	grant i kushtezuar	881	872	99
	grant i pakushtezuar + tarsnsferta specifike	45,599	36,952	81

	te ardhura	518	504	97
3	Shpenz.operative 602+ F.rezerve	170,588	132,356	77
	grant i kushtezuar	60	56	93
	grant i pakushtezuar + tarsnsferta specifike	101,515	79,566	78
	te ardhura	69,013	52,734	76
4	K.Qarkut Transferime 604	27,528	18,075	66
	grant	14,416	12,316	85
	grant i kushtezuar	9,412	4,257	45
	te ardhura	3,700	1,502	40
5	Nd ekonomike invalid 606 ,bonus strehimi ,ndihma financiare	601,630	590,821	98
	grant i kushtezuar	581,808	578,303	99
	grant i pakushtezuar + tarsnsferta specifike	17,862	12,518	70
	te ardhura	1,960		0
6	Investime 230-231	281,755	153,426	54
	grant i kushtezuar	50,112	47,399	94
	grant i pakushtezuar + trasnsferta specifike	113,890	66,504	58
	te ardhura	117,753	39,523	33
	Totali Bashkia Librazhd	1,399,989	1,163,562	83

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se nga të ardhurat e veta kjo bashki përballon në fakt:

- Shpenzimet në artikullin 600 “paga e shpërblime” për vitin 2022 në masën 0.44%.
- Shpenzimet në artikullin 601 “kontributin për sigurime shoqërore e shëndetësore” për vitin 2022 në masën 0.04%.
- Shpenzimet në artikullin 602 “shpenzime operative për mallra e shërbime” për vitin 2022 në masën 4.5%.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 “investime” për vitin 2022 në masën 3.39 %.
- Shpenzimet në artikullin 604 “transferime “ për vitin 2022 në masën 0.12%.

Duke u nisur nga burimi i financimit **për vitin 2022** shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 99,404 mijë lekë ose në masën 8.5 %, nga transferta e pakushtezuar dhe transferta specifike në shumën 428,061 mijë lekë ose në masën 36.5%, nga transferta e kushtezuar në shumën 636,097 mijë lekë ose në masën 55% .

Titulli gjetjes: Mbi programimin, realizimin dhe zbatimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi.

Situata:

Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2020 u konstatua se:

a. Realizimi i buxhetit për vitin 2022 janë realizuar 1,163,563 mijë lekë nga 1,399,989 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 83%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 602 “Shpenzime operative” në masën 77%, i cili tregon për planifikim me rezervë të tij. Me realizim në nivel të ulët paraqitet dhe zëri 230-231 “Shpenzime për investime” në masën 50%, i cili ka ardhur nga mos realizimi dhe finalizimi me kontratë i 11 projekteve të planifikuara si dhe nuk janë prokuruar fondet për 16 projekteve të tjera të planifikuara. Këto investime kanë kaluar për realizim dhe financim me fonde të trashëguara në vitin 2023, me përjashtim të 4 projekteve jo proiritare dhe kalimi i fondeve të tyre për financimin e 1 investimi në rugë rurale.

b. Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën 9,977,393 lekë ose në masën 0.15 % të shpenzimeve të planifikuara, të cilat janë ulur krahasuar me fundvitin 2021, që ishin në shumë të konsiderueshme prej 19,778,698 lekë. Detyrimet e krijuara vetëm në vitin 2022 janë në vlerën 1,143,282 lekë. Detyrimet e papaguara rakordojnë me gjendjet e llog. të klasë 4 të bilancit të vitit 2022, por nuk rakordojnë për shumën 8,760,919 lekë me raportimin në MFE të vitit 2022 (në vlerën 1,216,474 lekë), diferencë që i përket e detyrimeve të prapambetura për investime të pa financuara nga Ministritë e linjës dhe FZSHH, të cilat nuk janë përfshirë në raportim.

c. Gjithashtu konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën më të madhe prej 81.5% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtezuar dhe transferta e kushtezuar e

transferta specifike) dhe 8.5% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifatat vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat që siguron njësia vendore nga burimet të tjera.

Kriteri:

Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 43 paragrafi 4,47,48,52; ligji nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40/h,42; Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3.

Ndikimi:

Realizim jo të kënaqshëm të shpenzimeve në disa zëra buxheti si dhe realizim jo shumë të mirë të të ardhurave si dhe raportim jo i plotë e detyrimeve të papaguara.

Shkaku:

Mos programimi i buxhetit mbi bazë prioritetesh dhe nevojash reale dhe ndryshimet e shpeshta e bëjnë të paqëndrueshëm dhe jo efektiv procesin e buxhetimit, ndërsa mos evidentimi i saktë i detyrimeve dhe mos likuidim i tyre sjell rritjen e borxhit që ka Bashkia ndaj të tretëve.

Rëndësia: *I mesëm*

Për këtë rekomandojmë:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Librazhd, nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe në bashkëpunim me Menaxhimerët Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme në mënyrë që, programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të jenë sa më të argumentuara, si dhe të kujdesen për realizimin e projekteve të investimeve të planifikuara, sipas prioriteteve strategjike, duke eliminuar vonesat në procedurat e prokurimit, në lidhjen e kontratave, në rritjen e bashkëpunimit me operatorët ekonomik për përfundimin dhe dorëzimin e punimeve në afat, sigurimin e mbërritjes së faturave në institucion dhe likuidimin e tyre, duke eliminuar limitimin e likuidimeve për anagazhime të marra. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

Pika 2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë

- Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022
- Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit për vitin 2022.
- Rregjistri i taksapaguesve privat dhe familjar.
- Rakordimet me agjentët tatimor.
- Evidenca e planifikimit të të ardhurave.
- Aktet e rakordimit me degën e thesarit për të ardhurat.
- Regjistrat e subjekteve debitorë në 31.12.2022.
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në lidhje me çështjen e të ardhurave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

Drejtoria e të Ardhurave Vendore mbulon 6 njësi administrative, të cilat janë: NJA Qendër, Hotolisht, Lunik, Stëblevë, Polis, Orenjë dhe ka në përbërje 2 Sektorë (Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe i Burimeve Natyrore dhe Sektori i Transportit, Tregut dhe Parkingeve). Kjo drejtori ka 11 punonjës: 1(një) drejtor, 2 (dy) përgjegjës sektori 3 specialistë sektori, 1 agjent tregu dhe 4 inspektor taksash dhe tarifash vendore. Inspektori përgjigjet për taksat familjare (taksë ndërtesë, truall, taksën e tokës bujqësore, tarifa etj).

Paketa fiskale për periudhën objekt auditimi është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 95, datë 06.12.2021 “Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2022”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën Nr. 1329/1 Prot , datë 21.12.2021.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për vitin 2022, subjekte që kanë ushtruar aktivitetet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Lloji i Biznesit	Paraqitja e numrit te bizneseve			Për vitin 2022
	Gjendja fillim 31.12.2021	Biznese të reja gjate vitit 2022	Biznese të mbyllura, pezulluara gjate vitit 2022	Gjendja me 31.12.2022
Biznes i Vogël	633	46	52	627
Biznes i Madh	127	6	6	127
Institucione	41	0	6	35
Gjithsej	801	52	64	789

Për vitin 2022, kanë ushtruar aktivitetet 789 subjekte, nga të cilat 633subjekte të biznesit të vogël, 127 subjekte të biznesit të madh dhe 41 institucione.

Në vitin 2022, numri total ka qenë 22 subjekte më pak se në vitin 2021.

Bazuar në paketën fiskale, afati i pagesës së detyrimeve për taksapaguesit familjar dhe për biznesin e vogël është në datën 30 shtator dhe 30 nëntor, ndërsa bazuar në aktmarrëveshjen e lidhur midis Bashkisë Librazhd dhe Ujësjetllës Kanalizime ShA, “Për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore për viti 2022”, lidhur në datën 16.03.2022, neni 3, është përcaktuar “Shuma totale e detyrimit për tarifa dhe taksa vendore për cdo abonent të ndahet në një periudhë 4 mujore”. Ky përcaktim i bërë në akt marrëveshje është jo në përputhje me përcaktimin e bërë në paketën fiskale. Pra në dy dokument ka dy përcaktime të ndryshme lidhur me afatin e pagesës së detyrimeve për taksapaguesit familjar dhe për biznesin e vogël.

Gjithashtu përcaktimi i afatit në akt marrëveshje është i pa qartë, pasi përcaktimi” të ndahet në një periudhë 4 mujore”, nuk përcakton se kur fillon kjo periudhë dhe kur mbaron. Në akt marrëveshje duhej të ishte përcaktuar qartë afti 4 mujor brenda së cilit duhet të paguhet detyrimi.

Taksat e Tarifave vendore për familjarët ne qytet mblidhen nëpërmjet Ujësjetllës Kanalizime ShA, i i cili vepron si agjent tatimor. Këto taksa për qytetin janë: taksa e ndërtesës, tarifa e pastrimit dhe ndriçim gjelbërimit. Ndërsa taksat që UK ShA mbledh për familjarët.

UK ShA nuk mbledh tasa dhe tarifa për familjarët e njësisive administrative. Taksat familjare të NJA mblidhen nga specialistët e taksave. Për këtë kategori familjarësh (NJA), lloji i taksave dhe tarifave janë: taksa e ndërtesës, tarifa e pastrimit (për ato fshatra ku shtrihet ky shërbim), taksë trualli dhe tarifa e druve të zjarrit.

Për vjeljen e detyrimeve familjare për vitin 2022 për taksa e tarifa vendore janë përgatitur listat dhe janë dërguar tek agjenti tatimor Ujësjetllës Kanalizime ShA, sipas akt marrëveshjes se lidhur midis Bashkisë Librazhd me këtë shoqëri, sipas shkresës Nr 1322 prot, date 16.03.2022.

Numri i taksapaguesve familjar që Ujësjetllës Kanalizime ShA ka detyrimin e mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore është 2525 familje, ndërsa vlera e detyrimit sipas llogaritjeve të bëra nga Bashkia Librazhd është 7,857 mije leke .

Sipas rakordimi dy palësh në datën 31.12.2021, Ujësjetllës Kanalizime ShA nuk ka mbledhur për llogari të Bashkisë Librazhd, vlerën 3,585 mije leke. Duke i shtuar kësaj vlere detyrimin që Ujësjetllës Kanalizime ShA ka vitin 2022, e cila ka vlerën 7,857 mije lekë, vlera totale për arkëtim vitin 2022 është 11,442 mije leke (detyrime të vitit dhe të mëparshme, pra progresive). Vlera e arkëtuar nga Ujësjetllës Kanalizime ShA gjatë vitit 2022 është 7,989 mije leke (xhirimet e bëra). Bashkia Librazhd gjatë vitit 2022 ka bërë sistemime për taksapagues të kategorisë të cilët përjashtohen nga taksa e ndërtesës dhe kanë lehtësira në tarifatat vendore (invalid etj.), në vlerën 150 mijë lekë dhe 80 mijë lekë komisione për pagesën e agjentit tatimor.

Për sa më lart, debitorë familjare për taksa e tarifa vendore qe vilen nga Ujësjetllës Kanalizime deri 31.12.2022 janë ne vlerën 3,224 mije leke, detyrime te prapambetura nga viti 2011-2022, (sipas akt- rakordimit të datës 24.01.2023 për gjendjen 31.12.2022)

Bashkia Librazhd sipas VKB si më sipër ka miratuar treguesit e planit të të ardhurave, për vitin 2022.

Në mënyrë analitike planifikimi dhe realizmi i të ardhurat për taksat dhe tarifatat vendore paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Lloji i Taksës, Tarifës	Planifikimi 2022	Fakti Progresiv Janar-Dhjetor 2022	Realizimi ne %
	<i>Te ardhura tatimore</i>			
	<i>Te ardhura nga taksat vendore</i>			
1	Tatim i thjeshtuar mbi biz e vogël	1,800,000	227,158	12.6
2	Taksa nga tatimi mbi te ardhurat personale	3,000,000	9,550,973	318.4
3	Taksa mbi ndërtesat	12,650,000	12,530,701	99.1
4	Takse mbi truallin	550,000	525,000	95.5
5	Takse toke bujqësore	5,400,000	3,580,000	66.3
6	Taksa e kalim te drejtës se pronësisë	750,000	97,140	13.0
7	Taksa e ndikimit ne infrastrukture ndërtimet e reja	10,000,000	5,569,858	55.7
8	Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga legalizimet	4,000,000	3,632,187	90.8
9	Takse tabele	600,000	381,610	63.6
10	Takse hoteli	160,000	75,600	47.3
11	Taksa e regjistrimit përvitshëm te automjeteve	12,000,000	12,575,834	104.8
12	Takse nga Renta	350,000	257,638	73.6
13	Takse e përkohshme e ndikimit ne infrast.rrugore	5,000,000	4,810,800	96.2
	Shuma	56,260,000	53,814,499	95.7
	<i>Te ardhura jo tatimore</i>			
	<i>Te ardhura nga tarifatat vendore</i>			
1	Tarife pastrimi	18,000,000	17,950,000	99.7
2	Tarife ndricimi+Gjelbrimi	3,450,000	3,350,000	97.1
3	Tarife shërbimi ne varrezat publike	100,000	105,000	105.0
4	Tarifa e shërbimit veterinar	300,000	299,000	99.7

5	Tarife e tregut te organizuar	1,500,000	976,640	65.1
6	Tarifa leje për tregtim ambulator	50,000	40,500	81.0
7	Tarife parkimi	1,250,000	1,307,416	104.6
8	Tarife për dhënie licence e certifikate transporti	500,000	1,155,300	231.1
9	Tarife për leje te drejta , vërtetime, informacione .	700,000	138,300	19.8
10	Tarife për zënien e hapësirës publike	2,000,000	1,687,119	84.4
11	Tarife për librat e udhëtimiti te udhëtarëve brenda vendit	425,000	50,000	11.8
12	Tarifa për autorizime ushtrim aktiviteti, karburantet autorizime për karburantet.	6,150,000	5,200,000	84.6
13	Tarifa te tjera nga Urbanistika	1,600,000	555,601	34.7
14	Tarife për linjat ajrore dhe nëntokësore	430,000	330,000	76.7
15	Tarife për mbetjet inerte	200,000	33,333	16.7
16	Tarifa për ndikimin ne mjedis	6,650,000	3,813,585	57.3
17	Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.	500,000	186,000	37.2
18	Interesa kamatëvonesa, taksat	500,000	1,013,624	202.7
19	Detyrimi i prapambetur nga taksat	16,000,000	17,316,317	108.2
	Shuma	60,305,000	55,507,735	92.0
	Tarifa ne sektorin e pyjeve dhe kullotave			
1	Tarifa ne Sektorin e Pyjeve	12,650,000	14,188,964	112.2
2	Tarifa ne Sektorin e Kullotave	320,000	204,740	64.0
3	Tarifa nga shfrytëzimi i materialit drusor nga subjektet	21,000,000	25,354,047	120.7
4	Nga shfrytëzimi i druve te zjarrit nga fshatarësia	5,500,000	2,676,000	48.7
5	Nga shfrytëzimi i prodhimeve te dyta pyjore, te tjera .	250,000	134,850	53.9
6	Te ardhura nga përdorimi vërtetimeve te transportit ,kamate vonese dok. Ankandi rap teknik etj	600,000	501,000	83.5
7	Te ardhura nga shitja e materialit drusor qe dalin nga rrallimet	150,000	-	0.0
	Shuma	40,470,000	43,059,601	106.4
	Te ardhura te tjera			
1	Qera e shitje trualli	500,000	184,160	36.8
2	Qera ndërtese	370,000	489,353	132.3
3	Pagesa e prinderve çerdhe	1,200,000	1,494,418	124.5
4	Pagesa e prindërve kopsht	3,835,000	4,976,063	129.8
5	Detyr.te prapamb.nga kopshtet çerdhe dhe qendra ditore	1,000,000	-	0.0
6	Gjoha nga I.N.U.V, policia	2,000,000	192,880	9.6
7	Te ardhura nga pullat e gjendjes civile 5 %	70,000	44,500	63.6
8	Sponsorizime	-	2,241,200	
9	Te ardhurat nga shitja	-	91,520	

10	Sekuestri dhe Zhdemtime	-	369,500	
	Shuma	8,975,000	10,083,594	112.4
	TOTALI	166,010,000	162,465,429	97.9

Për vitin 2022, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga 166,010,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 162,465,429 lekë ose 98 %, me një mosrealizim në vlerën 3,544,571 lekë.

Taksa e tokës bujqësore, nga 5,400,000 lekë i planifikuar është realizuar 3,580,000 lekë ose 66 %, me një mosrealizim në vlerën 1,820,000 mijë lekë. Për këtë taksë Bashkia Librazhd ka hartuar rregjistrin e taksapaguesve për tokën bujqësore. Numri i taksapaguesve që ngarkohen me detyrime është 7,506. Rregjistri është hartuar mbi bazën e të dënave që vetë njësitë administrative administrojnë, si dhe sipas dokumentacionit që ka drejtorja e bujqësisë. Gjykojmë se do të ishte e nevojshme edhe një rakordim me DAMT në qark për këtë qëllim.

Nr.	Njësia Administrative	Familje (Nr)	Toke Bujqësore (Ha)
1	Njësia Administrative Hotolisht	1,070	694
2	Njësia Administrative Qender	1,802	681
3	Njësia Administrative Lunik	414	2,125
4	Njësia Administrative Stebleve	711	417
5	Njësia Administrative Orenje	1,559	4,049
6	Njësia Administrative Polis	1,500	3,081
	TOTALI	7,056	11,047

Taksa mbi ndërtesat, nga 12,650,000 lekë i planifikuar është realizuar 12,530,701 lekë ose 99 %, me një mosrealizim në vlerën 119,299 lekë.

Nga të dhënat e Drejtorisë e të Ardhurave, për vitin 2022 të ardhurat për taksat dhe tarifave vendore të cilat mbledhen me agjent tatimorë, sipas përqindjeve të mëposhtme dhe planifikimit e realizimit të tyre:

- 97 % nga taksa e kalimit të drejtës së pronësisë
- 5 % nga taksa e rentes minerare
- 25 % nga taksa e regjistrimit të automjeteve
- 2 % tatimi mbi të ardhurat personale .

Nr	Emërtimi	Viti 2022	
		Plan /000 leke	Fakt /000 leke
1	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë (agjenti kadastra)	750	97
2	Taksa e regjistrimit përvitshëm të automjeteve (agjenti DSHTR)	12,000	12,576
3	Renta minerare	350	258
4	Tatimi mbi të ardhurat personale	3,000	9,551
	Totali	16,100	22,482
	Realizimi	140%	

Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2022.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore progresive për periudhën 2011-2022, janë krijuar debitorë në vlerën **96,164,783** leke, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Librazhd. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 27,208,335 lekë nga 74 subjekte debitor të biznesit të madh, detyrimi prej

15,809,650 lekë nga 303 subjekte debitor të biznesit të vogël, detyrimi prej 3,924,422 lekë nga 96 ndërtesa social ekonomike, detyrimi prej 10,260,919 lekë nga 283 raste për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara, detyrimi prej 38,961,457 lekë nga taksapaguesit familjar.

Vetëm për vitin 2022, vlera e detyrimeve të pa arkëtuar për taksat dhe tarifatat vendore është 29,754,569 lekë, ose 31% e totalit të detyrimeve progresive. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 18,646,196 lekë nga 46 subjekte debitor të biznesit të madh, detyrimi prej 3,594,774 lekë, nga 175 subjekte debitor të biznesit të vogël, detyrimi prej 1,948,955 lekë nga 92 ndërtesa social ekonomike, detyrimi prej 2,011,853 lekë nga 49 raste për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara, detyrimi prej 3,552,791 lekë nga taksapaguesit familjar.

Në formë tabele, të dhënat për debitorët jepen si vijon:

	Në fillim të vitit 2022 (trashëguar nga vitet e mëparshme 2011-2021)		Krijuar brenda vitit 2022		Arkëtuar debitorë për periudhë 11-21		Në fund të vitit 2022	
	Nr	Vlere	Nr	Vlere	Nr	Vlere	Nr	Vlere
Biznesi i Madh	85	30,175,150	46	18,646,196	49	21,613,011	74	27,208,335
Biznesi Vogël	347	16,137,406	175	3,594,774	121	3,922,530	303	15,809,650
Ndërtesat social ekonomike	92	3,501,970	92	1,948,955	49	1,526,503	96	3,924,422
Legalizimet	263	9,593,857	49	2,011,853	29	1,344,791	283	10,260,919
Familjet	4719	38,159,683	1584	3,552,791	656	2,944,138	5268	38,961,457
SHUMA	5,506	97,568,066	1,946	29,754,569	904	31,350,973	6,024	96,164,783

Nga të dhënat e drejtorisë së të ardhurave, konstatohet se në datën 31.12.2021, situatë e debitorëve është si vijon:

TAKSAPAGUESIT	Krijuar brenda vitit 2021		Në fillim të vitit 2022 (trashëguar nga vitet e mëparshme 2011-2021)	
	Nr	Vlere	Nr	Vlere
Biznesi i Madh	55	16,894,002	85	30,175,150
Biznesi Vogël	276	3,927,000	347	16,137,406
Ndërtesat	32	1,712,000	92	3,501,970
Legalizimet	94	2,931,000	263	9,593,857
Familjet	2143	5,239,400	4719	38,159,683
SHUMA I	2,600	30,703,402	5,506	97,568,066

Nga krahasimi i vlerës së debitorëve midis dy viteve 2021 dhe 2022, si vlerës progresive, ashtu edhe vlerës së krijuar brenda secilit vit, konstatohet se është pothuaj e njëjta situatë. Sa më sipër nga Drejtoria e të Ardhurave, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar neni 12, germën “g”, dhe kushtet e kontratave të lidhura, subjektet që nuk kanë likuiduar detyrimet e kontratave me listë janë dërguar Drejtorisë së Financës për kontabilizim..

Pasqyra e subjekteve debitorë biznesi vogël , madh , ambulante e ndërtesa (lloji i aktivitetit: social ekonomik) etj,(2011-2022) date 31.12.2022.

Nr	Njesi Administrative	Subjekte Gjithsej	Vlera Gjithsej	Biz. Vogel Nr	Biz.Vog Vlere	Biz. Madh Nr	Biz. Madh Vler
1	Bashkia Librazhd	473	46,942	399	19,734	74	27,208
	Totali	473	46,942	399	19,734	74	27,208

Jo të gjithë subjektet që janë debitor janë aktiv. Një pjesë e tyre edhe pse nuk kanë mbyllur aktivitetin në QKB, për shkak të detyrimeve që kanë, ata janë konstatuar nga Drejtoria e të ardhurave se praktikisht nuk zhvillojnë aktivitet. Të dhënat janë sipas tabelës në vijim.

Nr	Njesi Administrative	Subjekte Gjithsej	Vlera Gjithsej	Biz. Vogel Nr	Biz. Vog Vlere	Biz. Madh Nr	Biz. Madh Vlere
Debitorë 31.12.2022							
1	Bashkia Librazhd	318	36,490	271	15,193	47	21,297
	Totali	318	36,490	271	15,193	47	21,297

Drejtoria e të Ardhurave, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime.

Afatet e pagesave sipas paketës fiskale:

Për biznesin e madh data 30.09.2022. Për biznesin e vogël 30.11.2022.

Për detyrimet tatimore të pa mbledhura janë ndjekur procedurat për mbledhjen me forcë të tyre, ku procedura e pare është njoftim vlerësimi për detyrimet e prapambetura, për biznesin e madh, biznesin e vogël, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, etj. Njoftim vlerësimet për detyrimet e prapambetura janë bërë më shkesën Nr 4580, Prot. date 13.10.2022 për biznesin e madh, shkresën Nr. 373 Prot., datë 19.01.2023 për biznesin e vogël, ndërtesat me qira , ambulante etj .

Mbas njoftim vlerësimi për subjektet debitorë janë kryer procedurat si vijon:

- Me shkresën Nr .5365 Prot, date 25.11.2022, është bërë bllokimi i llogarive bankare për biznesin e madh, ndërsa me shkresën nr. Nr 1104. Prot ,date 27.02.2023, është bërë bllokimi i llogarive bankare për biznesin e vogël.

- Me shkresën Nr. 1151 Prot , date 01.03.2023 është bërë vendosje e barrës hipotekore te pasurisë se paluajtshme pranë AShK me Nr.1102Prot, date 27.02.2023.

- Me shkresën Nr .1103 Prot., date 27.02.2023 është bërë vendosje e barrës së siguresë për mjetet e transportit.

Sipas të dhënave, edhe pse vazhdojnë procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 473 subjekte debitorë biznesi i madh, i vogël dhe ndërtesa social kulturore, në vlerën **46,942** mijë lekë, janë aktiv 318 subjekte ose 67 % e totalit të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa, në vlerën **36,490** lekë ose 78 % e vlerës së debitorëve.

Ndaj subjekteve debitorë për asnjë rast nuk është zbatuar pika 2 e nenit 89, e ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, nuk është kërkuar kallëzim penal ndaj subjekteve problematike debitorë në vite dhe me vlera

të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Ndërsa **vlera debitorë prej 38,159,683 lekë** përbëhet nga 5,268 familje të për taksat e tarifave vendore me datë 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve, për periudhën 2011-2022, sipas pasqyrës si më poshtë:

000/lekë

	Bashkia Librazhd	Taksa vendore			Tarifa Vendore	Shuma taksa tarifa	Numri i familjeve
		Taksë Toke	Taksë Ndërtese	Taksë Trualli			
1	Familjaret Qytet	-	1,236	-	1,967	3,203	355
2	Njesia Adm. Hotolisht	2,458	1,901	352	391	5,102	814
3	Njesia Adm.Lunik	868	106	-	12	986	258
4	Njesia Adm.Orenje	2,775	1,388	486	-	4,659	611
5	Njesia Adm.Polis	1,573	2,877	89	146	4,685	640
6	Njesia Adm. Stebleve	3,587	992	33	-	4,612	690
7	Njesia Adm Lib Qender	8,398	6,024	95	1,177	15,694	1900
	Shuma	16884	13136	569	3693	38,961	5268

Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundor.

Në Bashkinë Librazhd kanë zhvilluar aktivitet 6 subjekte për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë. Nga të dhënat e bashkisë Librazhd konstatohet se të gjitha këto subjekte janë pajisur me autorizime (licenca), sipas të dhënave të mëposhtme:

	Subjektet	Data e leshimit të licencës	Data e përfundimit të afatit të licencës
1	S.G	31.05.2018	31.05.2023
2	K	09.11.2018	09.11.2023
3	S.G	03.04.2019	03.04.2024
4	M.O	02.04.2019	02.04.2024
5	H	03.09.2019	03.09.2024
6	D. M	19.06.2020	19.06.2025

Nga rekomandimi i KLSH ,Bashkia Librazhd, Drejtoria e te Ardhurave Vendore ka marre masat për 6 subjektet për te arkëtuar detyrimin për pajisjen me autorizime për licenca për tregtim me pakice të karburanteve për subjektin S.G, M.O, H. Shpk, K Shpk, S.G ,D.M, Janë njoftuar me shkresë “Njoftim për pagese “dhe “fature për arkëtim” për vlerën 900,000 leke me shkresë Nr. 6497 Prot, date 10.12.2021 . Mbas njoftimit per pagese është dërguar dhe njoftim vlerësimi me Nr .583Prot date 07.02.2022.Vlera prej 5,400 mije leke është arkëtuar si me poshtë .

Gjendja e pagesave te kryera te subjekteve .

Subjektet	Shuma totale per pagese / leke	Data e pageses	Shuma e pageses / leke	Diferenca pa u arketuar/ leke
S.G	900,000	14.04.2022	500,000	-
		11.01.2023	400000	
K	900,000	22.02.2022	900,000	-
S.G	900,000	27.04.2022	500,000	-
		19.01.2023	400000	

		25.01.2022,25.01.2022,18.03.2022,15.04.2022		
M.O	900,000	12.06.2022,14.06.2022	900,000	-
H	900,000	24.03.2022	900,000	-
D.M	900,000	17.02.2022	900,000	-
Shuma	5,400,000		5,400,000	-

Nga auditimi për likuidimin e detyrimeve për kontrata të lidhura për shfrytëzim të fondit pyjor dhe kullosor.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se nga Bashkia Librazhd janë lidhur 68 kontrata për dhënie me qira për shfrytëzim të fondit pyjorë kullosor, arkëtimi i të cilave ndiqet nga Drejtoria e të Ardhurave. Nga të dhënat e kësaj drejtorie konstatohet se detyrimi vjetor për këto kontrata është në vlerën 13,572,886 lekë. Në datën 31.12.2021, detyrimi i pa paguar për këto kontrata ka vlerën 4,035,818 lekë, detyrimi i vitit 13,572,886 lekë, paguar gjatë viti 2022 vlera 14,625,564 lekë, detyrimi më 31.12.2022 është në vlerën 2,983,140 lekë, nga 13 subjekte debitor, e cila i përket vitit 2022. Vlera 2,983,140 lekë konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e Bashkisë Librazhd, sipas të dhënave të paraqitura në aneksin nr.2, bashkëngjitur projektraportit të auditimit.

Nga auditimi për likuidimin e detyrimeve për lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se në datën 31.12.2021, vlera progresive e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet është 9,593 mijë lejë, e cila përbehet nga 263 raste (legalizime objektsh) të pa likuiduara. Për vitin 2022, numri total i objekteve të legalizuara nga ASHK Elbasan është 124, me vlere për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet prej 4,895 mije leke.

Për vitin 2022 janë kryer pagesa për llogari të detyrimeve të prapambetura dhe detyrimit të vitit në vlerën 4,228 mijë lekë, për 104 raste (objekte). Kjo pagesë e shprehur në përqindje përbën 27% të numrit total progresiv të objekteve të legalizuara, ose 29% të vlerës së detyrimit progresiv, sipas tabelës në vijim:

Në /000 lekë

Nr	Gjendja me 31.12.2021		Objekte të legalizuara në vitin 2022		Pagesa të kryera gjatë vitit 2022		Gjendja e debitorëve në 31.12.2022	
	Nr. objekteve	Vlera e taksës	Nr objekteve	Vlera e taksës	Nr objekteve	Vlera e taksës	Nr objekteve	Vlera e taksës
1								
2	263	9,593	124	4,896	104	4,228	283	10,261

Si përfundim, nga të dhënat progresive, deri në datën 31.12.2022, nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, 283 persona me vlerë **10,260,919 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Librazhd.** Rezulton se nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkisë Librazhd, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 3.

III. Strategjia e menaxhimit të aseteve me qëllim krijimin e të ardhurave prej tyre. Auditim mbi shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për dhënie me qira të aseteve të Bashkisë (ndërtesa, tokë bujqësore të pa ndara etj). Rregullshmëria ligjore në lidhjen e kontratave. Arkëtimi i të ardhurave nga qiraja dhe përdorimi i tyre.

Titulli gjetjes: Mungesa e regjistrimit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Librazhd.

Situata: Bashkia Librazhd në miratimet e strukturave organike të administratës për vitin 2022 ka ngritur sektor për administrimin dhe menaxhimin e aseteve si strukturë të veçantë për administrimin, inventarizimin, gjendjes faktike dhe mbledhjen e të ardhurave nga kontratat e qirave të aseteve në administrim të Komunës. Gjatë vitit 2022 në programin buxhetor afatmesëm 2023-2025 është parashikuar vlera 500,000 lekë për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Vlera e parashikuar në buxhet për Sektorin e Menaxhimit të Aseteve është shumë e ulët dhe si rrjedhojë bëhet e pa mundur regjistrimi i të gjithë pasurive sipas listave të inventarit të pronave shtetërore/publike dhënë nga Këshilli i Ministrave, Bashkisë Librazhd, si vijon;

1. Me Vendim të Këshillit të Ministrave **Nr.1413, Datë 22.10.2008** “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Lunik, të Qarkut të Elbasanit”. Lista me 83(tetëdhjetë e tre) fletë i bashkëlidhet këtij vendimi dhe përfundon me numrin rëndor 609 (gjashtëqind e nëntë).
2. Me Vendim të Këshillit të Ministrave **Nr.377, Datë 08.04.2009** “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Stëblevë, të Qarkut të Elbasanit”. Lista me 80(tetëdhjetë) fletë i bashkëlidhet këtij vendimi dhe përfundon me numrin rëndor 543 (pesëqind e dyzet e tre).
3. Me Vendim të Këshillit të Ministrave **Nr.313, Datë 25.03.2009** “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Qendër, të Qarkut të Elbasanit”. Lista me 131(njëqind e tridhjetë e një) fletë i bashkëlidhet këtij vendimi dhe përfundon me numrin rëndor 951 (nëntëqind e pesëdhjetë e një).
4. Me Vendim të Këshillit të Ministrave **Nr.1086, Datë 28.10.2009** “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Librazhd, të Qarkut të Elbasanit”. Lista me 85(tetëdhjetë e pesë) fletë i bashkëlidhet këtij vendimi dhe përfundon me numrin rëndor 422 (katërqind e njëzet e dy).
5. Me Vendim të Këshillit të Ministrave **Nr.1414, Datë 22.08.2008** “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Orenjë, të Qarkut të Elbasanit”. Lista me 100 (njëqind) fletë i bashkëlidhet këtij vendimi dhe përfundon me numrin rëndor 744 (shtatëqind e dyzet e katër).
6. Me Vendim të Këshillit të Ministrave **Nr.891, Datë 19.08.2009** “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Polis, të Qarkut të Elbasanit”. Lista me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë i bashkëlidhet këtij vendimi dhe përfundon me numrin rëndor 405 (katërqind e pesë).
7. Me Vendim të Këshillit të Ministrave **Nr.579, Datë 28.05.2009** “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Hotolisht, të Qarkut të Elbasanit”. Lista me 97(nëntëdhjetë e shtatë) fletë i bashkëlidhet këtij vendimi dhe përfundon me numrin rëndor 705 (shtatëqind e pesë).

Sa më sipër Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Bashkia Librazhd me Urdhër Nr. 955, datë 30.11.2022 “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm të pasurisë së Bashkisë dhe njërive administrative në varësi të saj”, ka urdhëruar ngritjen e nëntë grupeve për inventarizim për të gjithë njësitë administrative të Bashkisë Librazhd (Qendër, Lunik, Orenjë, Hotolisht, Steblevë, Polis), për Drejtorinë e Kulturës, Drejtorinë e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale.

Drejtoria e Pyjeve Kullotave dhe Mjedisit është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e fondit pyjor/kullor në pronësi të Bashkisë Librazhd të kaluar në pronësi sipas VKM Nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, i ndryshuar me VKM 684 datë 02.09.2020.

Bazuar në VKM Nr. 684 Datë 02.09.2020 fondi pyjor i Bashkisë Librazhd është 37803 ha ku sipas listës së inventarit Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit rezultojnë 1554 pasuri të zërave kadastrale (pyll, shkëmbore, kullota) ndër to 428 pasuri rezultojnë që kjo drejtori është duke proceduar me regjistrimin e tyre në ASHK-Librazhd.

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Librazhd ka në administrimin e saj rreth **4379** (katërmijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) pasuri të paluajtshme publike në pronësi dhe në përdorim, nga të cilat janë të regjistruara në ASHK-Librazhd vetëm **112** (njëqind e dymbëdhjetë) prej tyre, ndërsa të paregjistruara nga Bashkia Librazhd vazhdojnë të mbeten **4267** (katërmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) pasuri. Bashkia Librazhd nuk ka marrë masa të plota për regjistrimin e të gjitha pronave dhe pasqyrimin e tyre në inventarin e pasurive dhe në kontabilitet, nuk ka ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, dokumentacion i cili është i nevojshëm për të realizuar regjistrimin e tyre; nuk ka kryer rakordim me ASHK Librazhd për asetet e ish komunave, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e këtyre objekteve; nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuara dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer detyrimin e trojeve në funksion të ndërtesës; Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, kreu IV i tij, përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike, shtetërore (nenet 35 - 41)”, UMF-së Nr.30, Datë **27.12.2011** “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30; ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.20, Datë 28.12.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë Librazhd”, neni 50.

Kriteri:

VKM Nr.510, Datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF Nr.30, Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16) Ligji Nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, kreu IV i tij, përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike, shtetërore (nenet 35 - 41) dhe ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Shkaku:

Mungesa e fondeve si dhe verifikimi faktik i regjistrit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Librazhd.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa që me grup pune, të cilët të jenë specialist të fushës, të hartojë regjistrin e plotë të aktiveve, jo vetëm për ato që janë të rregjistruara në kontabilitet, por edhe për aktivet të cilat momentalisht nuk janë të rregjistruara në librat e kontabilitetit. Mbi bazën e evidentimit në regjistrin e aktiveve, të bëhet inventarizimi fizik i të

gjitha pronave në teren dhe për situatën e konstatuar të hartohet një raport i hollësishëm titullarit të institucionit.

Rekomandimi: Sektori i Menaxhimit të Aseteve si dhe Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, për pronat e pa rregjistruara, të marrin masa për përgatitjen e dosjeve me dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor dhe rregjistrimin e tyre në ASHK. Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Aseteve, të llogarisë në buxhetin e PBA dhe buxhetin vjetor fondet e nevojshme për rregjistrimin e pronave në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Librazhd.

- ✓ *Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:*
 - Z. K.G në funksionin ish-Kryetar i Bashkia Librazhd;*
 - Z.Sh.Q, me detyrë, ish-Përgjegjës i Sektorit Menaxhimit Aseteve;*
 - Z.B.C, me detyrë, ish-Drejtor i Drejtorisë Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit;*
 - Z.A.B, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit;*
 - Z.Q.F, me detyrë, përgjegjës në Drejtorinë Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit;*
 - Z.D.H, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Menaxhimit Aseteve, Bashkia Librazhd;*
 - Z.J.V, me detyrë Specialist i Sektorit Menaxhimit te Aseteve, Bashkia Librazhd.*

Titulli gjetjes: *Mos kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale të cilat janë certifikuar në ASHK nga sektori i menaxhimit të asetëve në Bashkin Librazhd.*

Situata: Nga auditimi rezultoi se për vitin 2022 Sektori i Menaxhimit të Aseteve si dhe Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit në Bashkia Librazhd, ka regjistruar në Drejtorinë Rajonale të ASHK Librazhd në total 112(njëqind e dymbëdhjetë) prona sipas aneksit nr.3/9 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se pronat e certifikuar Bashkia Librazhd nuk ka kryer procesin e vlerësimit për 112 pasuritë e regjistruara cka e vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Librazhd. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. *Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16); VKB Nr.20, Datë 28.12.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë Librazhd”, neni 50.*

Kriteri:

VKM Nr.510, Datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF Nr. 30, Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16).

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar.

Shkaku:

Mos marrja e masave nga Bashkia Librazhd për vlerësimin e asetëve dhe më pas kontabilizimin e tyre.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Aseteve në Bashkinë Librazhd, të ndërmarrin të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin 112(njëqind e

dymbëdhjetë) pronavë të certifikuara në ASHK Librazhd, por pa vlerë respektive si dhe më pas të bëhet paraqitja e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësive publike vendore Bashkia Librazhd sipas aneksit Nr.1 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

- ✓ *Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:*
 - Z.K.G në funksionin ish-Kryetar i Bashkia Librazhd;*
 - Z.S. Q, me detyrë, ish-Përgjegjës i Setorit Menaxhimit Aseteve;*
 - Z.B. C, me detyrë, ish-Drejtor i Drejtorisë Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit;*
 - Z.A. B, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit;*
 - Z.Q. F, me detyrë, përgjegjës në Drejtorinë Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit;*
 - Z.D. H, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Menaxhimit Aseteve, Bashkia Librazhd;*
 - Z.J. V, me detyrë Specialist i Sektorit Menaxhimit te Aseteve, Bashkia Librazhd.*

Titulli gjetjes: *Mangësitë e evidentuar nga kontratat e lidhura në vitin 2022 me subjektet që shfrytëzojnë sipërfaqet në fondin pyjor me qëllim karriere.*

Situata: Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, nëpërmjet procedurës së ankandit, për periudhën janar-dhjetor 2022 ka lidhur 15 (pesëmbëdhjetë) kontrata për dhënie në përdorim të fondit pyjor me afat 10-vjeçar, për periudhën 2022-2032 (sipas aneksit nr. 2/1 bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit).

Parcelat e dhëna me qira nga fondi pyjor e kulloror janë pjesë e listës së pronave të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Librazhd, por këto kontrata janë lidhur në kushtet e mos plotësimit të plotë të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm. Këto kontrata nuk janë të shoqëruara me certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë dhe hartën treguese e cila duhet të lëshohet nga ASHK Librazhd. Gjithashtu në kontratat e qirasë mungon plani i rilevimit, i cili duhet të bëhet nga një topograf i licensuar dhe në të përcaktohen të dhënat e pronës, vendndodhja dhe kufijtë e saj, të cilët janë elementë të rëndësishëm në lidhjen e një kontrate. Në dosje bashkëlidhur gjendet vetëm një kopje harte nxjerr nga ASIG, e cila nuk përbën element kryesor në legjitimimin e pronës/asetit objekt qiraje.

Konstatohet se në të gjitha kontratat e lidhura, për distancën nga rruga kryesore për të hyrë në sipërfaqen e marr në përdorim, e cila është pjesë e fondit pyjësor/kulloror kombëtar, e administruar nga qiradhënësi dhe do t'i shërbejë qiramarrësit, nuk i nënshtrohet pagimit të detyrimeve për servitut kalimi duke krijuar të ardhura të munguara në buxhet.

Kriteri: Mos respektimi i përcaktimeve të Ligjit Nr.7850, Datë 29.07.1994 “Për K.C.R.SH-në” neni 826 i tij; të VKM Nr.559 Dt.29.07.2022 “Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”; Ligjin Nr. 57/2020 “Për Pyjet”; Ligjin Nr.9693/2007“Për fondin kulloror” si dhe Udhëzim Nr.1/2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kulloror publik”.

Ndikimi/Efekti:

Mungesë të ardhurash për Bashkinë Librazhd.

Shkaku:

Mos evidentimi dhe llogaritja e saktë e sipërfaqeve të cilat përdoren nga subjektet për qëllim karriere.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit të marrin masa që në vazhdimësi të lidhjes së kontratave të përcaktohen saktë dhe të tarifohen të gjithë sipërfaqet dhënë me qira, servitutet e kalimit etj., duke evituar mungesën e të ardhurave të krijuara për Bashkinë Librazhd.

Bashkia Librazhd të marrë masa në mënyrë të menjëhershme të regjistrimit të pronave të cilat jepen për shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore.

✓ *Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:*

Z.K. G, me detyrë ish-Kryetar i Bashkisë Librazhd;

Z.B. C, me detyrë, ish-Drejtor i Drejtorisë Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit;

Z.A. B, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit;

Z.Q. F, me detyrë përgjegjës në Drejtorinë Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit.

IV- Vlerësimi i punës së ZAMT- ve për tokat bujqësore, azhornimet e kryera mbi zbatimin e ligjshmërisë për veprimet e kryera në marrëdhëniet e ndryshimeve të pronësisë dhe regjistrimi në ASHK.

Spektori i menaxhimit dhe mbrojtjes së tokave bujqësore pranë Bashkisë Librazhd që nga viti 2016 është marrë me zbatimin e VKM nr.994 datë 09.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, sipas aplikimeve të kryera nga fermerët. Procesi i azhornimit të AMTP-ve për fermerët vazhdon akoma, si rezultat i numrit të madh të aplikimeve të mëparshme zyra vendore e ASHK Librazhd i ka kërkuar Bashkisë të realizojë këto azhornime me anë të shkresave të saj drejtuar Bashkisë. Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Spektori i menaxhimit dhe mbrojtjes së tokave bujqësore veprimtarinë e saj aktualisht e bazon në ligjin Nr.9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Në zbatim të tij dërgohet informacion me të dhëna në lidhje me dëmtimin e tokës bujqësore çdo 6 muaj në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark.

Fondi i tokës bujqësore për të gjithë fshatrat e Bashkisë Librazhd është 9678 ha (hektar). Me ligjin Nr.7501 “Për tokën”, Bashkisë Librazhd rezulton se janë ndarë 5672 ha dhe pjesa tjetër prej 4006 ha nuk u nda nga komisionet e ndarjes së tokës në fshatra. Nga fondi i pandarë i tokës bujqësore që në regjistrat e pasurive të paluajtshme figurojnë me pronar shtet, me VKM nr.770 datë 12.11.2014 kanë kaluar në fondin e kompensimit fizik në dispozicion të Agjencisë së Trajtitimit të Pronës 1103 pasuri e llojit Tokë Arë me sipërfaqe totale 2095.74 ha. Kjo është bërë pa u kryer verifikimet e duhura si gjatë regjistrimit fillestar të pasurive ashtu dhe në momentin që këto pasuri janë bllokuar nga VKM nr.770/2014 dhe si pasojë ka sjellë dhe mbivendosje me pronarë që kanë përfutur tokë me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi.

Konstatohet se, nga auditimi i kryer Spektori i Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës Bujqësore nuk ka kryer korrespondencën e detyruar me ASHK, Librazhd në zbatim të ligjit **Nr.20/2020** “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, neni 6 i saj ku dispozitat e këtij kreu kanë për qëllim konsolidimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi tokën bujqësore, nëpërmjet:

a) *“regjistrimit të titujve të pronësisë, që burojnë nga të gjitha aktet ligjore e nënligjore për pronësinë mbi tokën bujqësore, që kanë sjellë efekte përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji;*

b) *përfundimit të proceseve të pajisjes me tituj pronësie të përdoruesve të tokave të ishkooperativave dhe ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët kanë paraqitur kërkesë për këtë qëllim deri në gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”, dhe akteve nënligjore të saj Vendim Nr.1174, datë 24.12.2020 “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e*

sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese”, si dhe Vendim Nr.1180 Dt. 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore”.

Bashkia Librazhd, në zbatim të ligjit Nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, kreut IV të tij, neni 41, nga Bashkia ka filluar vetëm një procedurë në fund të vitit 2020, për inventarizimin dhe transferimin në pronësi të Bashkisë për 33 pasuri të llojit Arë në zonën kadastrale 3087, duke qenë se në këtë zonë regjistrimi fillestar i pasurive është kryer në vitin 2019. Ndërkohë që sipas pasqyrimeve të tabelave treguese rezultojnë që disponohet sipërfaqja 9678 ha tokë bujqësore, nga të cilat tokë e ndarë deri më sot është sipërfaqja 5672ha dhe tokë e pandarë një sipërfaqe prej 4006 ha, për të cilën nuk ka një informacion mbi gjendjen juridike dhe fizike të saj.

Për vitin 2022, Kontrata Qiraje të lidhura për tokë bujqësore është vetëm **1 (një)** me qira nga komisioni i qiradhënies së tokës bujqësore të pandarë, sipas udhëzimit Nr.1, Datë 18.07.2012, një sipërfaqe tokë bujqësore prej 12.2 ha në NJ.A.Q.Dorëz, ku palë janë Bashkia Librazhd dhe Shoqëria “N.I” shpk me administrator M.SH lidhur kontratë me Nr.495, Dt.01.02.2022, e cila rezulton e paguar në vlerën **74538 lekë**. Për shkak të mosndjekjes së procedurave në gjenezë konform ligjit si dhe mos bërjes së politikave e strategjive për zhvillim të tokave bujqësore kemi një aktivitet në nivele shumë të ulta nga Bashkia Librazhd dhe Sektorët menaxhues të tyre për llojit e aseteve/tokave bujqësore.

Evidencë për tokat bujqësore 2022

FONDI I TOKËS BUJQËSORE, BASHKIA LIBRAZH D				
Nr.	Njësia Admin/Fshati	Sipërfaqja e tokës me 01.08.1991	Tokë e ndarë sipas ligjit Ha	Tokë e pandarë Ha
I	Njësia Admin.Hotolisht	1465	909	556
1	Xhyre	357	186	171
2	Vehçan	223	116	107
3	Buzgare	35	9	16
4	Vulçan	125	107	18
5	Kokreve	108	75	33
6	Hotolisht	331	208	123
7	Dardhë	296	208	88
II	Njësia Admin.Qendër	3028	1904	1124
1	Dragostunjë	434	356	78
2	Spathar	291	149	142
3	Babje	244	153	91
4	Arrëz	38	30	8
5	Gizavesh	283	201	82
6	Librazhd Katund	191	151	40
7	Qarrishtë	130	94	36
8	Dorëz	608	290	318
9	Togëz	47	16	31
10	Librazhd Qender	326	140	186
11	Kuturman	334	136	98
12	Marinaj	102	88	14
III	Njësia Admin.Polis	950	621	329
1	Mirakë	212	142	70
2	Gostimë	217	154	63
3	Polis Qender	97	82	15
4	Polis Sheh	67	44	23
5	Gurshpatë	242	149	93
6	Vilan	115	50	65
IV	Njësia Admin.Lunik	1249	725	524
1	Zgosht	300	170	130
2	Letëm	314	162	152
3	Koshorisht	72	68	4
4	Lunik	266	131	135
5	Prevall	142	103	39
6	Dranovicë	63	32	31
7	Kostenjë	92	59	33
V	Njësia Admin.Orenjë	1710	1050	660
1	Funarës	327	185	142
2	Neshtë	110	75	35
3	Mexixë	60	37	23

FONDI I TOKËS BUJQËSORE, BASHKIA LIBRAZHD				
4	Floq	169	123	46
5	Orenjë	233	126	107
6	Rinas	115	55	60
7	Gurakuq	156	121	35
8	Ballgjin	126	68	58
9	Zdrajsh Verri	202	131	71
10	Zdrajsh Katund	212	129	83
VI	Njësia Admin.Steblevë	1276	463	813
1	Llangë	236	88	158
2	Zabzun	201	71	130
3	Steblevë	452	119	333
4	Borovë	142	84	58
5	Sebisht	162	89	73
6	Moglicë	37	10	27
7	Prodan	46	12	34
	Totali	9678	5672	4006

Informacion për KLSH, nga Sektori i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës Bujqësore, Bashkia Librazhd.

Për Njësinë Administrative Hotolisht sipërfaqja e tokës ndarë në vitin 01.08.1991 është në sipërfaqen 1465 ha, ku tokë e ndarë sipas ligjit me sipër rezulton sipërfaqja 909 ha, ndërsa tokë e pandarë sipërfaqja 556 ha.

Për Njësinë Administrative Qendër sipërfaqja e tokës ndarë në vitin 01.08.1991 është në sipërfaqen 3028 ha, ku tokë e ndarë sipas ligjit me sipër rezulton sipërfaqja 1904 ha, ndërsa tokë e pandarë sipërfaqja 1124 ha.

Për Njësinë Administrative Polis sipërfaqja e tokës ndarë në vitin 01.08.1991 është në sipërfaqen 950 ha, ku tokë e ndarë sipas ligjit me sipër rezulton sipërfaqja 621 ha, ndërsa tokë e pandarë sipërfaqja 329 ha.

Për Njësinë Administrative Lunik sipërfaqja e tokës ndarë në vitin 01.08.1991 është në sipërfaqen 1249 ha, ku tokë e ndarë sipas ligjit me sipër rezulton sipërfaqja 725ha, ndërsa tokë e pandarë sipërfaqja 524 ha.

Për Njësinë Administrative Orenjë sipërfaqja e tokës ndarë në vitin 01.08.1991 është në sipërfaqen 1710 ha, ku tokë e ndarë sipas ligjit me sipër rezulton sipërfaqja 1050ha, ndërsa tokë e pandarë sipërfaqja 660 ha.

Për Njësinë Administrative Steblevë sipërfaqja e tokës ndarë në vitin 01.08.1991 është në sipërfaqen 1276 ha, ku tokë e ndarë sipas ligjit me sipër rezulton sipërfaqja 463 ha, ndërsa tokë e pandarë sipërfaqja 813 ha.

Ku totali i saj është sipërfaqja 9678 ha tokë bujqësore, nga të cilat tokë e ndarë deri më sot është sipërfaqja 5672ha dhe tokë e pandarë një sipërfaqe prej 4006 ha.

✓ *Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:*

Z.K. G, me detyrë ish- Kryetar i Bashkia Librazhd;

Z.H. H, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Bujqësisë dhe Ushqimit, Bashkia Librazhd;

Z.R. A, me detyrë Përgjegjës i Drejtorisë Bujqësisë dhe Ushqimit, Bashkia Librazhd.

V- Procedurat e ndjekura nga Bashkia për shitjen e asetëve.

Sektori i Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Librazhd nga auditimi i kryer rezulton që nuk ka kryer asnjë transaksion pasurie perfituar me Vendim Këshilli të Ministrave në përdorim, admininsitrim dhe pronësi në favor të saj për periudhën janar 2022 deri më dhjetor 2022.

Ndërsa, Drejtoria e Pyjeve Kullotave dhe Mjedisit e Bashkisë Librazhd nuk ka të drejtën e shitjes së pronave dhënë në favor të saj në adminsitrim dhe në përdorim sipas VKM Nr.433, Datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, ndryshuar me VKM Nr.684, Date 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe

shtesa në VKM Nr.433/2016 të Këshillit të Ministrave si më lart cituar, por i jep ato në përdorim me një afat të caktuar.

Nga auditimi i kryer janë lidhur **5 (pesë)** kontrata për shitjen e lëndëve drusore (asortimente) për periudhën Janar 2022 – Dhjetor 2022 nga Drejtoria e Pyjeve Kullotave dhe Mjedisit e Bashkisë Librazhd me subjekte, ku rezultoi që është kryer likudimi i tyre në vlerën e arkëtuar 4,318,400 lekë (shitje lëndë drusore trupa dhe lëndë ndërtimi) sipas tabelës vijuese:

Shitjet e lëndëve drusore (asortimente) 2022

Nr.	Subjekti	Aministratori	Ekonomia pyjore	Ngastra nr.	Pika e grumbullimit	Lloji	Asortimentet			Kontrata		Likujduar leke
							Trupa m3	Lëndë ndërtimi m3	Nr.	Date	Vlefta	
1	P	A.P	Polis	78a	Rruge auto	Ah	50	11	3933	06.09.2022	330000	330000
2	D-20	Y.D	Polis	80a	Rruge auto	Ah	78	17	3933/1	06.09.2022	1384600	1384600
			D-Xhyre	23a			140	16				
3	N.S	N.S	Polis	154a	Rruge auto	Ah	114	14	3933/2	06.09.2022	710800	710800
4	K.K	K.K	Çemenikë	38a	Rruge auto	Ah	71	17	3933/3	06.09.2022	500000	500000
5	M - 3G	F. M	Klenje, N-Prevall	92a	Rruge auto	Ah	142	25	4900	31.10.2022	1393000	1393000
				52a			73	41				
TOTALI							668	141			4318400	4318400

Burimi DPKM, Bashkia Librazhd.

Gjithashtu vërehet se janë lidhur **7 (shtatë)** kontrata mbi prodhimet e dyta pyjore për periudhën Janar 2022 – Dhjetor 2022 nga Drejtoria e Pyjeve Kullotave dhe Mjedisit e Bashkisë Librazhd me subjekte, ku rezultoi që është kryer likudimi i tyre në vlerën e arkëtuar **134,850** lekë (të prodhimeve të dyta pyjore, zhavor, gurë, bimë mjekësore, tanifere e eterovajore) si më poshtë përshkruar në tabelë:

Shitja e prodhimeve të dyta pyjore

2022

Nr.	Subjekti	Adminstratori	Aktiviteti	Vendndodhja	M-A		Vlefta Leke
					Nr.	Date	
1	H.H	H.H	Gure	Spathar	94	13.01.2022	1750
2	I.P	I.P	Gure	Xhyre	429	16.02.2022	1050
3	B. Ç	B. Ç	Zhavor	Xhyre	792	01.04.2022	3500
4	K.G	T.K	Zhavor	Murrash	812	04.04.2022	7000
5	I.D	I.D	Zhavor	Dardhe	1815	19.07.2022	1050
6	S	K.S	BMTE	D-Xhyre, Polis,Lib.	A. B.	28.09.2022	110000
7	E.E	E.A	Gure, zhavor	Floq	B.	31.10.2022	10500

- Informacion për KLSH, nga DPKM, Bashkia Librazhd.

Konstatohet se, kontratat (të prodhimeve të dyta pyjore, zhavor, gurë, bimë mjekësore, tanifere e eterovajore) bashkëngjitur nuk kanë evidentim të saktë të të dhënave të me procesverbal të zonës ku do ushtroje aktivitetin, nuk ka projektin tekniko-ekonomik i cili i dorëzohet subjektit në momentin e firmosjes së kontrates dhe mandat pagesës së kryer për to, si dhe në dosje të kontratave nuk kemi gjendjen aktuale të subjekteve nga QKB (aktiv ose pasiv në momentin e lidhjes së kontratës). Në asnjë nga kontratat nuk vërehet procesverbal dorëzimi bashkëngjitur pas mbarimit të afatit të kontratës së lidhur ndërmjet DKPM, Bashkia Librazhd dhe subjektet, në kundërshtim me **Ligjin Nr. 57/2020 “Për Pyjet”** dhe **Ligjin Nr.9693/2007 “Për fondin kullosor”** dhe **Udhëzim Nr.1/2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”**.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

Z.K. G, më detyrë ish- Kryetar i Bashkia Librazhd;

Z.B. C, me detyrë, ish-Drejtor i Drejtorisë Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit;

Z.A. B më detyrë Drejtor i Drejtorisë Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit;

Z.Q. F me detyrë Përgjegjës në Drejtorinë Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit.

Pika 3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022 japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

- 3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;
- 3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë;
- 3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

Për auditimin e pikës 3 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2022 të shoqëruar me formatet 1-9.
2. Dokumente kontabël si: ditaret e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2022, libri i aktiveve.
4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2022.
6. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit Librazhd në mbyllje të vitit buxhetor 2022.
8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditaret,shpenzimet te ardhurat etj.).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

• ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Librazhd” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022, VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

• ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Bashkia Librazhd për vitin 2022 nuk ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, pasi nuk ka në varësi njësi shpenzuese me nipt më vete, pasi Agjencia e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsim Kultures i janë bashkuar Aparatit të Bashkisë në vitin 2020.

• ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Librazhd për vitin ushtrimor 2022 me shkresë përcjellëse nr.prot.1125 datë 28.02.2023.Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Sekretari i Përgjithshem Bashkisë Librazhd dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Përgjegjesi Finances. Pra në këtë rast kemi delegime të këtyre detyrave.

• ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klases 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca.Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

• ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mosndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel".
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në centralizator deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përkrahja me vërtetuesi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdheruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- ***Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhen nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të rregjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin rregjistruar janë rregjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2022.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e rregjistruara dhe ngjarjet janë rregjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë rregjistruar në periudhen e saktë kontabël, përveç disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat nuk janë rregjistruar në momentin e celjes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë rregjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhes

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë rregjistruar, ndërsa detyrimet nuk janë rregjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra nuk janë të paraqitura të plota në bilanc, por janë rregjistruar në momentin e pagesës në 6-mujorin e parë të vitit pasardhës, i cili është në vazhdim dhe i pa mbyllur.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitetet, pasivitetet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të rregjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare nuk janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, si dhe janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura .

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, në disa raste nuk janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivitetit dhe të Pasivitetit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabel ne llogarine e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në me formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2022”.

Totali i Aktivitetit për vitin 2022 është në vlerën 2,623,244,472 lekë dhe i paraqitur në formatin nr.1 dhe i zberthyer në llogari sipas aneksit nr.3, bashkangjitur projektraportit të auditimit.

AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 266,888,3555 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “Teprica e likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte” të paraqitur në aneksin nr.3/1 bashkangjitur projektraportit të auditimit.

Në lekë

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”**, sipas bilancit në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 266,888,3555lekë, gjëndje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2022”.

- **Gjendja e llogarisë 532 “Vlera të tjera”** në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 117,258 lekë. Kjo gjëndje përfaqëson vlerën e letrave me vlerë gjëndje në arkë, ku përfshihen biletat e tregjeve. Letrat me vlerë janë bërë hyrje në arkë me çmim shitje dhe janë kryer veprimet kontabël për hyrjet në arkë është debituar Llog 532 “Vlera të tjera” ne kredi te llog 63 “Ndryshim i gjendjeve” dhe për arkëtimet është debituar Llog. 531 “Arka” ne kredi te llogarive të klasës 7.Gjendja e letrave me vlere ne 31.12.2022 eshte 117,258 leke si me poshte:

Emërtimi	Nr. blloqesh	Nr.fletesh/bllok	Cmimi/flete	Vlera ne leke
Bileta tregu	654	100	1.32	86,328
		46	60	2,760
	88	100	3	26,400
		59	30	1,770
Shuma				117,258

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 63,093,001 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 70,036,246 lekë , ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej -6,943,245 lekë rakordon me gjëndjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjëndjet e llogarive:

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 12,241,282 lekë dhenë mbyllje të vitit 2022 në vlerën 16,179, 295 lekë, me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 3,938,013 lekë, e cila përfaqëson shtim të gjëndjes së mallrave ne fund te vitit 2022.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imet ”** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 50,851,719 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 53,856,951 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 3,005,232 lekë, e cila përfaqëson rritje te inventarit te imet per vitin 2022.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 146,430,244 lekë dhenë mbyllje të vitit 2022 në vlerën 163,164,365 lekë , ku kemi pakësim duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i kryerjes se pagesave ndaj kreditoreve te ndryshem ne lidhje me investimet dhe sherbimet e ndryshme.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 118,271,206 lekë dhenë mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 116,726,663 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka pësuar një ulje prej 1,544,543 lekë. Në vlerën e lartë të gjëndjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve të taksave në vlerën 96,164,783 lekë, që zënë 82,4% te vlerës debitore. Pjesa tjetër janë detyrimet e lindura nga rekomandimet “shpërblim dëmi” të lëna nga KLSH në vite, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërimit. Analiza e gjëndjes së llog.

“Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Gjendja e llogarise 468 “Debitorë të ndryshëm” me date 31.12.2022

NR	DEBITORET LLOGARIA 468	GJENDJA ME 01.01.2022	Shtesa per vitin 2022	Shtesa per vitin 2022	GJENDJA ME 31.12.2022
	BASHKIA LIBRAZHD				0
1	I	369,420	530,000	726,870	172,550
2	I.H /V.G	5,000	34,800	31,100	8,700
3	B.C	90,000	382,500	447,500	25,000
4	A.B	49,500	-	49,500	-
5	S.D	41,000	90,000	96,000	35,000
6	L.A	53,100	-	53,100	-
7	F.N	69,000	126,000	192,000	3,000
8	L.T	107,250	90,000	177,000	20,250
9	A.K/ H.SH	4,530		4,530	-
10	B.D+ B.T	3,000	-	-	3,000
11	L.SH	11,500	(10,000)		1,500
12	A.Q	15,000		15,000	-
13	F.R		13,700	13,700	-
14	Komuna S	300,000			300,000
15	Debitorë të tjere	11,120			11,120
16	Debitorë të trashëguar nga ish komunat nga KLSH-se sipas listave	5,999,034			5,999,034
17	Debitorë kopshtet cerdhja sipas listes.	1,871,597	6,348,589	6,465,852	1,754,334
18	Debitorë nga KLSH-ja sipas urdherit nr.452,date.02.08.2017	5,457,784		1,713,697	3,744,087
19	Debitorë per taksa e tatime per bashkine e NJA deri .31.12. 2020.	97,568,066	120,685,158	122,088,441	96,164,783
20	Debitorë nga KLSH-ja sipas urdherit nr.770,date.31.12.2019	1,483,680			1,483,680
21	Debitorë nga KLSH-ja sipas urdherit nr.771,date.31.12.2019	4,761,625			4,761,625
	GJOBA nga IMT	-	4,390,000	2,200,000	2,190,000
	GJOBA nga POLICIA	-	49,000	-	49,000
	Totali	18,271,206	132,729,747	134,274,290	116,726,663

- **Gjendja e llogarisë 4342** “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 46,437,702 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2022 që trashëgohen në vitin 2023 .Kjo gjendje në analizë përfshin gjëndjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.42 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 22,736,753 leke, “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 17,048,179 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 945,929 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 3,378,207 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 2,328,634 lekë .

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga :

- Gjendja e llogarisë **486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 9,977,393 lekë për detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, e cila rakordon gjendjen e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasiv të bilancit.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

.Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçodon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);

- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivët Afatgjata**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,543,691,455 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,097,855,542 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,912,845,568 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,546,376,842, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 20,285,271 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën prej 15,322,571 lekë, diferenca është vlerë e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 30,034,570 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 26,959,038 lekë, Kjo llogari paraqitet me diferenca në rritje prej 72,000 lekë që i përket 1 projekt-programi Alfa për kontabilitet-financë të shtuar gjatë vitit 2022, ndërsa pakësimet në vlerën 3,147,532 leke i përkasin projekt-preventivave për investime, të cilat i janë shtuar vlerës së objekteve të investuara. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar sipas aneksit nr.3/2, në rubrikën e anekseve.

Vlera prej 26,959,038 lekë i përket 27 projekteve, ku 4 projekte i kanë kaluar vlerës së investimeve dhe 23 projekte i përkasin projekt-programe për dixhitalizim të dhënash për tokat, pyjet, kullotat, projekte GIZ e plan rievimi. Ndërsa 11 projekt-preventiva janë për ndërtime e rikonstruksione, ku nga këto nuk janë vënë në përdorim 9 projekte investimesh, të cilat priten të vihen në funksionim në vitet e mëvonshme. Nga këto 2 projekte janë vënë në shfrytëzim në vitin 2022-2023. Këto projekte janë bërë hyrje dhe ruhen në Drejtorinë e Planifikim dhe Zhvillimit Urban dhe Arshivën e Institucionit.

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2020.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,523,691,455 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 2,097,855,542 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,882,810,998 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,546,376,842 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja ellog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 16,766,140 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 18,475,912 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 është në të njëjtën vlerë prej 18,475,912 lekë, pasi nuk ka shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2022. Amortizimi i llogaritur gabim nga ish Komunat është sistemuar. Këto gjendje paraqiten të analizuar sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabel i llogarisë 210 "Toka Troje Terrene" me date 31.12.2022

Nr	Emërtimi i aktiveve sipas Njësive Administrative	Gjendja me 31.12.2022	Shtesa gjate vitit 2022	Gjendja më 31.12.2022
I.	Aparati Bashkia Librazhd Shuma	2,405,843		2,405,843
1	Varrezat publike	144,650		144,650
2	Sistemim i varrezave publike tek fusha e Manes	2,261,193		2,261,193
1	Terrene varrezat e deshmorëve	662,746		662,746
2	Terrene varrezat publike	1,890,000		1,890,000
3	Lulishte VOLOREKU " 1 MAJI"	156,525		156,525
4	Lulishte Pallati dy katsh Lagj.1	51,290		51,290
5	Lulishte pallati 85-88	92,990		92,990
6	Lulishnja te Cerdhje	60,245		60,245
7	Lulishte te tregu	374,225		374,225
8	Varrezat publike (shtese)	246,095		246,095
IV	Drejtoria e Kultures Shuma	11,326,121		11,326,121
1	Toka terrene sportive	2,191,277		2,191,277
2	investime ne fushen e sportit	7,662,929		7,662,929
3	investime ne fushen e sportit	1,471,915		1,471,915
II.	NJESIA ADM.QENDER Shuma	476,872		476,872
1	Prita e mbrojtje tokash	476,872		476,872
III	Njesia Hotolisht Shuma	732,960		732,960
1	Rrethimi I varrezave hotolisht	732,960		732,960
		3,534,116		3,534,116
	BASHKIA LIBRAZH D TOTALI	18,475,912	0	18,475,912

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,662,464 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 4,662,464 lekë. Për këtë gjendje nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës për vlerën 4,662,464 lekë ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për

procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

Titulli gjetjes: *Mbi kontabilizimet në llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 4,662,464 lekë lekë gjendje e cila nuk është e analizuar.*

Situata:

Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,662,464 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 4,662,464 lekë. Për këtë gjendje nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës për vlerën 4,662,464 lekë ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale.

Kriteri:

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

Impakti:

Mungesa e analizës për vlerën 4,662,464 lekë që i përket llog.211 “Pyje, Plantacione” me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku:

Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar në vite.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Librazhd të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: zj. S. O. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe në cilësinë e hartueses së pasqyrave financiare.

- Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 715,760,670 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 680,481,918 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 935,305,353 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 934,289,736 lekë. Gjatë vitit 2022 janë krijuar aktive shtesë në vlerën 8,116,752 lekë, ku vlera prej 565,113 lekë nga rritja e AAGJMme pagesë si: rikonstruksione shkollash, kopshtesh, banja publike etj. Dhe shtesë pa pagesë nga jashtë sistemit në vlerën 7,551,639 lekë, që përfaqëson kalimin kapital Bashkisë Librazhd nga Ministria e Mbrojtjes të vlerës së Repartit Ushtarak në zonën Semez Babje. Pakësimet janë në vlerën 9,132,369 lekë, që përbëjnë vlerën e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit për vitin 2021 për këtë grupaktivesh të miratuara me VKB nr.38, datë 04.05.2022. Analiza e gjëndjes së kësaj llogarije dhe ndryshimet për vitin 2022 paraqiten në Aneks.

- **Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,705,373,704 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në 1,319,203,927 lekë, ku diferenca prej 312,792,125 lekë është amortizimi i llogaritur për vitin 2022. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,737,881,027 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,397,109,919 lekë. Gjatë vitit 2022 janë bërë shtesat në vlerën 111,243,068 lekë, e përbërë nga vlera 95,533,598 lekë përfaqëson investime të kryera me pagesë brenda sistemit në rrugë, kanale vaditëse, ujsjellës etj, nga vlera prej 12,561,938 lekë që përfaqëson investime me pagese jashtë sistemit nga donatorët për Rikualifikim të fshatit Fush-Studenci dhe nga levizjet e brendshme nga shtesa de vlerës prej 3,147,532 lekë të projekt-studimeve të investimeve përkatëse. Gjatë vitit 2022 pakësimet janë në vlerën 452,014,176 lekë, që i përket vlerës së investimeve në Ujsjellësa Bashki e NJA, të cilat i kanë kaluar me VKB-ët përkatëse Ujesjellës Kanalizime sh.a.Librazhd. Analiza e gjëndjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet për vitin 2022 paraqiten në Aneks.

- **Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 13,254,810 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 11,491,304 lekë, ku diferenca është amortizimi i perlllogaritur i vitit ushtrimor për këtë grup aktivesh. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 28,177,753 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 26,203,611 lekë, për të cilat ka inventar fizik. Në këtë grup aktivesh nuk ka shtesa për vitin 2022, por vetëm pakësime në vlerën prej 1,974,142 lekë, e cila përbëhet nga nxjerrjet jashtë përdorimit të këtyre aktiveve në vlerën 1,380,142 lekë të vitit 2021 të miratuar me VKB nr.38, datë 26.04.2022, si dhe vlera prej 594,000 lekë, që përfaqëson kalimin në përdorim të një makine korrëse bari tek Klubi i Sportit Sopot, të miratuar me VKB nr.93, datë 28.10.2022. Analiza e gjëndjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqitet në Aneks.

- **Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 32,753,715 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 32,854,994 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 80,643,383 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 87,442,951 lekë. Shtesat gjatë vitit 2022 përfaqësojnë blerjen e dy mjeteve për Agjensinë e Punëve Publike me vlerë 5,736,000 lekë dhe riparimet e kryerane vlerën 1,063,568 lekë për automjetet e Bashkisë Librazhd. Analiza e gjëndjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve në fund të vitit 2022 paraqiten në Aneksin nr. 3/3, në rubrikën e anekseve:

- **Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 35,119,952 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 30,685,023 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 77,665,106 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 78,192,249 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 2,324,034 lekë e paisjeve dhe transferimet kapitale nga institucionet e tjera qendrore në vlerën 488,608 leke, për të cilat janë ndjekur procedurat financiare e ligjore për evidentimn e tyre. Pakësimet janë në vlerën 2,285,499 lekë, që përfaqësojnë aktivet e inventarit ekonomik të nxjerrë jashtë përdorimi për llogari të vitit 2021, sipas vendimit të KB nr .38, date 04.05.2022.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF, sipas aneksit nr. 3/4, në rubrikën e anekseve:

- **Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale** paraqitet në bilanc në vlerën 2,460,157,767 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

“Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara” është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”pika 36 Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në celje te periudhes ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2022 Bashkia Librazhd

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2022 për Bashkinë Librazhd dhe Njësite Administrative ne varesi.

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit per vitin 2022 kane dalë urdheri me nr,955, dates 30.11.2022 “Per ngritjen e komisioneve te inventarizimit per vitin 2022”.Jane mbajtur procesverbale nga cdo komision .Eshte mbajtur relacion shpjegues per gjendjen e llogarive”si dhe procesverbale per propozim per nxjerrjen jashte perdorimit te materialeve që kanë humbur funksionin e tyre. Te gjitha proceset e kryerjes se inventareve per vitet 2022 janë me dokumentacion bashkëlidhur. Për vitin 2022 nuk janë nxjerre aktive afatgjata jashtë perdorimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventareve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Librazhd dhe për Njësinë Administrative ne varesi. Fletët e inventareve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2022 dhe rezultojnë në diferencë. Nuk është hartuar një relacion përmbledhës për gjithë inventarin e AAGJM, ku të përshkruhen mënyra e ruajtjes së këtyre aktiveve dhe konfirmimi i rezultatit të inventarit.

Konkluzion: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2022 në vlerën **4,546,376,842** lekë është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. **Inventari kontabël i aktiveve materiale** gjendje në fund të vitit 2022 në llogaritë: **210 “Toka, Troje, Terrene”** është në vlerën 18,475,912 lekë; **211 “Pyje, Plantacione”** në vlerën 4,662,464 lekë, **212 “Ndërtesa Konstruksione”** në vlerën 934,289,736 lekë; **213“Rrugë, rrjete, vepra ujore”** në vlerën 3,397,109,919 lekë; **214“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”**në vlerën 26,203,611 leke. Në këto inventare janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas amërtesave të projekteve të investimeve, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale per çdo aktiv.

Për vitin 2022 nga auditimi i procedurës se mbajtjes dhe kontabilizimit te aktiveve rezultoi se çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore, por mungon kartela kontabël për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur, pra në formë analitike në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30.

Konkluzion: Gjendja e **llog. 231“Shpenzime në proces për rritjen e AQT”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 0, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se ka kontrata që kanë përfunduar si punime, por likuidimi është shtrirë në 2-3 vite ushtrimore, për të cilat janë kryer pagesa pjesore sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Nga auditimi i kontabilizimeve të veprimeve ekonomike për kontratat e investimeve me shtrirje kohore likuidimi përtej vitit ushtrimor rezulton se llogarja 231 “Shpenzime për investime në proces” është debituar dhe kredituar për vlera pjesore të paguara,

duke e mbyllur këtë llogari në mënyrë të gabuar pa u kapitalizuar aktivi deri në vlerë të plotë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, kështu në fund të vitit 2022 konstatohet se nga 14 kontrata projektsh kanë mbetur pa u mbyllur për vlerën prej 6,221,225 lekë, vlerë e cila duhet ti përkiste gjendjes debitore llog. 231 "Shpenzime për investime në proces" me datë 31.12.2022. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1, Pika 2 Klasa 2¹si dhe kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32.

Titulli gjetjes: *Mbi kontabilizimet e bëra në llogarinë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT"*

Situata:

Gjendja e llog. 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 0, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se ka kontrata që kanë përfunduar si punime, por likujdimi është shtrirë në 2-3 vite ushtrimore, për të cilat janë kryer pagesa pjesore sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Nga auditimi i kontabilizimeve të veprimeve ekonomike për kontratat e investimeve me shtrirje kohore likujdimi përtej vitit ushtrimor rezulton se llogarja 231 "Shpenzime për investime në proces" është debituar dhe kredituar për vlera pjesore të paguara, duke e mbyllur këtë llogari në mënyrë të gabuar pa u kapitalizuar aktivi deri në vlerë të plotë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, kështu në fund të vitit 2022 konstatohet se nga 14 kontrata projektsh kanë mbetur pa u mbyllur për vlerën prej 6,221,225 lekë, vlerë e cila duhet ti përkiste gjendjes debitore llog. 231 "Shpenzime për investime në proces" me datë 31.12.2022.

Kriteri:

Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1, Pika 2 Klasa 2 si dhe kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32.

Impakti:

Mos evidentim dhe kontabilizim jo i saktë i AAGJM të blera deri në kapitalizmin e tyre.

Shkaku:

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka bërë kontabilizimin direkt në llogarinë AAGJM me vlera pjesore të paguara, ndërkohë kur aktivi nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë të kontratës, pa e kontabilizuar në llog. e ndërmjetme llog. 231 "Shpenzime për investime në proces" deri në momentin e kapitalizimit.

Rëndësia: *I mesme*

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Librazhd të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" deri në vlerë të plotë, dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave ti kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivit të

¹- Për rrjedhim, aktivet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23, "Investime". - Këto janë investime në proces, pra aktivi ende nuk është përfunduar dhe detyrimisht nuk është në funksionim dhe nuk është kapitalizuar. Grupi 23, "Investime" ndahet në dy llogari treshifrore që më tej klasifikohen në nivele shtatëshifrore, sipas karakteristikave të këtyre aktiveve.

- Llogaria 231, "Investime për aktive afatgjata materiale", të analizuar në llogari shtatëshifrore. Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto bëhen funksionale dhe kapitalizohen në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara.

kapitalizuar.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: zj. S. O. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe në cilësinë e hartueses së pasqyrave financiare.

Të dhëna për llogaritë e pasivit të bilancit jepen në aneksin nr.3/5, në rubrikën e anekseve.

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 212,564,288 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Gjendja e kësaj llogarije në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6,085,382 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 22,736,753 lekë, vlerë e cila ka ardhur në rritje, duke shtuar faturat e palikujduara për mallra, shërbime dhe investime të periudhës së fundvitit ushtrimor. Sipas analizës së gjëndjes së kësaj llogarie rezulton se, përbëhet nga 10 fatura të palikujduara ndaj të tretëve, borxh i krijuar në nentor-dhjetor të vitit 2022, ku në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Analiza e llogarisë 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to (mallra e shërbime)”

NR	EMERTIMI	PERSHKRIMI	NR	DATE	Vlera e pa likujduar
1	A. shpk	Blerje fishekzjarre	47/2022	31.12.2022	299,753
2	A.D	Blerje buke per mencen sociale	555/2022	31.12.2022	50,899
3	S.S	Blerje materiela,baner +strukture	29/2022	30.12.2022	33,000
4	E.T	Hostimi faqes se Bashkise Librazhd	32/2022	27.12.2022	40,000
5	SH.A U. L	fatura uji		24.12.2022	158,190
6	S.S	Blerje materiela,baner +strukture	27/2022	23.12.2022	73,000
T O T A L I I L L O G A R I S E 4 0 1					654,842

Analiza e llogarisë 404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to(për investime)”

Nr.	Subjekti	Pershkrimi I Kontrates	Numri fatures	Data	Gjendje 31.12.2022
1	2.	Rikonstruksion i rruges Kraste-Gizavesh	374/2022	28.12.2022	20,710,011
2	E. E	Perpunimi i mbetjeve urbane	209/2022	29.12.2022	432,060
3	G.K	Transport i mjeteve te renda	68/2022	23.12.2022	117,600
4	E. shpk	Rikonstru i shkalleve hyrese te Bashkise Librazhd	211/2022	28.12.2022	822,240
TOTALI I					22,081,911

- **Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 22,736,753 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën kontabël 945,929 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 3,378,207 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës e analizuar si vijon:

b.Sigurimet shoqërore 15% punëdhënësi vlera 3,034,321 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”** në fund të vitit 2022 është në vlerën kontabël 2,328,634 lekë, e cila përbëhet nga:

a.Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarsi vlera 343,886 lekë

b.Sigurimet shëndetësore 1.7% punëdhënësi vlera 343,886 lekë.

Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet si në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 116,843,921 lekë, vlera të cilat rakordojnë me gjendjet e llogarisë kundërpartit 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit.

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin garancitë e ngurtësuar në vlerën 5% të pa likujduar në datën 31.12.2022, për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 39,305,272 lekë.Për këtë gjendje të

Ilogarise 466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Librazhd, ku në mënyrë analitike paraqitet në Anekin nr. 3/6, bashkangjitur projektraportit të auditimit në rubrikën e anekseve.

- **Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të të vonesave të krijuara në kryerjen e procedurave të prokurimit, në lidhjen e kontratave apo në mbërritjen me vonesë të faturave dhe si rezultat bllokimi i transaksioneve financiare nga MFE në ditët e fundit të dhjetorit të vitit ushtrimor. Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 19,778, 698 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 9,977,393 lekë me një diferencë në zbritje prej 9,801,305 lekë lekë në krahasim me vitin 2021, e cila tregon për punë impenjative nga bashkia Librazhd për uljen e detyrimeve të papaguar ndaj të tretëve, duke mos i lënë vend akumulimit të këtyre detyrimeve. Nga analiza e kësaj gjendje rezultoi se janë kryesisht detyrimet të lindura nga mbajtja e penalteteve nga Bashkia dhe nga rekomandimet shpërblim të lënë nga KLSH-ja, të cilat janë në procese gjyqësore, të evidentuara në kontabilitet. Analiza e kësaj llogarije paraqitet në Aneksin nr. 3/8, bashkangjitur projektraportit të auditimit.

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2022 paraqitet në Aneksin nr. 3/7, në rubrikën e anekseve.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 1,229,813,748 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Librazhd paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet” paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën **83,204,140** lekë, i cili kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 3,788,125 lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e palujtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 19,885,880 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 40,740,086 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndricimit, zënie hapësire publike, qirate për truallin.etj.

- Gjendja e llogarisë sintetike **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 76,832,850lekë, i cila kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndermarrjet dhe pronesia”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 41,883,938 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet i cili kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 34,948,912 lekë, e cila përfshin tarifën e parkimit, kamatvonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** në vlerën prej 9,977,393, e cila kësaj llogarije rakordon me llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”,

Analiza e shpenzimeve në vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 1,002,347,923 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 230,555,705lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 230,555,705lekë diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 38,327,711lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 38,327,711 lekë , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 132,356,204 lekë dhe sipa aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 132,356,204 lekë , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente te brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 17,230,403 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 17,230,403 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime per Buxhetet familjare e Individe”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 590,821,145 lekë, e cila rakordon me aktrakordin me Thesarin.

Per vitin 2022 totali i te ardhurave ne vlerë është 1, 229,813,748 lekë dhe totali shpenzimeve është 1,002,347,923 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 227,465,825 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022 është në vlerën -6,943,245 lekë .

Formati nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit”

- Zeri "Burimet për investime" Formati 6, i plotësuar për shumën 129,044,030 lekë në analizë tregon burimet e investimit, vlera prej 105,294,313 lekë fonde të akorduara per investime, vlera prej 20,602,185 lekë investime te dhuruara nga donatore vendas.

- Zëri **“Shpenzime per Aktive Afatgjata materiale”** formati 6 e plotësuar për shumën **128,972,030** lekë në analizë rakordon me pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” kolona 4 formati 7/b.

Nga testi kontrollit për vitet 2022 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve.gjendja e arkës nuk e kalon limit e arkës. Për të gjitha arkëtimit ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likujduese të institucionit. Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kreut III pika 34 dhe 35 gjerat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 "Për limitin e arkës".

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi

dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Komente nga subjekti i audituar: Observacioni i sjellë me shkresën nr.4897, datë 19.07.2023, e sjelle me imail nga z. A.A për konstatimin e grupit të KLSH për respektimin e afatit 30 ditë të realizimit të pagesave nga data e paraqitjes së faturës paraqet pretendimin se: “Për pagesat jashtë afatit 30 ditë nga paraqitja e faturës (fq nr 61-62) sqarojmë se, nga ana jonë është respektuar afati sipas Udhëzimit plotësues nr.1 datë 10.01.2022 “ Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022” kreu III pika 126 në të cilin citohet “Stok i detyrimeve të prapambetura konsiderohen të gjitha llojet e detyrimeve financiare të konstatuara dhe të paguara ndaj të tretëve ,të cilat rezultojnë të pa paguara prej mbi 60 ditë kalanderike që nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik ,si dhe ato pas afatit të përcaktuar në legjislacionin përkatës” dhe është punuar me korrektesi për kontrollin e shpenzimeve dhe likuidimin në kohë për mos krijimin e detyrimeve.

Qendrim i grupit të auditimit:Ky observacion merret në konsideratë, pasi ka argumentim ligjor, gjë e cila është reflektuar në material, duke e hequr si konstatim dhe shkarkimin nga përgjegjësia e zj. A.A

Pika 4.1- 4.3. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Librazhd (regjistrat e parashikimit dhe realizimit), për periudhën 01.01.2022 – 30.04.2023, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Procedura 01/01/2022 - 30/04/2023	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHESEJ	44	528,998,057	412,590,360
-Të hapura	11	408,107,106	300,948,451
-E Hapur e Thjeshtuar	33	120,890,951	111,641,909
Sipas objekteve	44	528,998,057	412,590,360
-Objekte në fushën e investimeve	22	440,625,885	329,148,742
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	22	88,372,172	83,441,618

Burimi: Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Librazhd

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2022– 30.04.2023, janë realizuar gjithsej **44** procedura me fond limit 528,998 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 412,590 mijë lekë pa TVSH, me një diferencë për vlerën 116,407 mijë lekë ose 22%, nga e cila: **për vitin 2022** janë realizuar gjithsej **31** procedura me fond limit 314,501 mijë lekë dhe vlerë kontrate 248,742 mijë lekë, dhe për 4 mujorin e parë të **vitit 2023** janë realizuar **13** procedura me fond limit 214,496 mijë lekë dhe vlerë kontrate 163,848 mijë lekë.

Sipas llojit të aktivitetit, konstatohet se në fushën e ndërtimit (investime), janë **22** procedura me fond limit 440,625 mijë lekë ose 50% e kontratave të lidhura dhe në të tjera janë **22** procedura me fond limit 329,148 mijë lekë.

Procedura të llojit “E Hapur” janë 11 procedura me fond limit 408,107 mijë lekë, ose 77% e fondit të prokuruar.

Kanë marrë pjesë në procedura **108** OE/BOE dhe janë s’kualifikuar **12** OE/BOE ose 11%.

Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **20** procedura ose 45% e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë **24** procedura, ose 54% e tyre.

Lidhur me procedurat e prokurimit për blerje të vogla, përgjatë periudhës objekt auditimi, janë kryer 33 procedura me fond limit 16,162 mijë lekë, dhe vlerë kontrate 13,546 mijë lekë.

Mbi bazën e materialitetit dhe riskut të bërë nga Grupi i KLSH, nga **44** procedura me vlera të larta me fond limit 528,998 mije lekë janë vlerësuar për auditim **26** procedura me fond limit 481,674 mijë lekë ose 91% e fondit limit, ku shkeljet sipas procedurave dhe problematikave paraqitet si më poshtë vijon:

Titulli i gjetjes: KLSH-ja, konstatohet se në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2022 - 30.04.2023, janë konstatuar kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST, të miratuar nga AK-ja.

Situata: Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2022 – 30.04.2023, janë realizuar gjithsej **44** procedura me fond limit 528,988 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 412,590 mijë lekë pa TVSH, me një diferencë për vlerën 116,407 mijë lekë ose 22%, nga e cila: **për vitin 2022** janë realizuar gjithsej **31** procedura me fond limit 314,501 mijë lekë dhe vlerë kontrate 248,742 mijë lekë, dhe për 4 mujorin e parë të **vitit 2023** janë realizuar **13** procedura me fond limit 214,496 mijë lekë dhe vlerë kontrate 163,848 mijë lekë.

Grupi i KLSH-së, referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut nga **44** procedura me fond limit 528,988 mije lekë, ka vlerësuar për auditim **26** procedura me fond limit 481,674 mijë lekë ose 91% e fondit limit, nga e cila: për vitin 2022 nga **31** procedura me fond limit 314,501 mijë lekë janë audituar **19** procedura me fond limit 286,721 mijë lekë ose 91% e vlerës së fondit limit, dhe për 4 mujorin e parë të **vitit 2023** nga **13** procedura me fond limit 214,496 mijë lekë janë audituar **7** procedura me fond limit 194,953 mijë lekë ose 91% e vlerës së fondit limit.

Nga auditimi i **26** procedurave me fond limit **481,674** mijë lekë, janë konstatuar në **21** raste kritere jo në përputhje me kuadrin rregullator, në **18** procedura OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, në vlerën **283,022 mijë lekë** pa TVSH dhe në **1** rast kontrata duhej ndarë në lote veprime në kundërshtim me ligji nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenet 2, 36, 39, 77, 82, 92, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 26, 39, 40, 42, 88,” konkretisht sipas periudhave:

- a- **Për aktivitetin e vitit 2022**, nga auditimi i **19** procedurave me fond limit 286,721 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP **16** raste ku kriteret e aplikuar nga AK nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator, në **13** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Librazhd, pasi ka mangësi

në plotësimin e tyre dhe në **1** rast procedura duhej ndarë në lote.

- b- Për aktivitetin e 4 mujorit të partë të vitit 2023**, nga auditimi i **7** procedurave me fond limit 194,953 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP **5** raste kriteret e aplikuar nga AK nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator, dhe në **5** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Librazhd, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre.

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: Neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”; Neni 36, “Specifikimet teknike”, Neni 39, “Ndarja e kontratave në lote”, Neni 77, “Kërkesat për kualifikim”, Neni 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Neni 92, Shqyrtimi i ofertave”: VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 26, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, Neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave, Neni 42 “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote”, Neni 88, pika 3, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”.

Shkaku: Mos vlerësimi i drejtë i kriterëve dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe aplikimi i kriterëve jo në përputhje me kuadrin rregullator.

Ndikimi: Aplikimi i kriterëve jo në përputhje me kuadrin rregullator, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST për vlerën **283,022 mijë lekë**.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Librazhd, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen fitues të OE të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 4, 5 dhe 8, nga anëtarët e KVO, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *1. Anëtarët e KVO kanë paraqitur observacion që lidhet me procedurat e mëposhtme:*

- 1. “Rikonstrukcion i rrugës Mirakë Gjovac , Nj.Ad. Polis “.*
- 2. ” Ndërtim Central Park, Faza e II”.*
- 3. “Sistemin Asfaltim i rrugës se fshatit Spathar, Loti I”.*
- 4. “Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Plane, Nj.Ad. Polis”*
- 5. “Ndërtim i bazamenteve te urës në përroin e Rinasit , fshati Gurë Kuq”*
- 6. Vendtakimi i përroit Sheh, Polis me lumin e Gostimes , Nj.Adm.Polis (faza II)”.*

- Ne te gjitha procedurat e prokurimit ne te cilat kemi qene anëtarë , kemi dhënë vendime te cilat kemi gjykuar se janë te sakte dhe qe ne te gjitha procedurat kemi vlerësuar duke marre ne konsiderate si faktor baze ofertën ekonomike me te favorshme dhe me çmim me te ulët. Edhe nëse një OE me oferte ne vlere me te ulet ka patur disa ane teknike, për te cilat kemi vlerësuar qe nuk kane ndikim thelbësor për te skualifikuar një OE, ne e kemi kualifikuar dhe shpallur fitues ne mënyrë te tille qe te mirë menaxhohen fondet buxhetore, dhe për te kursyer fondin buxhetor.

Komisioni i Vlerësimit te ofertave, ne baze te materialeve qe disponohen ne dosjet e prokurimit por edhe nga verifikimi ne Sistemin e Prokurimit publik arsyeton se duhet te merret për baze dhënia e këtij opinionini

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

- 1.Për procedurat e vlerësuara nga ana juaj të cituara më sipër pjesë e këtij observacioni, konstatohet se në përgjithësi nga ana juaj është synuar në thujtje gjitha rastet kualifikimi dhe vlerësimi i ofertës me vlerë më të ulët, fakt i cili është evidentuar dhe pasqyruar në Akt Konstatimet e mbajtura pranë Bashkisë*

Librazhd. Audituesit, sqarojnë se pavarësisht përzgjedhjes së ofertës ekonomikisht më të favorshme, si rezultat i së cilës janë kursyer fonde për buxhetin e Bashkisë Librazhd, audituesit sqarojnë, se krahas këtij vlerësimi, anëtarët e KVO kanë për detyrim ligjor respektimin e legjislacionit të prokurimit publik, ku OE duhet të kualifikohen dhe shpallen fitues vetëm në rastet kur ata plotësojnë të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit....kjo në respektim të pikës 3 të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

AK, në vijim të frymës së ligjit të prokurimit publik, mundet që për mangësi apo devijime të cilat në thelb nuk cenojnë zbatimin e kontratës, ta vlerësojnë një ofertë të vlefshme sipas paragrafit të dytë të dispozitës së cituar më sipër. Pikërisht, ky moment nuk është përcaktuar nga anëtarët e KVO, të cilat duhej që për këto mangësi të vogla, të bënin evidentimin e tyre duke e pasqyruar me procesverbalet përkatëse dhe të ishin pjesë e dosjes së procedurës.

-Në çdo rast, audituesit bëjnë me dije se do vlerësohen mangësitë e pasqyruara, duke vlerësuar rast pas rasti rëndësinë që mund të kenë kriteret e pa plotësuara në zbatimin e kontratave.

Procedurat e periudhës 01.01.2022 – 31.12.2022

Për periudhën 01/01/2022 – 31/12/2022, nga Bashkia Librazhd referuar të dhënave të regjistrimit të prokurimeve ka kryer gjithsej **31** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 314,501 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 248,742 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 65,759 mijë lekë pa TVSH ose 21 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01/01/2022 - 31/12/2022	Nr.	VI.Fond Limit	VI.Kontrate
GJITHESEJ	31	314,501,795	248,742,108
-Të hapura	7	224,513,269	165,510,342
- E Hapur e Thjeshtuar	24	89,988,526	83,231,766
Sipas objekteve	31	314,501,795	248,742,108
-Objekte në fushën e investimeve	16	260,450,382	197,280,323
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	15	54,051,413	51,461,785

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **72** OE/BOE, nga të cilat janë s’kualifikuar **7** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **13** procedura ose 42% e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 16 ose 51% e tyre.

Të dhëna të hollësishme për procedurat e prokurimit publik në formë tabele, jepen në aneksin nr. 4, bashkangjitur projektraportit të auditimit.

-Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).

1. Tenderi me objekt: “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve rurale, gabiona teli, tombino betoni etj”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale për mirëmbajtje te rrugëve rurale, gabiona teli, tombino betoni etj.”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.284, datë 04.04.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 14.09.2022. 1. S. K - (Pergj.Sektori Prokurime) 2. M. G- (Pergj. Sekt. Transportit) 3. M.D – (Sp. Sektori Finances)	3.Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr. 285 datë 04.04.2022. 1. Ç. V – (Kryetar) 2. E. Ç – (Anëtar) 3. S. A – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e Thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 3,333,333 leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: BOE “H” shpk & “K” shpk , me ofertë 3,065,500 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 06.05.2022, me afat 12 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 267,833 - lekë pa tvsh

8. Data e hapjes së tenderit: 15.04.2022	9. Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender – 2 OE b) Skualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 2 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për vlerësimin e ofertave.

Situata: Vlerësimi i ofertave 1.OE “H” shpk nuk përmbush kriterin e pikës **3.1 të DST** për paraqitjen e certifikatave ISO 9001 dhe ISO 14001, certifikata të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit dhe të akredituara nga organizma kombëtar të akreditimit ose nga organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

-Sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit, OE “H” shpk, ka marrë përsipër kryerjen 80% të kontratës. Nga zëra që ka preventivi, 7 prej tyre janë marrë përsipër nga ky subjekt, ndërkohë nuk rezulton nga dokumentacioni i paraqitur në sistem që ky OE të disponojë certifikatat ISO të cituara më sipër, në kundërshtim me pikën **3.1 të DST** si dhe nenit 88 pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në hartimin e kriterëve të veçanta, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e KVO.**

Ndikimi: Nuk jep garanci për cilësinë e produkteve sipas certifikimeve të nevojshme.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 4, nga anëtarët e KVO, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *1. Për sa me lart, Komisioni Vlerësimit Ofertave ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin e bashkimit të operatorëve “H shpk & K shpk” për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale për mirëmbajtje të rrugëve rurale, gabiona teli, tombino betoni etj” dhe për sa i përket certifikatave ISO 9001 dhe ISO 14001, janë dorëzuar nga bashkimi i operatorëve konkretisht “K.” shpk në sistem dhe fizikisht.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

-Observacioni juaj nuk pranohet, pasi nuk keni paraqitur prova apo argumente për të kundërshtuar përmbajtjen e gjetjes së audituesve, të cilat sqarojnë se OE “H” shpk i cili ka marrë përsipër 80% të kontratës, nuk disponon certifikatat ISO të nevojshme, kjo sipas përcaktimit të nenit 88 pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Tenderi me objekt: “Riparime të shtresave asfaltike në Nj.Administrative dhe në Bashkinë Librazhd”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Riparime të shtresave asfaltike në Nj.Administrative dhe në Bashkinë Librazhd”		
1.Urdhër Prokurimi: 628, dt. 03.08.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 10.08.2022. 1. S.K - (Pergj.Sektori Prokurime) 2. J.M - (Pergjegjes Urbanistikes) 3. A.P - (Sp. Sektori Urbanistikes)	3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 628/1 datë 3.8.2022. 1. B.B - (Kryetar) 2. B.M - (Anëtar) 3. S.A - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e Thjeshtuar”		

5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 4,156,064 leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: OE "B.N." shpk me ofertë 4,057,131 Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 20.09.2022, me afat 5 dite.	7.Diferenca me fondin limit: 98,933 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit : 22.08.2022.	9.Burimi Financimit: Bashkia Librazhd.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender – 1 OE b)Skualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12.Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **3.1/a e DST** e cila kërkon nga OE punë të ngjashme për një objekt të vetëm **sa** 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet është kërkesë e hartuar gabim dhe në kundërshtim me pikën 5 germa a të VKM-së nr. 0285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, e cila nuk përcakton lidhësen **sa** por e kërkon në një vlerë jo më të madhe se...

2.Kërkesa e pikës **3.3 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 9 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

3.Kërkesa e pikës **3.7/c e DST**, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t'u kërkohej që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesë janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikim të padrejtë për OE.

3.1.Gjithashtu, në pikën **3.7/b të DST**, NjP ka përcaktuar se *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre.* Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.* Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

Vlerësimi i ofertave: 1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **3.7 të DST** për 2 mjete dhe konkretisht:

-Për mjetin Grejder, ka paraqitur si dokument Deklaratën Doganore me nr. R20042. Ky mjet rezulton me goma, vetëlëvizës, i cili regjistrohet në regjistra publikë, dhe për të është e nevojshme pajisja me dokumentet si leje qarkullimi, policë sigurimi dhe akt kolaudimi, si dhe të paguhen taksat vjetore të mjetit, detyrim i cili rezulton i papërmbushur nga ky OE.

-Për mjetin Autobitumatriçe, është paraqitur një mjet autobot, i cili nuk rezulton të jetë autobitumatriçe, si dhe një faturë tatimore si dhe deklarata doganore me nr. R66947 për blerje

cisternë për përzierjen e bitumit. Në DST kërkohet ekzakhtësisht autobitumatriçe, ndërkohë OE nuk ka provuar se disponon mjetin sipas parametrave të kërkuara nga NJP.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NJP* si dhe *anëtarët e KVO*.

Ndikimi: Prokurim të fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **4,057 mijë lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 4, nga anëtarët e NJP, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *1. Lidhur me pikën 2 të gjetjes për pikën 3.3, sqarohet se periudha kohore për dëshminë punëtore 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, argumentojmë se ky përcaktim nuk është aspak kërkesë e paargumentuar dhe është në përputhje me LPP dhe RRPP. Periudha kohore 3 muajt, është një periudhe kohore tepër e shkurtër duke marrë në konsideratë grafikun e punimeve për realizimin e kontratës. Fakti që ligji përcakton psh., kërkimin e punëve të ngjashme për një periudhe kohore mbi 2 vite, e bën këtë kërkesë për dëshmitë për disponimin e fuqisë punëtore të pranueshme dhe tepër të thjeshtë për tu përmbushur nga OE. Edhe nga asistenca që APP ka bërë AK, për këtë objekt prokurimi e ka gjykuar të sakte dhe të rregullt formulimin e kriterit të veçantë pika 3.3 të DST, si një institucion kompetent që mbikëqyr dhe këshillon / asiston AK për mbështetjen në ligj dhe në aktet normative të prokurimeve publike.*

2. Lidhur me pikën 3 për 1 inxhinier ndërtimi profili transport, sqarohet se është kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit dhe është kërkuar si staf mbështetës dhe jo si drejtues teknik në licencë, çka mund të plotësohet nga OE të interesuar edhe nëpërmjet një kontrate të thjeshtë pune. Duke patur në konsideratë që kemi të bëjmë me asfaltim rruge të një zone të ndryshme, kemi gjykuar dhe argumentuar që është e nevojshme që kompania e cila do të zbatojë punimet të ketë të punësuar edhe një inxhinier ndërtimi profili transport.

3. Lidhur me pikën 4 për mjetet dhe makineritë e nevojshme, sqarohet se është kërkuar ndër të tjera që mjetet me qira të kenë në objekt të tyre edhe objektin e kontratës, për të garantuar që mjetet do të jenë në dispozicion të realizimit të veprës dhe jo në objekte të tjera. Kjo kërkesë është përcaktuar për të garantuar që punimet të realizohen në kohë dhe në cilësi.

-Anëtarët e NJP, sqarojnë se procedura është mbikëqyrtur nga APP, e cila ka dhënë rekomandimet përkatëse, dhe për çështjet e cituara nga audituesit nuk ka pasur rekomandimet.

Në dosjet e procedurës gjenden të argumentuara hartimi i preventiveve, specifikimet teknike, grafiku i punimeve, projekti etj, të hartuara nga specialistët e fushës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Pretendimet e paraqitura për fuqinë punëtore e cila kërkohet të disponohet 3 muajt e fundit, kërkesë kjo e vendosur në të gjitha procedurat, është kërkesë e cila potencialisht mund të çojë në kufizim të pjesëmarrjes së OE, ndërkohë që sipas dispozitës së cituar nga audituesit në situatën e gjetjes, kriteret e vendosura në VKM-në që rregullon procedurat e prokurimit publik, AK mund të kërkojnë nga OE fuqinë punëtore të nevojshme për zbatimin e kontratës, pa përcaktuar konkretisht periudha të shtrira në kohë. Pikërisht, ky fakt mund të çojë në s'kualifikim të padrejtë për OE, të cilat në momentin e aplikimit për të përfituar fonde publike pranë Autoritetit tuaj Kontraktor, plotëson kushtet, por të shtrira në kohë mund të ketë mangësi të numrit të stafit të kërkuar. Për AK duhet të jetë e nevojshme dhe e arsyeshme, që në kërkesa për fuqinë punëtore t'i referohet periudhës më të afërt, që përkon me muajin e fundit, kjo për të krijuar mundësi për sa më shumë ofertues të cilat plotësojnë kapacitet tjera teknike. Audituesit, citojnë dhe gjykojnë që kjo gjetje të qëndrojnë pjesë e raportit, pasi pavarësisht se nuk ka ndikuar në vlerësimin e kryer nga KVO, potencialisht ka ndikuar ose mund të ndikojë në të ardhmen në paraqitjen e ofertave nga OE.

-Duke qenë se kjo gjetje rezulton e përhapur në shumicën e procedurave tjera të kryera nga AK, Bashkia Librazhd, qëndrimi i audituesve është i njëjtë, dhe për shkak të mos përsëritjes së fakteve, kjo gjetje dhe ky qëndrim do vijoj të jetë i njëjtë edhe për rastet tjera të trajtuara më poshtë në këtë Projekt Raport.

2.Lidhur me pikën 3 të gjetjes që lidhet me inxhinierin e ndërtimit profili transport, do pranohet observacioni juaj, kjo pasi referuar edhe qasjes së komisioneve përgjatë procedurave të tjera të ndjekura përgjatë vitit 2023, kanë ruajtur si standard që për procedurat me objekt shtrim apo rikonstruksion rrugës, të kërkohet edhe ekspertiza e inxhinierit të ndërtimit i profilit transport, qasje e cila nuk është e njëjtë përgjatë procedurave të vitit 2022.

3.Lidhur me pikën 4 që ka të bëjë me kërkesën për mjetet dhe makineritë me qira, për të cilat kërkohet që të kenë të shtua në të objektin e prokurimit, audituesit sqarojnë se ky pretendim nuk pranohet, kjo pasi kërkesa potencialisht mund të çoj në s'kualifikimin të padrejtë të OE, të cilat disponojnë të gjitha kapacitetet e nevojshme teknike (mjete + makineri) për zbatimin e kontratës, por vetëm për shkak të mos përcaktimit të objektit të prokurimit në kontratë të kryhet s'kualifikimi i tyre. Audituesit, njëkohësisht siç kanë konstatuar edhe përgjatë auditimit, ky kriter ka rezultuar arsye s'kualifikimi në disa prej procedurave, çka nënkupton se edhe vetë KVO është vendosura përpara arsyeve jo esenciale për s'kualifikimin e OE. Nuk përbën kriter i cili jep garanci shtesë AK për seriozitetin apo potencialin që kanë për zbatimin e kontratave.

-Duke qenë se kjo gjetje rezulton e përhapur në shumicën e procedurave tjera të kryera nga AK, Bashkia Librazhd, qëndrimi i audituesve është i njëjtë, dhe për shkak të mos përsëritjes së fakteve, kjo gjetje dhe ky qëndrim do vijoj të jetë i njëjtë edhe për rastet tjera të trajtuara më poshtë në këtë Projekt Raport.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 4, nga anëtarët e KVO, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1173/7-29 prot., datë 28.03.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *1. Ne lidhje me piken, për dokumentacionin e mjetit Grejder, AK ka specifikuar se për mjete te cilat nuk janë regjistruar ne regjistër, pranohet fatura/deklarata. Mjeti Grejder është klasifikuar si makineri e rende ndërtimore dhe ka specifikime te tjera për mënyrën e regjistrimit te saj, sipas parashikimeve te Kodit rrugor dhe kuadrit ligjor ne fuqi për qarkullimin e mjeteve.*

2. Persa i përket, pikës se dyte, për mos përmbushjen e kriterin ne mënyrë eksplicite sipas kërkesave te parashikuara ne DST, komisioni i vlerësimit te ofertave e ka pare te arsyeshme klasifikimin si te vlefshme ofertën e OE për te mos krijuar diskriminim dhe për te gene te paanshëm, objektiv.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Observacioni juaj nuk pranohet, pasi nuk argumentohet teknikisht dhe ligjërisht nga ana juaj. Audituesit sqarojnë se kërkesa për mjetin grejder rregullohet sipas nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Gjithashtu për mjetin autobitumatriçe, përveç komenteve – opinion, observuesit nuk kanë paraqitur pretendimet të cilat mbështeten në dokumente ligjore.

3. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Krastë – Gizavesh, Bashkia Librazhd”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Rrugës Kraste – Gizavesh, Bashkia Librazhd”		
1.Urdhër Prokurimi: 664, dt. 30.08.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 01.09.2022. 1. S .K (Pergj.Sektori Prokurime) 2. J .M - (Përgjegjës Urbanistikes) 3. J.B - (Sp.Sektori i Urbanistikes)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 664/1 datë 30.08.2022. 1. E .P - (Kryetar) 2. B .B - (Anëtar) 3. S .A - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur ”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 98,505,655 leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: “OE “2.” me ofertë 57,516,136 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 08.11.2022, me afat 8 Muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 40,989,519 - lekë pa tvsh

8. Data e hapjes së tenderit: 19.09.2022.	9. Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë dhe Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender – 5 OE b) Skualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar: 5 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1. Kërkesa e pikës **3.3 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 70 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2. Kërkesa e pikës **3.6 në DST** e cila kërkon 5 shoferë dhe 4 manovratorë, është kërkesë e cila nuk përputhet me atë të kërkesës së pikës **3.10 të DST** për numrin e mjeteve të kërkuara për të cilat kërkohen shoferët dhe manovratorët. Konkretisht janë kërkuar 12 mjete për të cilat është e nevojshme disponimi i shoferit, dhe po 12 mjete tjera për të cilat kërkohet disponimi i manovratorit për drejtimin e tyre. Sa më sipër, konstatohet një mos përputhje dhe mos argumentim nga ana e NJP për hartimin e këtij kriteri. Sa më sipër, kemi një numër të lartë mjeteve të kërkuara, të cilat AK nuk i argumenton me volumet konkrete në raport me periudhën e gjatë 8 mujore të kërkuar për zbatimin e punimeve dhe njëkohësisht se si do drejtohen këto mjete kur është kërkuar ky numër i kufizuar drejtuesish.

3. Kërkesa e pikës **3.10/c e DST**, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesë janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikim të padrejtë për OE.

3.1. Gjithashtu, në pikën **3.10/b të DST**, NJP ka përcaktuar se *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre*. Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*. Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

Vlerësimi i ofertave: 1. OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku OE ka zhvilluar veprimtarinë e tij për vitin 2022. Pavarësisht se sipas deklaratës së dhënë ky OE ka deklaruar se ka likuiduar të gjitha detyrimet vendore për këstet e maturuara për vitin 2022, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur kanë rezultuar njësi të vetëqeverisjes vendore në të cilat ky OE ka aktualisht adresa të hapura për të cilat nuk ka provuar se ka likuiduar detyrimet vendore. Konkretisht, në ekstraktin e QKB, ky OE rezulton se ka adresa të hapura në Bashkitë Durrës, Kamëz, Mallakastër dhe Devoll, ndërkohë nuk ka provuar me dokumentacion se ka likuiduar

detyrimet vendore pranë këtyre bashkive, duke mos përmbushur kriterin sipas deklaramit të dhënë.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **3.10 të DST** për disa nga mjetet e kërkuara pasi janë konstatuar mangësi si vijon:

a.Për 1 Autopompë betoni, është deklaruar mjeti me targa AA837IF në pronësi të subjektit ofertues. Për këtë mjet, rezulton se është paraqitur një certifikatë transporti e cila është lëshuar në emër të subjektit “D. K.” shpk, dhe jo në emër të subjektit ofertues.

b.Për 1 kamion me vinç, është deklaruar mjeti me targa AB482CF. Certifikata e transportit e paraqitur rezulton të jetë për mjetin me targa AA615GH, ndërkohë që edhe fotot e paraqitura për mjetin mbajnë targën AA615GH e cila është e ndryshme me atë të deklaruar nga OE.

c.Për 4 ekskavator me goma, janë paraqitur 4 mjete, dokumentacioni i të cilave janë deklaratat doganore për 3 mjete dhe 1 faturë tatimore shitje për mjetin tjetër. Dokumentacioni i paraqitur për këto mjete (ekskavator me goma), është i pamjaftueshëm pasi nuk përmbushin detyrimet ligjore sipas përcaktimit të nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Urdhrit nr. 200, datë 16.05.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë neni 8 dhe neni 17. Për këto mjete, është e nevojshme që për lëvizjen në rrugë, duhet të pajisen me leje qarkullimi, policë sigurimi, aktin e kontrollit teknik, detyrim i cili nuk është përmbushur nga OE.

d.Për 1 Grejder, mjet i cili rezulton me goma, është paraqitur si dokumentacion vetëm deklarata doganor me nr. R 60665. Në kushtet e një mjeti vetëlëvizës me goma, ky mjet është në kushtet e cituara më sipër (në germën c), për të cilën duhej të dispononte me leje qarkullimi, policë sigurimi, aktin e kontrollit teknik, detyrim i cili nuk është përmbushur nga OE.

e.Për 1 Autobitumatriçe, është deklaruar mjeti me targa AB549CJ. Për këtë mjet nuk është paraqitur certifikata e transportit. Njëkohësisht, në fotot e paraqitura, mjeti rezulton me targa DR7405E dhe disa mbishkrime që lidhen me një subjekt tjetër (V.).

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi: anëtarët e NjP si dhe anëtarët e KVO.***

Ndikimi: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **57,516 mijë lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 4, nga anëtarët e NJP, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Prezimet e subjektit: 1. Kërkesa e pikës 3.5 të DST, për 3 punonjës teknik ndërtimi, është një kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit dhe është kërkuar si staf mbështetës dhe jo si drejtues teknik në licencë , çka mund të plotësohet nga OE të interesuar edhe nëpërmjet një kontrate të thjeshtë pune. Duke patur në konsideratë që kemi të bëjmë me asfaltim rruge të në zone rurale, kemi gjykuar dhe argumentuar që është e nevojshme që kompania e cila do të zbatojë punimet të ketë të punësuar edhe teknike ndërtimi të mjaftueshëm.

2. Kërkesa e pikës 3.6 dhe 3.10 të DST, për mjetet e kërkuara, janë kërkesa të cilat përputhen me objektin e prokurimit, zërat e punimeve dhe specifikimet teknike të kërkuara. Gjithashtu për çdo procedurë prokurimi Titullari i AK, ka ngritur grup pune të veçantë për përlllogaritjen e fondit limit, hartimit të kriterëve të veçanta teknike, listës së mjeteve, grafikut të punimeve etj. Njësia e Prokurimit mbështetur në analizën teknike dhe ligjore të këtij komisioni ka përcaktuar edhe në DST, formulimin e kriterëve teknike të veçanta në DST, sikurse kriteri 3.6 dhe 3.10 në DST, përfshirë stafin teknik, mjetet e nevojshme, shoferë, manovratorët etj. Vendosja e çdo kriteri të veçantë është e dokumentuara dhe argumentuar teknikisht dhe ligjërisht me dosjen teknike të përlllogaritjes së fondit limit. Theksojmë faktin që mjetet janë argumentuar që do të përdoren në periudha kohe sipas proceseve të punës dhe jo të gjitha në të njëjtën kohë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
 3.Lidhur me pikën 3.5, pranohet pretendimi juaj, por audituesit sqarojnë se njëlloj siç është vendosur edhe në raste tjera të ngjashme në vijim, kërkesat për teknikë ndërtimi duhet të jenë më të arsyeshme, dhe jo të kërkohet numër i lartë i tyre.
 2.Lidhur me pikën 3.6 dhe 3.10 që lidhet me numrin e manovratorëve dhe të mjeteve të kërkuara, audituesit sqarojnë se ky pretendim nuk qëndron, pasi në mënyrë të përhapur mungon një përllogaritje e numrit të manovratorëve dhe mjeteve të kërkuara. Konstatohet numër i vogël manovratorësh në raport me numrin e mjeteve. Duhet një optimizim i kësaj kërkesë ku raporti ndërmjet manovratorëve të kërkuar dhe mjeteve të nevojshme për zbatimin e kontratës, të jenë në raport të arsyeshëm.
 -Duke qenë se kjo gjetje rezulton e përhapur në shumicën e procedurave tjera të kryera nga AK, Bashkia Librazhd, qëndrimi i audituesve është i njëjtë, dhe për shkak të mos përsëritjes së fakteve, kjo gjetje dhe ky qëndrim do vijoj të jetë i njëjtë edhe për rastet tjera të trajtuara më poshtë në këtë Projekt Raport.

4. Tenderi me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”		
1.Urdhër Prokurimi: 696 dt. 07.09.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 08.09.2022. 1. S .K - (Pergj.Sektori Prokurime) 2. J. M - (Përgjegjës Urbanistikes) 3. J .B - (Sp. Sektori i Projekteve)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 696/1 datë 07.09.2022., 1. E .P - (Kryetar) 2. B .B - (Anëtar) 3. S .A - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur ”	6.Oferta fituese: OE “B.” SHPK, me ofertë 26,729,830 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 08.11.2022, me afat 80 dite.	7.Diferenca me fondin limit: 1,561,890 - lekë pa tvsh
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 28,291,720 leke pa tvsh.	9.Burimi Financimit: Ministria e Financave dhe Bashkefinancim nga Bashkia Librazhd.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender – 3 OE b)Skualifikuar – 2 OE c) Kualifikuar - 1 OE
8. Data e hapjes së tenderit : 27.09.2022	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka
11.Ankimime AK, Nuk ka		

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **3.3 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 45 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës **3.4 në DST** e cila kërkon nga OE 1 inxhinier mjedisi drejtues teknik në licencën e shoqërisë, është kërkesë jo në përputhje me objektin e prokurimit. AK nuk argumenton nevojën për 1 inxhinier mjedisi, pasi nuk ka procese pune që lidhen me inxhinierin e mjedisit, dhe aq më pak që ky inxhinier të jetë edhe drejtues teknik në licencën e shoqërisë. Është kërkesë e tepërt në raport me objektin e punës.

3.Kërkesa e pikës **3.6 në DST** e cila kërkon 2 shoferë, është kërkesë e cila nuk përputhet me atë të kërkesës së pikës **3.7 të DST** për numrin e mjeteve të kërkuara për të cilat kërkohen shoferët. Konkretisht janë kërkuar 10 mjete për të cilat është e nevojshme disponimi i shoferit. Sa më sipër, konstatohet një mos përputhje dhe mos argumentim nga ana e NJP për hartimin e

këtij kriteri. Sa më sipër, kemi një numër të lartë mjetesh të kërkuara, të cilat AK nuk i argumenton me volumet konkrete në raport me periudhën 3 mujore të kërkuar për zbatimin e punimeve dhe njëkohësisht se si do drejtohen këto mjete kur është kërkuar ky numër i kufizuar drejtuesish.

4. Kërkesa e pikës **3.7/c e DST**, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t'u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesë janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikim të padrejtë për OE.

4.1. Gjithashtu, në pikën **3.7/b të DST**, NjP ka përcaktuar se *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre*. Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*. Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

5. Kërkesa e pikës **3.13 e DST** e cila kërkon nga OE 1 ekspert për mbrojtjen nga zjarri, është kërkesë e tepërt dhe jo në përputhje me preventivin e punimeve. Sipas preventivave për objektet që do rikonstruktohen, zërat lidhen me prishje tavani, prishje çatie, punime hekuri, breza betoni dhe ulluqe shkarkimi. Sa më sipër, nuk ka zëra që të kërkojnë ekspertizën e ekspertit zjarrëfikës.

6. Lidhur me kërkesën e pikës **2.2.3 të DST** e cila kërkon nga OE vërtetimin për likuidimin e detyrimeve vendore, dhe atë të pikës **3.11 të DST** e cila kërkon nga OE Impiant Betoni me QKL në pronësi, më qira ose kontratë furnizimi, NjP nuk ka ndjekur të njëjtin standard të ndjekur në procedura tjera, kjo edhe në zbatim të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2022 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, duke mos përcaktuar plotësimin e këtyre kriterëve paraprakisht nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit. AK ka ndjekur standarde të dyfishta sa i përket mënyrës së hartimit të këtyre kriterëve duke mos ju përmbytur dispozitës së cituar më sipër.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NjP**.

Ndikimi: Ul konkurrencën ndërmjet Operatorëve Ekonomikë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 4, nga anëtarët e NjP, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: 1. Kërkesa e pikës 3.4 te DST, për 1 inxhinier mjedisi, është një kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit dhe Agjencia e Prokurimit Publik e ka cilësuar të saktë këtë kërkesë, në zbatim të plotë të projektit, specifikimeve teknike dhe zërave te preventivit. APP e ka vlerësuar si kriter të saktë dhe të rregullt.

2. Kërkesa 3.13 e DST për një ekspert për mbrojtjen nga zjarri, nuk është aspak një kërkesë e tepërt, duke marre në konsideratë faktin që kemi të bëjmë me punime në rreth 38 banesa të shpërndara në fshatra të ndryshme, dhe me zëra të punimeve sikurse instalime elektrike, hidraulike, ulluqe etj. Kemi menduar dhe gjykuar bazuar edhe në praktikat e mëparshme se është e domosdoshme që kompania të disponojë një ekspert zjarrfikës, për të siguruar mbarëvajtjen e punimeve në banesa dhe sigurinë e tyre. APP e ka vlerësuar si kriter të saktë dhe të rregullt.

3. Kërkesat e përcaktuara në pikat 2.2.3 (për taksat vendore) dhe 3.11 në DST, janë të sakta dhe të mire argumentuara. Fakti që këto kritere nuk janë të vendosura në të gjithë DST të publikuara nga AK Bashkia Librazhd, nuk do të thotë që ne kemi vepruar dy standarde, pasi AK i referohet edhe objekteve të mëparshme të ngjashme, dhe në asnjë dispozite ligjore apo normative të prokurimeve publike nuk citohet apo shkruhet që duhet të kemi të njëjtat kritere të veçanta teknike për çdo lloj procedure prokurimi, pasi objektet e prokurimit mund të kenë edhe kritere teknike të veçanta referuar llojit të objektit të prokurimit, tipologjisë së punimeve, vlerës së fondit limit, faktit që kemi të bëjmë me asfaltim rrugë apo rikonstruksion banesa ...etj. Pra vendosja e tyre është specifike në varësi të objektit të prokurimit dhe të mirëargumentuara, sikurse janë të vlerësuara të tilla edhe nga APP. Por kjo nuk do të thotë aspak që këto kritere vendosen me dy standarde sikurse vendosja e kritereve pika 2.2.3 dhe 3.11 e DST.

Ky konstatim i grupit të audituesve nuk qëndron dhe besojmë se duhet të hiqet në projekt raport si i pambështetur.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

-Lidhur me kërkeën e pikës 3.4 për inxhinierin e mjedisit, pretendimi i paraqitur nuk qëndron. Për shkak të tipologjisë së punimeve, nuk parashikohet asnjë kategori punimesh për të cilat konsiderohet e nevojshme ekspertiza e inxhinierit të mjedisit, ekspertizë e cila për punimet që përkojnë me inxhinierinë mjedisore përcaktohet qartë në VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, pretendimi se APP e ka konsideruar dhe vlerësuar si kriter të saktë, sqarohet se ky pretendim nuk qëndron, pasi APP nuk shprehet nëse kriteret janë të sakta apo jo, por rekomandon kur gjykon se kritere të ndryshme nuk janë të përshtatshme për procedurat e prokurimit, por në çdo rast është përgjegjësi e AK vendosja e tyre. Detyrimi për argumentimin teknik dhe ligjor të kritereve është detyrë e AK, strukturave të ngarkuara nga titullari për hartimin e tyre, dhe në këto kushte është detyrim i juaji argumentimi i vendosjes së kriterit, dhe jo justifikimi se APP i ka konsideruar të rregullta. Monitorimi nga APP ashtu si edhe auditimi nga KLSH, është pikërisht për përmirësimin e punës së njëjësive në raport me procedurat e prokurimit publik.

Duke qenë se edhe në raste të tjera, kemi observuar duke konsideruar mos rekomandimin e APP për kritere të caktuara, audituesit sqarojnë se lidhur me këtë çështje, për shmangien e përsëritjeve, do konsiderohet argumentimi i mësipërm i njëjtë edhe për rastet tjera të ngjashme.

2.Lidhur me pikën 3.11 pretendimi nuk qëndron. AK nuk ka argumentuar konkretisht proceset e punës për të cilat kërkohet ekspertiza e ekspertit të mbrojtjes nga zjarri, dhe njëkohësisht nuk zërat që ka cituar në observacionin e paraqitur nuk lidhen me nevojën për të disponuar këtë ekspert.

3.Lidhur me observacionin e pikës 2.3.3 dhe 3.11, audituesit sqarojnë se pretendimi nuk qëndron. Personat përgjegjës nuk kanë argumentuar gjetjen e audituesve dhe thelbin e asaj që është trajtuar. Konkretisht, audituesit sqarojnë se kërkesa e bërë nga NjP për 2 pikat e mësipërme, është kërkesë e cila plotësohet nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit, fakt i cili në këtë procedurë nuk është kërkuar në mënyrën e duhur, dhe audituesit kanë cituar se ndryshe nga procedura tjera në të cilat kërkesat që lidhet me taksat vendore dhe mjetet ose makineritë e nevojshme është kërkuar që të deklarohen nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit, në procedurën konkrete objekt shqyrtimi, nuk është ndjekur i njëjti standard.

5. Tenderi me objekt: “Blerje fadrome për Drejtorinë e Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale dhe autovinç për Drejtorinë e Punëve Publike”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje fadrome për Drejtorinë e Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale dhe autovinç me kosh për Drejtorinë e Punëve Publike”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.720, datë 16.09.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 16.09.2022. 1. S.K - (Pergj.Sektori Prokurime) 2. S .O - (Pergj. Sektori Finance) 3. M. G- (Pergj. Sekt. Transportit)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 720/1, datë 19.09.2022 1. Ç.V – (Kryetar) 2. S .A - (Anëtar) 3. B .M – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e Thjeshtuar ”		

5.Fondi Limit (pa Tvsh) 5,000,000 (pese milion) leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: OE "A " Shpk" me ofertë 4,780,000 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 28.10.2022, me afat 10 dite.	7.Diferenca me fondin limit: 220,000 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 30.09.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender – 2 OE b)Skualifikuar -1 OE c) Kualifikuar – 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Specifikimet Teknike: 1.Për mjetin Fadromë, kërkohet që fuqia motorike të jetë 85 kë me vit prodhimi 2000 – 2008. Së pari, përcaktimi që fuqia të jetë fikse 85 kë, është kërkesë kufizuese, pasi AK do duhej të përcaktonte një kufi të arsyeshëm midis fuqisë minimale dhe maksimale të kërkuar e cila do i shërbente AK. Gjithashtu, përcaktimi që mjeti të jetë me vit prodhimi 2000 – 2008, nuk i shërben AK, i cili do duhej që kërkesën për vitin e prodhimit të mjetit të mos përcaktonte një tavan pasi, po nëse mjeti do ishte më i madh se viti 2008 a do konsiderohej i kualifikueshëm? Pikërisht ky specifikim mund të përbëjë kufizim për paraqitje oferte për OE. 2.Për mjetin Autovinç me kosh, për specifikimet e përcaktuara, kërkohet ndër të tjera që viti i prodhimit të jetë 2008 – 2010, masa e mjetit bosh 3800 kg – 4000 kg, masa e mjetit e autorizuar 4800 kg – 5000 kg si dhe gjatësia e vinçit 12 m – 14 m. Lidhur me këto specifikime, sqarohet se ato nuk janë në përputhje me rregullat e prokurimit publik, pasi janë specifikime jo konkurruese të cilat nuk i shërbejnë procedurës. Viti i përcaktuar me kufi mes vitit minimal dhe maksimal është 2 vjet, kufi shumë i vogël i cili kufizon një numër të madh OE që mund të disponojnë mjetin e kërkuar. Ky specifikim bëhet me kufizues kur konstaton faktin se është përcaktuar një tavan për vitin maksimal i cili është viti 2010, çka potencialisht kufizon OE të cilat kanë këto mjete dhe janë më të reja se viti 2010. Gjithashtu, lidhur me masën e mjetit bosh dhe atë të autorizuar, vihet re një diferencë prej 200 kg ndërmjet masës minimale dhe maksimale. AK nuk përcakton nevojën e kësaj difference minimale prej 200 kg, ndërkohë që mund të vihej një kufi më i arsyeshëm, çka do thotë një kufi më i lartë për të mundësuar paraqitjen e ofertave për OE që kanë mjetet e kërkuara. E njëjta situatë është me gjatësinë e vinçit, e cila është përcaktuar me një kufi 2 metër ndërmjet gjatësisë minimale dhe maksimale të kërkuar. AK do duhej që të përcaktonte vetëm gjatësinë minimale të nevojshme.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për ndarjen e procedurës me lote si dhe hartimin e specifikimeve teknike, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NjP.**

Ndikimi: Ndikon në uljen e ofertuesve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 4, nga anëtarët e NJP, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: 1 Në Akt Konstatim nr.4, për këtë objekt prokurimi **“Blerje fadrome për Drejtorinë e Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale dhe autovinç me kosh për Drejtorinë e Punëve Publike”** është cituar se janë aplikuar kritere kualifikimi të argumentuara dhe në përputhje me rregullat e LPP, por procedura duhej të ndahej në lote, duke ngarkuar me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit. Gjykojmë dhe argumentojmë se ky qëndrim i grupit të audituesve nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit për mosndarjen në lote të këtij objekti prokurimi, bazuar në faktin që ky emërtimi objektit është vendosur i tillë me Vendim të Këshillit Bashkiak me të njëjtin formulim dhe si i tillë është edhe miratuar nga Prefektura Elbasan. Në këtë rast kemi të bëjmë me blerjen e dy mallrave me tipologji të njëjtë, janë mjete të cilat mund të shiten nga çdo kompani e cila shet mjete motorike apo mjete të renda. Nuk gjykojmë se kemi të bëjmë me mallra të cilat do të duhet të ndahet

procedura ne lote, sepse nuk do te kishte kuptim, se pari e tille është miratuar ne buxhet , dhe e dyta kemi te bëjmë me mjete te renda , te cilat kane ngjashmëri.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Pretendimi i paraqitur nuk qëndron. Audituesit sqarojnë se sipas pikës 3 të nenit 74 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullores së prokurimit publik” i ndryshuar “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit” përcaktohet qartë në pikën (a) se Personi/at sigurojnë të dhënat e nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit publik, dhe në pikën (b) përcaktohet se *Përzgjedh llojin e procedurës së prokurimit.*

Për sa më sipër, dispozita e më sipërme përcakton qartë strukturën, njësinë apo persona konkret që përcaktojnë llojin e procedurës që duhet ndjekur. Lidhur me faktin se procedura duhet ndarë në lote, kjo përcaktohet në faktin se mjetet nuk janë të njëjta, por kanë tipologji të ndryshme në funksion, dhe ndarja e sa në lote shihet si një mundësi për rritjen e numrin të OE pjesëmarrës të cilët mund të paraqisnin ofertë edhe për njërin mjet, pa përjashtuar mundësinë që të paraqisnin oferta për të 2 lotet. Ndarja në lote rrit konkurrencën.

6. Tenderi me objekt: “Instalim kamera sigurie në rrugët kryesore të qytetit (faza e dytë”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Instalim kamera sigurie në rrugët kryesore të qytetit (faza e dytë)”		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 717, datë 16.09.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 27.09.2022. 1. S .K - (Pergj.Sektori Prokurime) 2. D. T - (Përgjegjës Sektori IT) 3. M. G - (Përgj. Sek. Transportit)	3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 717/1, datë 16.09.2022. 1. S. O - (Kryetar) 2. B. M - (Anëtar) 3. S. A - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur ”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 12,379,700 leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: “I.S” shpk, me ofertë 12,196,900 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 02.11.2022, me afat 60 ditë.	7.Diferenca me fondin limit: 182,800 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit : 13.10.2022	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender - 1 OE b)Skualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **3.3 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 1 punonjës të certifikuar nga kompania prodhuese e sistemit të kamerave (për të cilën OE duhet të paraqesë certifikatën përkatëse dhe të figurojë në listëpagesa për periudhën e kërkuar), është kërkesë e paargumentuar nga AK. AK ka kërkuar një numër relativisht të kualifikuar në nivel inxhinierësh si telekomunikacioni, elektronik dhe elektrik, pikërisht për të bërë të mundur zbatimin e kontratës, ndërkohë përcaktimi se duhet edhe 1 punonjës i certifikuar nga kompania prodhuese, vendos i cili duhet të jetë në listëpagesën e shoqërisë, krijon kufizim për OE që disponojnë staf të kualifikuar dhe materialet e nevojshme sipas specifikimeve teknike për zbatimin e kësaj kontrate, pa qenë e nevojshme të kenë edhe certifikime nga prodhuesit e produkteve. Pikërisht ky detyrim, vendos OE në kushte të pabarabarta.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NJP.*

Ndikimi: Ul numrin e OE pjesëmarrës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 4, nga anëtarët e NJP, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *1. Për sa i përket faktit të përcaktimit në kriterin pika 3.3, kërkesës për një punonjës të certifikuar nga kompania prodhuese e sistemit të kamerave, argumentojmë se ky përcaktim nuk është aspak kërkesë e paargumetuar dhe është në përputhje me LPP dhe RRPP, si edhe bazuar në vlerën e lartë të mallrave objekt prokurimit, duhet të jete garancia për certifikimin e tyre për të siguruar mirë përdorimin e fondeve publike. Ky kriter është cilësuar i sakte nga APP. Gjithashtu stafi i kërkuar i kualifikuar i inxhinierëve është i mireargumentuar dhe i mbështetur teknikisht në preventivin përkatës. Këto kritere teknike janë të hartuara nga specialisti i fushës P.IT dhe për këtë arsye garantojnë sigurinë në zbatimin e rregullt të kontratës. Njësia e Prokurimit ka bere ndryshimet në SPE për kriteret për të cilat APP ka sugjeruar apo rekomanduar për tu hequr apo për tu mire argumentuar. Bashkangjitur e-mail APP.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Pretendimet e paraqitura nuk qëndrojnë. Produktet prodhohen nga kompani të ndryshme, dhe subjektet tregtuese nuk mund të certifikojnë stafin e tyre me çdo kompani që prodhon këto produkte. AK ka kërkuar specifikime konkrete për mallrat objekt prokurim, dhe personeli i kualifikuar për instalim kamerash, konsiderohet çdo person që ka kualifikime të certifikuara nga organizma të ndryshëm që kanë për objekt instalimin e kamerave dhe pikërisht kjo është arsyeja se pse nuk duhej lidhur domosdoshmërisht kualifikimi i specialistit nga vetë kompania prodhuese, por të kërkohej specialist i cili të jetë i kualifikuar për instalim kamerash.

7. Tenderi me objekt: “Blerje karburant”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburant ”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.70, datë 28.01.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 10.03.2022. 1. S.K - (Pergj.Sektori Prokurime) 2. M .G - (Pergj.Sekt. Transportit) 3. M. D - (Sp. Sektori Financës)	3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 71/, datë 28.01.2022. 1. S .O - (Kryetar) 2. S. A - (Anëtar) 3. Ç. V - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e Thjeshtuar ”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 9,960,872 leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: OE “M” shpk me ofertë 9,960,872 - Lekë pa tvsh, marzh fitimi 12,9 % , me lidhje kontrate datë 15.03.2022, me afat 12 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: --- - lekë pa tvsh Eshte marreveshje kuader me 12,9 % marzh fitimi.
8. Data e hapjes së tenderit: 10.02.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender - 1 OE b)Skualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Procedura nuk ka mangësi

8. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse në Bashkinë Librazhd”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Kanaleve Vaditëse në Bashkinë Librazhd”		
1.Urdhër Prokurimi: 331, dt. 30.08.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 30.08.2022. 1. S .K - (Pergj.Sektori Prokurime) 2. J. M - (Përgjegjës Urbanistikes) 3. B .K - (Specialist Sektori i Ujitjes)	3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 331/1, datë 30.08.2022. 1. H .H - (Kryetar) 2. S. A - (Anëtar) 3. A .P - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e Thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 9,999,998 leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: “A” Sh.p.k , me ofertë 9,523,375 Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 05.10.2022, me afat 40 dite.	7.Diferenca me fondin limit: 476,623 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit : 12.09.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë dhe Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomikë a)Pjesëmarrës – 2 OE b)Skualifikuar – 1 OE c)Kualifikuar – 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **3.3 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 50 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës **3.5 në DST** e cila kërkon 3 manovrator, është kërkesë jo në përputhje me numrin e mjeteve të cilat kërkohet disponimi i manovratorit. Sipas pikës **3.7** kërkohet 2 mjete për të cilat është e nevojshme disponimi i manovratorit, ndërkohë janë kërkuar 3 drejtues. Gjithashtu, sqarohet se sipas pikës **3.7** kërkohen 5 mjete tjera për të cilat kërkohet disponimi i shoferëve ndërkohë nuk është kërkuar nga NjP asnjë shofer. Ka mos përputhje mes kërkesës së stafit të nevojshëm dhe mjeteve të kërkuara.

3.Kërkesa e pikës **3.7/b të DST**, NjP ka përcaktuar se *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre*. Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*. Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

4.Kërkesa e pikës **3.7/c e DST**, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesë janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikim të padrejtë për OE.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkak: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NJP.*

Ndikimi: Ul numrin e OE pjesëmarrës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

9. Tenderi me objekt: “Rikualifikimi i qendrës së fshatit Fushë Studen dhe ndërtimi i shtegut biçikletave”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikualifikimi i qendrës së fshatit Fushë Studen dhe ndërtimi i shtegut të biçikletave”		
1.Urdhër Prokurimi: 404, dt. 18.05.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 03.10.2022. 1. S .K - (Pergj.Sektori Prokurime) 2. J. M - (Përgjegjës Urbanistikes) 3. J. B - (Spec.Sek. i Urbanistikes)	3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 423 datë 26.05.2022. 1. B.B – (Kryetar) 2. A .P - (Anëtar) 3. S.A - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur ”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 14,030,660 leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: “A” shpk me ofertë 11,141,753 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 30.08.2022, me afat 4 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 2,888,907 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit : 13.06.2022.	9.Burimi Financimit: PZHRSH dhe Bashkia Librazhd.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës – 10 OE b)Skualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 10 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës 3.5 në DST e cila kërkon ndër të tjera 2 manovratorë, është kërkesë e cila nuk përputhet me atë të kërkesës së pikës 3.7 të DST për numrin e mjeteve të kërkuara për të cilat kërkohej manovratorët. Konkretisht janë kërkuar 5 mjete për të cilat është e nevojshme disponimi i manovratorit. Sa më sipër, konstatohet një mos përputhje dhe mos argumentim nga ana e NJP për hartimin e këtij kriteri.

3.Kërkesa e pikës 3.7/b të DST, përcakton se *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre.* Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e cila përcakton se *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.* Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

Vlerësimi i ofertave: 1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 1/dh të Kriterëve të Përgjithshme për likuidimin e taksave. Sipas formularit të vetëdeklarimit ky OE ka deklaruar ndër të tjera likuidimin e taksave vendore pranë Bashkisë Maliq. Edhe sipas ekstraktit të QKB ky OE ka kryer punime ndërtimore pranë kësaj bashkie përgjatë vitit 2021. Në dokumentacionin e paraqitur pranë AK, mungon vërtetimi për likuidimin e taksave vendore pranë kësaj bashkie.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës 1/e të Kriterëve të Përgjithshme për pagesën e energjisë elektrike. Ky OE ka deklaruar sipas formularit të vetëdeklarimit likuidimin e pagesës për energjinë elektrike. Procedura për paraqitjen e ofertave mban datën 13.06.2022. Me datë 10.08.2022, OE ka dorëzuar pranë AK të noterizuar vërtetimin me nr. 2022-9576500-YX datë 27.05.2022 i cili përcakton se OE ka likuiduar detyrimet deri në muajin Prill 2022. Në kushtet e dorëzimit të dokumentacionit në muajin Gusht 2022, OE duhet të paraqiste dokumentacionin

e rifreskuar për pagesën e detyrimeve të energjisë elektrike duke përfshirë muajt Maj dhe Qershor 2022, muaj për të cilët nuk jep garanci të ketë likuiduar këto detyrime.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **3.7 të Kriterëve të Veçanta** për mjetin Grejder. Është paraqitur mjeti i marrë me qira nga subjekti "H." shpk. Për këtë mjet është paraqitur si dokumentacion vetëm deklarata doganore, ndërkohë ky mjet rezulton me goma dhe që regjistrohet në regjistrat publikë. Për këtë mjet duhet të disponoheshin leja e qarkullimit, polica e sigurimit dhe akti i kolaudimit sipas kërkesës së NJP në DST.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP dhe KVO.**

Ndikimi: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **11,141 mijë lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 4, nga anëtarët e NJP, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *1. Kërkesa e pikës 3.4 te DST, për 1 Inxhinier Elektrik drejtues teknik, është një kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit dhe Agjencia e Prokurimit Publik e ka cilësuar te saktë këtë kërkesë, ne zbatim te plote te projektit, specifikimeve teknike dhe zërave te preventivit. APP e ka vlerësuar si kriter te sakte dhe te rregullt. Konkretisht zërat e preventivit :*

7 3.An/53 F.V. Shtylle metalike per ndricim H=7 m, d=160 mm- cope 22

- 28 Analize FV ndricues LED 100Ë cope 22

- 29 Analize F.V. Morseteri shtylle 3P+sig10A+kapak cope 22

- 30 3.An/et F.V. Elektroda tokezimi komplet cope 22

- 31 3.An/55 F.V. Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm cope 22

- 32 Analize F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV. 3x1.5mm2 ml 250

- 33 Analize F.V. Kabell FG7OR 4x4mm2 ml 100

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Do pranohet observacioni juaj që lidhet me inxhinierin elektrik drejtues teknik. Audituesit kanë sqaruar se AK në vijim të konsiderojë faktin se një pjesë e stafit jo domosdoshmërisht të jetë drejtues teknik, kjo edhe për shkak të volumit të zërave konkret në preventiv.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 4, nga anëtarët e KVO, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1173/7-29 prot., datë 28.03.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *1. Komisioni i vlerësimit te ofertave argumenton se ka respektuar kuadrin ligjor për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit te OE ne mënyrë korrekte. Në zbatim te plote te parimeve kryesore dhe ne përputhje me dispozitat e ligjit, vkm për prokurimin publik dhe menaxhimin ne mënyrë efikase dhe eficente e fondeve publike, komisioni i vlerësimit te ofertave ka vlerësuar procedurën e prokurimit duke patur parasysht gjithë elementet e nevojshëm.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Audituesit i qëndrojnë faktit se OE është kualifikuar pa përmbushur të gjitha kriteret, duke shfaqur disa mangësi të evidentuara tek situata e gjetjes, për të cilët observuesit nuk kanë paraqitur kundërshtime për to, por vetëm janë shprehur se kanë vlerësuar ofertën në respekt të kuadrit rregullator për prokurimin publik. Audituesit vlerësojnë se KVO ka vlerësuar ofertën bazuar edhe në ofertën më të favorshme për AK, por njëkohësisht, mbartin edhe detyrimin e vlerësimit me objektivitet të çdo dokumenti, dhe në rast të devijimeve të vogla të cilat në thelb nuk cenojnë zbatimin e kontratës, ta kualifikojnë atë, por në çdo rast të bëjnë evidentimin e këtyre mangësive.

10. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe veprave të artit të Bashkisë Librazhd”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe veprave të artit të Bashkisë Librazhd”		
1.Urdhër Prokurimi: 761, dt. 28.09.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 03.10.2022. 1. S .K - (Pergj.Sektori Prokurime) 2. J .M - (Përgjegjës Urbanistikes) 3. A .P - (Sp. Sektori i Urbanistikes)	3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 764/1 datë 28.09.2022, i ndryshuar 1. S.O - (Kryetar) 2. Ç .V - (Anëtar) 3. A.H - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e Thjeshtuar ”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 8,333,253 leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: “BO G.K shpk & V.K shpk me ofertë 8,279,930 Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 14.02.2023, me afat 30 ditë.	7.Diferenca me fondin limit: 53,323 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit : 17.10.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës – 2 OE b)Skualifikuar – 1 OE c) Kualifikuar – 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **3.3 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 25 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës **3.7/b të DST**, NjP ka përcaktuar se *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre.* Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.* Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

3.Kërkesa e pikës **3.7/c e DST**, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesë janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikim të padrejtë për OE.

Vlerësimi i ofertave: 1.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **3.7 të DST** për disa nga mjetet e paraqitura dhe konkretisht:

-Për 1 Autobot Uji 500 l, asnjëri nga BOE nuk ka deklaruar disponimin e këtij mjete. OE "G.K" shpk ka deklaruar sipas formularit të Vetëdeklarimit Bot Uji, ndërkohë sipas DST kërkohet Autobot Uji, pra nuk kemi të bëjmë me mjetin e kërkuar. OE "V.K" shpk nuk ka deklaruar asnjë Autobot Ujit.

2.OE "G.K" shpk, i cili ka marrë përsipër kryerjen e 67.14% të punimeve sipas preventivit, nuk përmbush kriterin e pikës **3.5 të DST** për 1 Teknik Ndërtimit dhe 2 Specialist Ndërtimi. Ky OE, nuk ka deklaruar në shtojcën përkatëse asnjë nga specialistët e kërkuar nga NjP në kriteret e veçanta të kualifikimit. Neni 88, pika 3 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, përcakton qartë se secili nga anëtarët e bashkimit duhet të përmbushin kërkesat ekonomike, financiare, **profesionale dhe ato teknike** në përputhje me përqindjen dhe/ ose natyrën e pjesëmarrjen në punë. Sa më sipër, ky OE nuk ka përmbushur kërkesat në raport me përqindjen e punëve dhe proceseve të marra përsipër në këtë kontratë.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkak: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NjP dhe KVO.*

Ndikimi: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **8,279 mijë lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 4, nga anëtarët e NjP, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *Kërkesa e pikës 3.7/e te DST: Njësia e Prokurimit argumenton dhe sqaron se ky kriter i veçantë kualifikues, për nyje inertesh e cila duhet te ndodhet ne distance me te madhe se 35 km nga objekti qe te mundësohet përmbushja e standardeve te përcaktuara ne VKM Nr. 628 date 15.07.2015 "Për miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe Ndërtimit te Rrugëve", mbështetet ne cilësitë teknike dhe kapacitetet teknike te prodhimit dhe transportimit te inerteve dhe ne VKM nr. Nr. 628 date 15.07.2015 "Për miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe Ndërtimit te Rrugëve". Distanca e kërkuar jo me e madhe se 35 km nga objekti, është kërkuar për te ruajtur cilësinë materialet inerte ne mënyrë qe punimet dhe materialet për realizimin e objektit te jenë cilësore dhe te ruajnë vetinë e tyre.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Do pranohet observacioni juaj që lidhet me kërkesën për nyjën e inerteve me distancë jo më larg se 35 km, por në vijim, audituesit sqarojnë se cilësia e produkteve garantohej edhe përtej kësaj distance dhe si e tillë të shmanget në procedurat në vijim.

-Lidhur me vlerësimin e ofertave, audituesit pranojnë observacioni për mjetin grejder, kjo pasi BOE provon se disponon këtë mjet, por siç është cituar në raste tjera, kriteri i vendosur për përcaktimin e objektit të prokurimit në kontratën e marrjes së mjetit me qira është kriter i papërshtatshëm dhe përbën shkak jo cilësor për s'kualifikimin e OE.

11. Tenderi me objekt: "Ndërtim i këndit sportiv në Shkollën e Mesme të Bashkuar Orenjë", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim i këndit sportiv në Shkollën e Mesme të Bashkuar Orenjë"		
1.Urdhër Prokurimi: 820 dt. 18.10.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 26.10.2022. 1. S. K - (Pergj.Sektorit Prokurime)	3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e Thjeshtuar”	2. J. M - (Pergjegjes Urbanistikes) 3. B. K - (Specialist Ing. Sektori Ujitjes dhe Kullimit)	Nr. 820/1 datë 18.10.2022., i ndryshuar. 1. H. H - (Kryetar) 2. E. Ç - (Anëtar) 3. A. H - (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 4,745,737 leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: OE “A.C” SHPK, me ofertë 3,973,798 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 23.03.2023, me afat 19 dite.	7.Diferenca me fondin limit: 771,939 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit : 07.11.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkise Librazhd.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës – 2 OE b)Skualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 2 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **3.3 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 25 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës **3.7/b të DST**, e cila përcakton se *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre*. Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të nenit 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*. Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

2.1.Kërkesa e pikës **3.7/c e DST**, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesë janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e OE.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP**.

Ndikimi: Ul konkurrencën.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 4, nga anëtarët e KVO, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *1. Ne Akt Konstatim nr.8, për këtë objekt prokurimi, është cituar se OE nuk përmbush kriterin e pikës 3.7 të DST pasi rezulton se nuk ka deklaruar ne shtojcën 8 Formularin e Vetë deklaramit, mjetin kamionçinë deri ne 3.5 Ton. Ndërkohë OE disponon kontrata qiraje për 2 cope Kamion deri ne 8 ton te cilët e përmbushin kriterin e kërkuar sipas DST.*

2. Se dyti, OE nuk përmbush kriteri 3.7/b për mjetin ekskavator dhe kamion deri 8 ton. Ky OE mjetin ekskavator dhe kamion deri 8 ton te cilat i ka me kontrata qiraje dhe janë brenda afateve është pare e arsyeshme nga anëtarët e KVO pavarësisht se ne këto kontrata nuk është e përcaktuar objekti i prokurimit te jene te sakta pasi nuk përbejnë pengese ne realizimin e kontratës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Do pranohet observacioni juaj duke u konsideruar si devijime, kjo edhe për faktin se audituesit e kanë konsideruar të gabuar kërkesën e NjP për përcaktimin e objektit të prokurimit në kontratat për marrjen e mjeteve me qira, kriter i cili si në rastin konkret, mund të përbëjë s’kualifikim jo cilësor për OE. M gjith, audituesit e kanë evidentuar si problematikë, pasi duhet të jetë në vijim detyrë për anëtarët e KVO evidentimin e devijimeve të vogla, kjo në përputhje me paragrafin e dytë të pikës 3 të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

12. Tenderi me objekt: “Rehabilitim i shesheve midis pallateve, Lagjja Sheja”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitim i Shesheve midis pallateve, Lagjja Sheja”		
1.Urdhër Prokurimi: 860 dt. 01.11.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 04.11.2022. 1. S. K - (Pergj.Sektori Prokurime) 2. J. M - (Pergjegjes Urbanistikes) 3. B. K - (Specialist Sektori i Ujitjes)	3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 860/1 datë 01.11.2022., 1. H. H - (Kryetar) 2. A. P - (Anëtar) 3. S. A - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e Thjeshtuar”	6.Oferta fituese: OE "M" sh.p.k, me ofertë 5,862,744 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 09.02.2023 , me afat 30 dite.	7.Diferenca me fondin limit: 669,392 - lekë pa tvsh
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 6,532,136 leke pa tvsh.	8. Data e hapjes së tenderit : 30.11.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkise
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës – 2 OE b)Skualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 2 OE
		13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në aplikimin e kriterëve.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës 3.3 e DST e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 15 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës 3.7/b të DST, e cila përcakton se *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre.* Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të nenit 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët*

ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve. Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

2.1. Kërkesa e pikës 3.7/c e DST, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t'u kërkohej që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesë janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikimin e OE.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP.**

Ndikimi: Ul konkurrencë ndërmjet OE.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

13. Tenderi me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Çerçan”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim Asfaltim i rruges se fshatit Çerçan, Nj.Ad.Hotolisht”		
1.Urdhër Prokurimi: 889, dt. 8.11.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 17.11.2022. 1. S. K - (Pergj.Sektori Prokurime) 2. J. M - (Përgjegjës Urbanistikes) 3. B. K - (Specialist Sektori Ujitjes)	3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 889/1 datë 08.11.2022. 1. S. O - (Kryetar) 2. A. P - (Anëtar) 3. A. H - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur ”	6.Oferta fituese: BOE “C.M” shpk dhe K.” shpk, me ofertë 30,218,111 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 29.03.2023, me afat 4 MUAJ.	7.Diferenca me fondin limit: 10,929,257 - lekë pa tvsh
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 41,147,368 leke pa tvsh.	8. Data e hapjes së tenderit : 05.12.2022.	9.Burimi Financimit: Bashkia Librazhd dhe Grant.
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës – 4 OE b)Skualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 4 OE
		13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës 3.3 e DST e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 50 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës 3.4 në DST e cila kërkon nga OE 1 inxhinier mjedisi drejtues teknik në licencën e shoqërisë, është kërkesë jo në përputhje me objektin e prokurimit. AK nuk argumenton nevojën për 1 inxhinier mjedisi, pasi nuk ka procese pune që lidhen me

inxhinierinë e mjedisit, dhe aq më pak që ky inxhinier të jetë edhe drejtues teknik në licencën e shoqërisë. Është kërkesë e tepërt në raport me objektin e punës.

3.Kërkesa e pikës **3.5 në DST** e cila kërkon 2 Pllakashtrues, nuk është në përputhje me preventivin e punimeve, pasi nuk kemi asnjë zë që lidhet me punime për të cilat kërkohet ekspertiza pllakashtruesve.

4.Kërkesa e pikës **3.9 në DST** e cila kërkon nga OE 2 kamion mbi 10 Ton, 2 kamion mbi 20 Ton, 6 mjete gjurmimi nga të cilat 4 ekskavatorë me goma, 1 ekskavator me zinxhirë dhe 1 ekskavator me goma, janë kërkesa të paargumentuara nga AK në raport me volumin dhe afatin e punimeve.

Vlerësimi i ofertave: 1.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **3.8 të DST** e cila kërkon nga OE të dorëzojë për materialet hekur, ISO 9001:2015 “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”. Është paraqitur një certifikatë në emër të shoqërisë K. I., certifikatë e cila është në gjuhë të huaj e pa përkthyer dhe e panoterizuar. Gjithashtu, kjo certifikatë rezulton se është jashtë afatit të vlefshmërisë nga data 29 Korrik 2021. Njëkohësisht nuk përcaktohet lidhja ndërmjet kësaj certifikate dhe BOE, pra nuk përcaktohet se çfarë marrëdhënieve juridiko ka ndërmjet bashkimit të operatorëve dhe disponuesve të kësaj certifikate.

2.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë Bashkisë Librazhd, rezulton se BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore në çdo vend ku ka ushtruar aktivitetin për vitin 2021 dhe 2022. Ky BOE, ka deklaruar punë të ngjashme të realizuara në Elbasan përgjatë vitit 2021 –2022 për kontratën me objekt “Rikualifikim i lulishtes në qendër të qytetit të Elbasanit”, në Vlorë përgjatë vitit 2021 për kontratën me objekt “Riasfaltim i disa rrugëve në fshatin Poro, Nj.A Novoselë”, në Durrës përgjatë vitit 2021 për kontratën me objekt “Zbatim i i projektit të kontrollit fizik të mjeteve në terminalin e trageteve”. Në të 3 këto njësi të vetëqeverisjes vendore, rezulton se BOE nuk ka likuiduar detyrimet vendore për vitin 2021 dhe 2022 në kundërshtim me kërkesat e veçanta të kualifikimit.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NJP.*

Ndikimi: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **30,218 mijë lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 4, nga anëtarët e NJP, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *1. Kërkesa e pikës 3.4 te DST, për inxhinier mjedisi drejtues teknik në licencën e shoqërisë , është një kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit. Përveç faktit që kemi të bëjmë me një vepër publike të një lloji të veçantë – asfaltim, e cila përmban kategori punimesh speciale dhe teknike të rëndësishme të veçantë të mbrojtjes së mjedisit. Në akt konstatim është përmendur që njësi e prokurimit ka kërkuar **inxhinier ndërtimi profili transport**, ndërkohë që në procedurat e tjera nuk e ka kërkuar, duke vepruar në dy standarde. Njësi e Prokurimit në lidhje me këtë citim gjykon se ky këndvështrim është i padrejtë nga Grupi i audituesve pasi një kërkesë e tillë është vendosur edhe në objekte të tjera, me ngjashmëri në objekt, citojmë objektet përkatëse : Riparime të shtresave asfaltike në Njësitë Administrative dhe në Bashkinë Librazhd, “Rikonstruksion i rruges Mirake Gjovac , NJ.Ad.Polis, “ Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Spathar “ etj..... Fakti që këto kriterë nuk janë të vendosura në të gjithë DST të publikuara nga AK Bashkia Librazhd, nuk do të thotë që në kemi vepruar dy standarde, pasi AK i referohet edhe objekteve të mëparshme të ngjashme , dhe në asnjë dispozite ligjore apo normative të prokurimeve publik nuk citohet apo shkruhet që duhet të kemi e njëjtët kriterë të veçantë teknike për çdo lloj procedure prokurimi , pasi objektet e prokurimit **mund të kenë edhe kriterë teknike të veçanta referuar llojit të objektit të prokurimit, tipologjisë së punimeve, vlerës së***

fondit limit, faktit qe kemi te bëjmë me asfaltim rruge apo rikonstruksion banesa ...etj. Pra vendosja e tyre është specifike ne varësi te objektit te prokurimit dhe te mireargumetuara, sikurse janë te vlerësuara te tilla edhe nga APP . Por kjo nuk do te thotë aspak qe këto kritere vendosen me dy standarde sikurse vendosja e kritereve pika 3.4 e DST. Ky konstatim i grupit te audituesve nuk qëndron dhe besojmë se duhet te hiqet ne projektraport si i pambështetur.

*2. Kërkesa e pikës 3.5 te DST, për 3 punonjës teknik ndërtimi, është një kërkesë ne përputhje me objektin e prokurimit dhe është kërkuar si staf mbështetës dhe jo si drejtues teknik ne licencë, çka mund te plotësohet nga OE te interesuar edhe nëpërmjet një kontrate te thjeshte pune. Duke patur ne konsiderate qe kemi te bëjmë me asfaltim rruge te një zone rurale , kemi gjykuar dhe argumentuar qe është e nevojshme qe kompania e cila do te zbatoje punimet te ketë te punësuar edhe teknike ndërtimit te mjaftueshëm. **Është vlerësuar një kriter i vlefshëm dhe i sakte nga APP.***

*3. Kërkesa e pikës 3.9 te DST, për mjetet e kërkuar , janë kërkesa te cilat përputhje me objektin e prokurimit, zërat e punimeve dhe specifikimet teknike te kërkuara. Gjithashtu për çdo procedure prokurimi Titullari i AK, ka ngritur grupe pune te veçantë për përlllogaritjen e fondit limit, hartimit te kritereve te veçanta teknike, listës se mjeteve, grafikut te punimeve etj. Njësia e Prokurimit mbështetur ne analizën teknike dhe ligjore te këtij komisioni ka përcaktuar edhe ne DST , formulimin e kritereve teknike te veçanta ne DST , sikurse 3.9 ne DST, përfshirë stafin teknik, mjetet e nevojshme, shoferet , manovratorët etj. Vendosja e çdo kriteri te veçantë është e dokumentuara dhe argumentuar teknikisht dhe ligjërish me dosjen teknike te përlllogaritjes se fondit limit dhe nga projektuesi. Nuk është përgjegjësi e Njesisë se Prokurimit vendosja e kritereve teknike te veçanta te punuara nga specialiste te fushës nëpërmjet komisioneve te veçanta te ngritura nga Titullari i AK. **Është vlerësuar një kriter i vlefshëm dhe i sakte nga APP.***

4. Kërkesa e pikës 3.9/a, te DST, sqarojmë linje inerte dhe jo fabrika asfaltoshtruese: Njësia e Prokurimit argumenton dhe sqaron se ky kriter i veçantë kualifikues, për nyje inertesh e cila duhet te ndodhet ne distance me te madhe se 35 km nga objekti qe te mundësohet përmbushja standardeve te përcaktuara ne VKM Nr 628 date 15.07.2015 “Per miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe Ndërtimit te Rrugëve”, mbështetet ne cilësitë teknike dhe kapacitetet teknike te prodhimit dhe transportimit te inerteve dhe ne VKM nr. Nr 628 date 15.07.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe Ndërtimit te Rrugëve”. Distanca e kërkuar jo me e madhe se 35 km nga objekti, është kërkuar për te ruajtur cilësinë materialet inerte ne mënyrë qe punimet dhe materialet për realizimin e objektit te jenë cilësore dhe te ruajnë vetinë e tyre.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

-Pranohet pjesërisht observacioni juaj që lidhet me kërkesën për 1 inxhinier ndërtimi profili transport, kjo pasi në procedurat që janë ndjekur sidomos përgjatë vitit 2023 është vendosur në të gjitha rastet e audituara me objekt shtrim rrugës, si kërkesë nga AK. Pranohet observacioni që lidhet me distancën e fabrikës së asfaltit, por AK duhet që në raste të tjera në vijim, të konsiderojë faktin se cilësia e asfaltit mund të sigurohet edhe përtej kësaj distance dhe në këto kushte duhet të rishikohet në të ardhmen si kriter. Gjithashtu pranohet observacioni për 3 teknik ndërtimi, pasi justifikohen proceset e punës për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre, por audituesit sqarojnë se në procedurat e ardhshme të rishihet kërkesa për 3 teknik ndërtimi duke përcaktuar një numër më të ulët të tyre.

-Lidhur me kërkesat tjera, ato nuk pranohet, kjo pasi kërkesa për inxhinier mjedisi drejtues teknik, siç është cituar edhe në raste tjera të ngjashme dhe të trajtuara më sipër, nuk është në përputhje me ekspertizën që kryen ky inxhinier, pasi kategoria e punimeve nuk përkon me ato të punimeve të inxhinierisë së mjedisit, për të cilat kërkohet ekspertiza e inxhinierit të mjedisit, dhe aq më pak drejtues teknik. Edhe për numrin e marr të mjeteve të kërkuara, NjP nuk argumenton numrin e madh të mjeteve, ndërkohë që specialistët e fushës kanë për detyrë të përcaktojnë numrin dhe kapacitetin e tyre në raport me volumet dhe periudhës konkrete të punimeve.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 4, nga anëtarët e KVO, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1173/7-29 prot., datë 28.03.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *Ne Akt Konstatim nr.4, për këtë objekt prokurimi, “Sistemim dhe asfaltim i rruges se fshatit Çercan” janë konstatuar disa ane teknike te paplotësuara te cilat nuk cenojnë vlefshmërinë e ofertës duke qene oferta me vlere me te ulet ne klasifikim. Nisur nga ky arsyetim*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave që BO “C. M “ shpk dhe “K. “SHPK me oferte 30,218,111 lek pa tvsh është shpallur fitues.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Lidhur me pretendimet tuaja, audituesit siç e kanë trajtuar në raste të tjera të ngjashme, mangësitë e evidentuara në rast se gjykohej se janë devijime të vogla, të bëjnë evidentimin e tyre, kjo në përputhje me paragrafin e dytë të pikës 3 të nenit 92 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Lidhur me gjetjet e mësipërme, audituesit do reflektojnë mangësitë e evidentuara për mos vendosjen e objektit të prokurimit në kontratën e mjeteve dhe makinerive të marra me qira, duke qenë se edhe kriteri i vendosur është konsideruar i papërshtatshëm.

14. Tenderi me objekt: “Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Planë, Nj. Administrative Polis”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Plane, Nj. Administrative Polis”		
1. Urdhër Prokurimi: 866 dt. 01.11.2022.	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 09.12.2022. 1. S. K - (Pergj. Sektori Prokurime) 2. J. M - (Përgjegjës Urbanistikes) 3. B. K - (Specialist Sektori i Ujitjes)	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 866/1 datë 09.12.2022, i ndryshuar., 1. H. H - (Kryetar) 2. Ç. V - (Anëtar) 3. A. P - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”		
5. Fondi Limit (pa Tvsh) : 20,197,293 leke pa tvsh.	6. Oferta fituese: OE “B. N.” SHPK, me ofertë 17,746,740 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 16.03.2023, me afat 30 dite.	7. Diferenca me fondin limit: 2,450,553 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit : 27.12.2022.	9. Burimi Financimit: Buxheti i Bashkise dhe Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës – 5 OE b) Skualifikuar – 1 OE c) Kualifikuar – 4 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1. Kërkesa e pikës 3.2 e DST e cila kërkon nga OE kategorinë e licencës NP-5 (Punime nëntokësore, ura e vepra arti), nuk është në përputhje me preventivin e punimeve, sipas të cilit nuk ka zëra konkret punimesh që përputhen me këtë kategori licence të kërkuar.

2. Kërkesa e pikës 3.3 e DST e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 45 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

3. Kërkesa e pikës 3.6 në DST e cila kërkon 2 shoferë dhe 2 manovratorë, është kërkesë e cila nuk përputhet me atë të kërkesës së pikës 3.8 të DST për numrin e mjeteve të kërkuara për të cilat kërkohej shoferët dhe manovratorët. Konkretisht janë kërkuar 10 mjete për të cilat është e nevojshme disponimi i shoferit dhe 8 mjete për të cilat është e nevojshme disponimi i manovratorëve. Sa më sipër, konstatohet një mos përputhje dhe mos argumentim nga ana e

NJP për hartimin e këtij kriteri. Sa më sipër, kemi një numër të lartë mjetesh të kërkuara, të cilat AK nuk i argumenton me volumet konkrete në raport me periudhën 3 mujore të kërkuar për zbatimin e punimeve dhe njëkohësisht se si do drejtohen këto mjete kur është kërkuar ky numër i kufizuar drejtuesish.

4.Gjithashtu, në pikën **3.7/b të DST**, NJP ka përcaktuar se *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre*. Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve*. Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

4.1.Kërkesa e pikës **3.7/c e DST**, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t'u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesë janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikimin e OE.

Vlerësimi i ofertave: 1.OE fitues, nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore. Ky OE rezulton se përgjatë vitit 2022 ka lidhur disa kontrata me Bashkinë Librazhd, ndërkohë në dokumentacionin e dorëzuar pranë AK, nuk rezulton dhe provon me vërtetimet përkatëse të ketë likuiduar detyrimet vendore.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **3.5 të DST** për disa nga punonjësit e kërkuar, pasi punonjësit rezultojnë të deklaruar njëkohësisht në kontratën tjetër të lidhur nga Bashkia Librazhd me objekt *"Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe te pafavorizuara"* kontratë e lidhur me datë 08.11.2022 me afat 80 ditë. Stafi i deklaruar dhe angazhuar në të dy procedurat është V. D, A. K, E. K, S. K dhe E. S.

3.OE fitues nuk përmbush kriterin e pikës **3.8 të DST** për disa nga mjetet dhe konkretisht:

-Për mjetin autobetoniere, mjeti me targa AB081MD, rezulton se ka certifikatën e kontrollit teknik jashtë vlefshmërie nga data 23.12.2022;

-Për mjetin Grejder, OE ka paraqitur mjetin me deklaratë doganore R20072. Ky mjet rezulton me goma vetëlëvizës, i cili duhet të disponojë dokumentacionin e mjeteve që regjistrohen si leja e qarkullimit, polica e sigurimit dhe certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP dhe KVO**.

Ndikimi: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **17,746 mijë lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

15. Tenderi me objekt: "Ndërtim i bazamenteve të urës në përroin e Rinasist, fshati Gurë Kuq", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim i bazamenteve të urës në përroin e Rinasist, fshati Gurë Kuq"		
1.Urdhër Prokurimi: 1024/1 dt. 22.12.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 22.12.2022. 1. S. K - (Pergj.Sektor Prokurime)	3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 1024/2 datë 22.12.2022.

4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e Thjeshtuar”	2. J. M - (Përgjegjës Urbanistikes) 3. B. K - (Specialist Ing. Sektori Ujitjes dhe Kullimit)	1. Ç. V - (Kryetar) 2. A. P - (Anëtar) 3. B. M - (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 6,581,547 leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: OE “B. N.” SHPK, me ofertë 5,707,312 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 10.02.2023, me afat 60 dite.	7.Diferenca me fondin limit: 874,235 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit : 04.01.2023.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit. Fondi i Emergjencave Civile	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës – 1 OE b)Skualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **3.3 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 11 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës **3.7/b të DST**, e cila përcakton se *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre*. Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*. Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

2.1.Kërkesa e pikës **3.7/c e DST**, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesë janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e OE.

Vlerësimi i ofertave: 1.OE fitues, nuk përmbush kriterin e pikës **3.4 të DST** për 1 inxhinier ndërtimi. Inxhinieri i deklaruar U. S., rezulton njëkohësisht i deklaruar si inxhinier drejtues teknik në procedurën e shpallur fitues pranë të njëjtit AK, atë me objekt “*Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Planë, Nj.Administrative Polis*”.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **3.5 të DST** për 2 punonjësit hekurkthyes. Punonjësit e deklaruar A.K dhe E. S, rezultojnë njëkohësisht të deklaruar të angazhuar në procedurën e shpallur fitues pranë të njëjtit AK, atë me objekt “*Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Planë, Nj.Administrative Polis*”.

2.OE fitues nuk përmbush kriterin e pikës **3.7 të DST** për mjetin kamion vetëshkarkues. Janë kërkuar 2 mjete, ndërkohë që mjeti me targa AA597EN, rezulton i deklaruar njëkohësisht në procedurën e shpallur fitues pranë të njëjtit AK, atë me objekt “*Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Planë, Nj.Administrative Polis*”.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NJP dhe KVO.*

Ndikimi: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **5,707 mijë lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

16. Tenderi me objekt: “Vendtakimi i përroit Sheh, Polis me lumin e Gostimes, Nj.Adm.Polis (faza II)”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Vendtakimi i përroit Sheh, Polis me lumin e Gostimes, Nj.Adm.Polis (faza II)”		
1.Urdhër Prokurimi: 1025/1, dt. 22.12.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 22.12.2022. 1. S. K - (Pergj.Sektori Prokurime) 2. J. M - (Përgjegjës Urbanistikes) 3. B. K - (Specialist Ing.Sektori Ujitjes)	3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 1025/2, datë 22.12.2022. 1. H. H - (Kryetar) 2. Ç. V - (Anëtar) 3. B. M - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 3,333,333 leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: OE “B. N.”shpk, me ofertë 3,204,544 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 15.02.2023, me afat 45 dite.	7.Diferenca me fondin limit: 128,789 - lekë pa tvsh .
8. Data e hapjes së tenderit : 06.01.2023.	9.Burimi Financimit: Fondi i Emergjencave Civile.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës – 2 OE b)Skualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 2 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **3.3 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 9 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës **3.7/b të DST**, e cila përcakton se *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre.* Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.* Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

2.1.Kërkesa e pikës **3.7/c e DST**, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t’u kërkohej që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesë janë kosto të panevojshme për

OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikimin e OE.

Vlerësimi i ofertave: 1.OE fitues, nuk përmbush kriterin e pikës **3.4 të DST** për 1 inxhinier ndërtimi. Inxhinieri i deklaruar U. S., rezulton njëkohësisht i deklaruar si inxhinier drejtues teknik në procedurën e shpallur fitues pranë të njëjtit AK, atë me objekt *“Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Planë, Nj.Administrative Polis”*.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **3.5 të DST** për 2 punonjësit hekurkthyes. Punonjësit e deklaruar A. K dhe E. S, rezultojnë njëkohësisht të deklaruar të angazhuar në procedurën e shpallur fitues pranë të njëjtit AK, atë me objekt *“Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Planë, Nj.Administrative Polis”*.

2.OE fitues nuk përmbush kriterin e pikës **3.7 të DST** për mjetin kamion vetëshkarkues. Janë kërkuar 2 mjete, ndërkohë që mjeti me targa AA597EN, rezulton i deklaruar njëkohësisht në procedurën e shpallur fitues pranë të njëjtit AK, atë me objekt *“Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Planë, Nj.Administrative Polis”*.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP dhe KVO.**

Ndikimi: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **3,204 mijë lekë** pa TVSH..

Rëndësia: E lartë

17. Tenderi me objekt: “Blerje mallra për ndërtimin e hapësirave rekreative për fëmijët tek Parku i Qershive”, me këto të dhëna:

“Blerje mallra për ndërtimin e hapësirave rekreative për fëmijët tek Parku i Qershive”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.867, datë 01.11.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.867, datë 01.11.2022	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.867/1, datë 01.11.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar “	1. S. K –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. J. M - (Anëtar) 3. M. G – (Anëtar)	1. Ç. V – (Kryetar) 2. A. P - (Anëtar) 3. S. A– (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 3’349’681- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: O.E ‘S’ sh.p.k me ofertë 2’964’211 pa tvsh - Lekë, me lidhje kontrate datë 27/12/2022, me afat 30 dite nga dt e fillimit te punimeve	7.Diferenca me fondin limit: 385,470 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 18.11.2022	9.Burimi Financimit: Grant	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Pika 2.3.3. Operatori ekonomik duhet të ketë stafin e nevojshëm për kryerjen e këtij investimi një punësim mesatar minimumi prej 5 (pesë) persona duke përfshirë dhe stafin drejtues dhe teknik, **për periudhën gusht 2022-tetor 2022.**

Kjo kërkesë nuk është në përputhje me pikën 6 germa (ç) të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 09.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhën kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e

paraqitjes së ofertës, OE të disponojë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës **2.3.6/b e DST** e cila përcakton se “Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre”. Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se “Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

3.Kërkesa e pikës **2.3.6/c e DST** e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e tyre.

Vlerësimi i ofertave: 1-Sipas kriterëve të përgjithshme në DST nuk ka dorëzuar vërtetimin që operatori ekonomik nuk është në proces falimenti (statusi aktiv) sipas DST kriteret e përgjithshme të kualifikimit/përzgjedhjes.

2-Sipas kriterit “kapaciteti teknik” pika 2.3.1 tek kriteret e veçanta në DST operatori ekonomik për punët e ngjashme ka sjell dokumentacionin e mëposhtëm për punët e ngjashme.

-Bashkia Korçë “Rehabilitim urban i territorit mbrapa teatrit “A.Z. Çajupi.

Kontrata për këtë procedurë prokurimi është lidhur mes operatorit ekonomik dhe Bashkisë Korçë në datë 01.06.2017. Këto dokumente të paraqitura nga operatori ekonomik nuk duhet të konsiderohen nga KVO për shkak sepse këto dëshmi punimesh nuk janë brenda afatit 3 vjeçar të përcaktuar në VKM 285 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” dt 19.05.2021 neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, neni 40.

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

-Këshilli i Qarkut Korçë, “Këndi i lojërave për fëmijë në Qytetin e Ersekës”.

Sipas dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik si dëshmi për punime të ngjashme operatori ka paraqitur vetem kontratë të lidhur me subjektin dhe faturë tatimore të pjesshme jo në përputhje me VKM 285 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” dt 19.05.2021 neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, neni 40.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me **përgjegjësi:** anëtarët e NJP dhe KVO.

Ndikimi: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **2,964 mijë lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 8, nga anëtarët e KVO, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *1. Komisioni i vlerësimit te ofertave argumenton se ka respektuar kuadrin ligjor për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit te OE ne mënyrë korrekte. Në zbatim te plote te parimeve kryesore dhe ne përputhje me dispozitat e ligjit, vkm për prokurimin publik dhe menaxhimin ne mënyrë efikase dhe eficente e fondeve publike, komisioni i vlerësimit te ofertave ka vlerësuar procedurën e prokurimit duke patur parasysht gjithë elementet e nevojshëm.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se: Audituesit i qëndrojnë faktit se OE është kualifikuar pa përmbushur të gjitha kriteret, duke shfaqur disa mangësi të evidentuara tek situata e gjetjes, për të cilët observuesit nuk kanë paraqitur kundërshtime për to, por vetëm janë shprehur se kanë vlerësuar ofertën në respekt të kuadrin rregullator për prokurimin publik. Audituesit vlerësojnë se KVO ka vlerësuar ofertën bazuar edhe në ofertën më të favorshme për AK, por njëkohësisht, mbartin edhe detyrimin e vlerësimit me objektivitet të çdo dokumenti, dhe në rast të devijimeve të vogla të cilat në thelb nuk cenojnë zbatimin e kontratës, ta kualifikojnë atë, por në çdo rast të bëjnë evidentimin e këtyre mangësi.

18. Tenderi me objekt: “Riparime të pjesshme në kanalet vaditëse Librazhd”, me këto të dhëna:

“Riparime të pjesshme në kanalet vaditëse Librazhd”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.359, datë 28.04.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.359, datë 28.04.2022 1. S. K –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. J. M - (Anëtar) 3. S. O –(Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.360, datë 28.04.2022 1. H. H – (Kryetar) 2. J. B - (Anëtar) 3. S. A- (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 3’749’246- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: B.O.E “G.K” sh.p.k & “D.I” sh.p.k me ofertë 3’702’546 pa tvsh - Lekë, me lidhje kontrate datë 16/06/2022, me afat 30 dite nga dt e fillimit te punimeve	7.Diferenca me fondin limit: 46,700 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 09.05.2022	9.Burimi Financimit: Te ardhurat e Bashkisë Librazhd	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Pika 3.3. Operatori ekonomik duhet të ketë stafin e nevojshëm për kryerjen e këtij investimi një punësim mesatar minimumi prej 40 (dyzet) personave duke përfshirë dhe stafin drejtues dhe teknik, **për periudhën dhjetor 2021-shkurt 2021.**

Kjo kërkesë nuk është në përputhje me pikën 6 germa (ç) të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 09.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhën kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës, OE të disponojë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Pika 3.5. “Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që ka në stafin e saj me kontratë pune të vlefshme, të domosdoshëm për kryerjen e punimeve **3 punonjës manovrator”.**

NJP nuk ka argumentuar kërkesën e mësipërme për 3 punonjësit manovrator të kërkuar në

DST. Sipas kriterit 3.7 në DST të hartuar nga NJP lista e mjeteve të kërkuara mjete të cilat do të përdoren për kryerjen e punimeve publike është kërkuar fadromë me gome dhe mini ekskavator.

NJP ka kërkuar 3 manovrator ndërkohe kemi vetëm dy mjete të cilat plotësojnë kushtet për tu drejtuar nga punonjës manovrator të cilët janë të pajisur me leje te veçantë drejtimi.

Kriteri 3.5 në DST është vendosur në kundërshtim me VKM 285 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.

- VKM 285, datë 19.05.2022_“Për prokurimin publik”, Neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, ku përcaktohet

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar 92 për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

3.Kërkesa e pikës **3.7/b e DST** e cila përcakton se ”Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre”. Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se ”Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

4.Kërkesa e pikës **3.7/c e DST** e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e tyre.

Vlerësimi i ofertave: Operatori fitues ka mungesë ose mangësi ne dokumentacionin dorëzuar.

1-Sipas pikës 3.7 në DST për mjetin me targa AA103XE i operatorit “D.I” shpk në dokumentacionin e paraqitur rezulton:

-Certifikata e kontrollit teknik ka skaduar në vitin 2021

-Certifikata e transportit të mallrave ka skaduar në vitin 2021

2- Sipas pikës 3.7 në DST, operatori ekonomik “G.K” nuk ka paraqitur dokumentacionin për mjetin me targa AB088ER (Autobetoniere).

3- Sipas pikës 3.7 në DST, operatori ekonomik “G.K” nuk ka paraqitur dokumentacionin për mjetet e mëposhtme:

a)Mjeti me targa AA987 IV(kamion vetëshkarkues me ngarkesë mbi 10 ton)

b) Mjetin me targa AA610ST (kamion vetëshkarkues me ngarkesë mbi 10 ton)

4- Sipas pikës 3.7 në DST operatori ekonomik “G.K” nuk ka paraqitur dokumentacionin për pajisjet e kërkuara gjenerator 3 copë, aparat saldimi 1

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP dhe KVO.**

Ndikimi: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **3,702 mijë lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 8, nga anëtarët e NJP, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: 1. Kërkesa e përcaktuar ne kriterin e veçantë pika 3.5, për 3 punonjës manovrator është e sakte, dhe nuk janë kërkuar vetëm mjetet fadromë me goma dhe minieskavator sikurse është cituar ne akt konstatim, por edhe mjete te tjera si 2 kamionçina deri në 3.5 Ton dhe 2 kamion vetëshkarkues me kapacitet mbi 10 Ton.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

-Observacioni juaj nuk pranohet, kjo pasi kërkesa për manovrator lidhet me llojin e mjeteve që drejtojnë manovratorët, ndërkohë mjetet tjera të cilat keni cituar në observacionin tuaj janë mjete të cilat drejtohen me shofer të cilët disponojnë dëshmi tjera drejtimi dhe jo dëshmi të aftësisë profesionale që disponojnë manovratorët.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 8, nga anëtarët e KVO, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1173/7-29 prot., datë 28.03.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: 1. Komisioni i vlerësimit te ofertave argumenton se ka respektuar kuadrin ligjor për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit te OE ne mënyrë korrekte. Në zbatim te plote te parimeve kryesore dhe ne përputhje me dispozitat e ligjit, vkm për prokurimin publik dhe menaxhimin ne mënyrë efikase dhe eficente e fondeve publike, komisioni i vlerësimit te ofertave ka vlerësuar procedurën e prokurimit duke patur parasysht gjithë elementet e nevojshëm.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Audituesit i qëndrojnë faktit se OE është kualifikuar pa përmbushur të gjitha kriteret, duke shfaqur disa mangësi të evidentuara tek situata e gjetjes, për të cilët observuesit nuk kanë paraqitur kundërshtime për to, por vetëm janë shprehur se kanë vlerësuar ofertën në respekt të kuadrit rregullator për prokurimin publik. Audituesit vlerësojnë se KVO ka vlerësuar ofertën bazuar edhe në ofertën më të favorshme për AK, por njëkohësisht, mbartin edhe detyrimin e vlerësimit me objektivitet të çdo dokumenti, dhe në rast të devijimeve të vogla të cilat në thelb nuk cenojnë zbatimin e kontratës, ta kualifikojnë atë, por në çdo rast të bëjnë evidentimin e këtyre mangësive.

19. Tenderi me objekt: “Furnizim vendosje barriere mbrojtëse në disa rrugë të qytetit Librazhd”, me këto të dhëna:

“Furnizim vendosje barriere mbrojtëse në disa rrugë të qytetit Librazhd”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.871/1, datë 02.11.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.871/1, datë 02.11.2022	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.871/2, datë 02.11.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ‘E hapur e thjeshtuar ‘	1. S. K –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. J. M - (Anëtar) 3. M. G – (Anëtar)	1. H. H – (Kryetar) 2. M. D - (Anëtar) 3. S. A– (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 3’093’275- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: O.E ‘I.’ sh.p.k me ofertë 2’995’100 pa tvsh - Lekë, me lidhje kontrate datë 22/12/2022, me afat 15 dite nga dt e fillimit te punimeve	7.Diferenca me fondin limit: 98,175 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 21.11.2022	9.Burimi Financimit: Grant	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Pika 2.3.3. Operatori ekonomik duhet të ketë stafin e nevojshëm për kryerjen e këtij investimi një punësim mesatar minimumi prej 15 (pesëmbëdhjete) personave duke përfshirë dhe stafin drejtues dhe teknik, **për periudhën gusht 2022-tetor 2022.**

Kjo kërkesë nuk është në përputhje me pikën 6 germa (ç) të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 09.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhën kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës, OE të disponojë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës **2.3.6/b e DST** e cila përcakton se “Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre”. Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se “Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

3.Kërkesa e pikës **2.3.6/c e DST** e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e tyre.

Vlerësimi i ofertave: Operatori fitues ka mungesë ose mangësi në dokumentacionin dorëzuar.

1-Sipas pikës 3.7 në DST për mjetin me targa AA103XE i operatorit “D.I” shpk në dokumentacionin e paraqitur rezulton:

-Certifikata e kontrollit teknik ka skaduar në vitin 2021

-Certifikata e transportit të mallrave ka skaduar në vitin 2021

2- Sipas pikës 3.7 në DST, operatori ekonomik “G. K” nuk ka paraqitur dokumentacionin për mjetin me targa AB088ER (Autobetoniere).

3- Sipas pikës 3.7 në DST, operatori ekonomik “G.K” nuk ka paraqitur dokumentacionin për mjetet e mëposhtme:

a)Mjeti me targa AA987 IV(kamion vetëshkarkues me ngarkesë mbi 10 ton)

b) Mjetin me targa AA610ST (kamion vetëshkarkues me ngarkesë mbi 10 ton)

4- Sipas pikës 3.7 në DST operatori ekonomik “G.K” nuk ka paraqitur dokumentacionin për pajisjet e kërkuara gjenerator 3 copë, aparat saldimi 1

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP dhe KVO.**

Ndikimi: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **3,702 mijë lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Procedurat e periudhës 01.01.2023 – 30.04.2023

-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.

Për periudhën 01/01/2023 – 30/04/2023, nga Bashkia Librazhd referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **13** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 214,496 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 163,848 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 50,648 mijë lekë pa TVSH ose 24 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01/01/2023 - 30/04/2023	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHESEJ	13	214,496,262	163,848,252
-Të hapura	4	183,593,837	135,438,109
- E Hapur e Thjeshtuar	9	30,902,425	28,410,143
Sipas objekteve	13	214,496,262	163,848,252
-Objekte në fushën e investimeve	6	180,175,503	131,868,419
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	7	34,320,759	31,979,833

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **36** OE/BOE, nga të cilat janë s’kualifikuar **5** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **7** procedura ose 53% e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 8 ose 61% e tyre.

20. Tenderi me objekt: “Blerje karburant”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburant ”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.109, datë 26.01.2023.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 26.01.2023. 1. S. K - (Pergj.Sektori Prokurime)	3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 109/, datë 26.01.2023. 1. S. O - (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur”	2. D. T - (Pergj.Sekt. Transportit) 3. M. D - (Sp. Sektori Financës)	2. Ç. V - (Anëtar) 3. D. B - (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 13,685,010 leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: OE “M” shpk me ofertë 13,685,010 - Lekë pa tvsh, me normë fitimi 14/litër, me lidhje kontrate datë 17.02.2023, me afat 12 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: --- - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 13.02.2023.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit (Granti)	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës – 1 OE b)Skualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Procedura nuk ka mangësi

21. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Mirakë – Gjovac, Nj.A Polis”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Mirakë – Gjovac, Nj.A Polis”		
1.Urdhër Prokurimi: 128 dt. 02.02.2023.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Datë 02.02.2023. 1. S. K - (Pergj.Sektori Prokurime)	3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 128/1 datë 02.02.2023., 1. E. P - (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur ”	2. A. H - () 3. J. B - (Sp. Sektori i Projekteve)	2. D. B - (Anëtar) 3. J. M - (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 52,732,110 leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: BOE “A” SHPK & “Z.K” shpk, me ofertë 39,007,074 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 11.04.2023, me afat 2 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 13,732,036 - lekë pa tvsh

8. Data e hapjes së tenderit : 20.02.2023	9. Burimi Financimit: Grant	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës – 6 OE b) Skualifikuar – 1 OE c) Kualifikuar – 5 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1. Kërkesa e pikës **3.3 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 45 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2. Kërkesa e pikës **3.6 në DST** e cila kërkon 4 shoferë dhe 4 manovratorë, është kërkesë e cila nuk përputhet me atë të kërkesës së pikës **3.8 të DST** për numrin e mjeteve të kërkuara për të cilat kërkohej shoferët dhe manovratorët. Konkretisht janë kërkuar 10 mjete për të cilat është e nevojshme disponimi i shoferit dhe 9 mjete për të cilat është e nevojshme disponimi i manovratorit. Sa më sipër, konstatohet një mos përputhje dhe mos argumentim nga ana e NJP për hartimin e këtij kriteri. Sa më sipër, kemi një numër të lartë mjeteve të kërkuara, të cilat AK nuk i argumenton me volumet konkrete në raport me periudhën 4 mujore të kërkuar për zbatimin e punimeve dhe njëkohësisht se si do drejtohen këto mjete kur është kërkuar ky numër i kufizuar drejtuesish.

3. Gjithashtu, në pikën **3.8/b të DST**, NJP ka përcaktuar se *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre.* Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të nenit 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.* Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

3.1. Kërkesa e pikës **3.8/c e DST**, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesë janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikim të padrejtë për OE.

Vlerësimi i ofertave: 1. OE “A. C” shpk, nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e detyrimeve për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2021 dhe 2022. Ky OE rezulton sipas ekstraktit historik të QKB me adresë kryesore në Librazhd, ndërkohë nuk ka paraqitur asnjë vërtetim që provon likuidimin e detyrimeve vendore pranë kësaj bashkie.

-Njëkohësisht, sipas ekstraktit dhe paraqitjes së punëve të ngjashme, ky OE ka ushtuar aktivitet si dhe ka adresë tjetër ku ushtron aktivitetin përgjatë viteve 2021 – 2022 pranë Bashkisë Dimal (Ura Vajguore), ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetimet përkatëse për likuidimin e detyrimeve vendore pranë kësaj bashkie. OE “A.C” shpk, ka paraqitur punë të ngjashme të kryera në

Bashkinë Himarë dhe Selenicë për vitet 2021-2022, ndërkohë nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për likuidimin e detyrimeve pranë këtyre bashkive.

2. BOE nuk përmbush kriterin e pikës **3.5 të DST** për 1 inxhinier ndërtimi profili transport. OE “A. C” shpk, ka deklaruar sipas shtojcës si inxhinier ndërtimi profili transport, inxhinierin S. Gj. Nga dokumentacioni i paraqitur pranë AK, rezulton se ky inxhinier edhe me profil hidroteknik dhe jo profil transport, në kundërshtim me kërkesën e pikës 3.5.

3. BOE nuk përmbush kriterin e pikës **3.8 të DST** për mjetin Grejder me goma. Për këtë mjet, është deklaruar nga OE “Z. K” shpk mjeti me targa MK3108ZA, mjet i marrë me kontratë qiraje. Për këtë mjet është paraqitur vetëm 1 leje qarkullimi, ndërkohë mungon gjithë dokumentacioni i nevojshëm për këtë mjet që përfshin policën e sigurimit, aktin e kolaudimit dhe foto të mjetit.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e NjP dhe KVO.

Ndikimi: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **39,007 mijë lekë** pa TVSH..

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 5, nga anëtarët e NjP, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *1. Kërkesa e pikës 3.5 të DST, për inxhinier ndërtimi profili transport, është një kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit dhe është kërkuar si staf mbështetës dhe jo si drejtues teknik në licencë, çka mund të plotësohet nga OE të interesuar edhe nëpërmjet një kontrate të thjeshtë pune. Duke patur në konsideratë që kemi të bëjmë me asfaltim rruge të një zone rurale, kemi gjuikuar dhe argumentuar që është e nevojshme që kompania e cila do të zbatojë punimet të ketë të punësuar edhe një inxhinier ndërtimi profili transport.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Pranohet observacioni juaj lidhur me kërkesën për 1 inxhinier ndërtimi profili transport, duke qenë se kjo kërkesë ndër të tjera ka përcaktuar edhe mundësinë që ky inxhinier të disponohet me kontratë pune, pa qenë e detyrueshme të jetë edhe drejtues teknik në licencën e shoqërisë.

-Lidhur me vlerësimin e ofertave, audituesit do reflektojnë pikën e fundit të gjetjes që lidhet me mjetet, në të cilat nuk është përcaktuar objekti i prokurimit, qëndrim i cili është detajuar në rastet e ngjashme trajtuar më sipër.

22. Tenderi me objekt: “Ndërtim Central Park (Parku Qendror) Faza II”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim Central Park (Parku Qendror) Faza II”		
1. Urdhër Prokurimi: 222 dt. 23.02.2023.	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Datë 23.02.2023. 1. S. K - (Pergj. Sektori Prokurime)	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 222/1 datë 23.02.2023
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”	2. A. H - () 3. J. B - (Sp. Sektori i Projekteve)	1. J. M - (Kryetar) 2. XH. B - (Anëtar) 3. D. B - (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa Tvsh) : 33,842,622 leke pa tvsh.	6. Oferta fituese: OE “L.K” shpk, me ofertë 27,037,612 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 14.04.2023, me afat 4 muaj.	7. Diferenca me fondin limit: 6,805,010 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit : 13.03.2023	9. Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës – 3 OE b) Skualifikuar – 1 OE c) Kualifikuar - 2 OE

11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka
----------------------------	---	--

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kritereve: 1. Kërkesa e pikës **3.3 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 55 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2. Kërkesa e pikës **3.4 në DST** e cila kërkon nga OE 1 inxhinier mjedisi drejtues teknik në licencën e shoqërisë, është kërkesë jo në përputhje me objektin e prokurimit. Për ekspertizën e këtij inxhinieri AK duhet ta mundësonte edhe me prezencën e këtij inxhinieri në listëpagesa, pa qenë e nevojshme të jetë njëkohësisht drejtues teknik në licencë.

3. Kërkesa e pikës **3.5 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 15 punëtorë ndërtimi të thjeshtë, është kërkesë evazive dhe e paargumentuar. Sipas pikës 3.3 kërkohet për zbatimin e kësaj kontrate 55 punonjës. Në vijim, kërkohen 3 inxhinierë, 2 teknik ndërtimi, 1 inxhinier elektrik, 1 elektrikist 3 betonues, 3 hekurkthyes, 2 karpentier, 15 punëtorë të thjeshtë dhe 8 shofer + manovratorë që bëjnë në total 38 punonjës. Sa më sipër, konstatohet se janë kërkuar 55 punonjës, ndërkohë që me profile përkatëse kërkohen 38 të tillë. Diferenca prej 17 punonjës nuk justifikohet, pasi punëtorë të thjeshtë janë kërkuar 15 të tillë, duke e lënë evazive së pari se çfarë dokumentesh kërkohen për punëtorët e thjeshtë, dhe çfarë stafi tjetër kërkohet për 17 punonjësit që nuk specifikohet ekspertiza që ata mund të ofrojnë.

4. Kërkesa e pikës **3.6 në DST** e cila kërkon 4 shoferë, është kërkesë e cila nuk përputhet me atë të kërkesës së pikës **3.8 të DST** për numrin e mjeteve të kërkuara për të cilat kërkohen shoferët. Konkretisht janë kërkuar 10 mjete për të cilat është e nevojshme disponimi i shoferit. Sa më sipër, konstatohet një mos përputhje dhe mos argumentim nga ana e NJP për hartimin e këtij kriteri. Sa më sipër, kemi një numër të lartë mjetesh të kërkuara, të cilat AK nuk i argumenton me volumet konkrete në raport me periudhën 4 mujore të kërkuar për zbatimin e punimeve dhe njëkohësisht se si do drejtohen këto mjete kur është kërkuar ky numër i kufizuar drejtuesish.

5. Gjithashtu, në pikën **3.8/b të DST**, NJP ka përcaktuar se *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre*. Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve*. Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

5.1. Kërkesa e pikës **3.8/c e DST**, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesë janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikim të padrejtë për OE.

Vlerësimi i ofertave: 1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **3.4 të DST** për 1 inxhinier topograf drejtues teknik në licencën e shoqërisë i cili të figurojë në listëpagesa 3 muajt e fundit. Për të përmbushur këtë kriter, është deklaruar inxhinier I. B., i cili nuk figuron në listëpagesë për muajin Dhjetor 2022 dhe Janar 2023, pra nuk figuron 3 muajt e fundit sa kërkuar në DST.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **3.5 të DST** për disa nga punonjësit e kualifikuar dhe konkretisht:

a.Për 1 inxhinier Elektrik, është deklaruar E.Rr, i cili nuk figuron në listëpagesën e muajit Dhjetor 2022, pra nuk figuron 3 muajt e fundit në listëpagesë.

b.Për 1 betonues nga 3 të kërkuar. Punonjësi Q. T nuk figuron në listëpagesën e shoqërisë për asnjë nga 3 muajt e fundit.

c.Për 1 hekurkthyes nga 3 të kërkuar. Punonjësi A. C nuk figuron në listëpagesën e shoqërisë për asnjë nga 3 muajt e fundit.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **3.6 të DST** për 2 nga 4 shoferët e kërkuar. L. B rezulton se ka kategorinë C të lejes së drejtimit jashtë afatit të vlefshmërisë nga data 20.10.2020, ndërsa për punonjësit Xh. L nuk është paraqitur dokumentacion.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, *duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e NjP dhe KVO.*

Ndikimi: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **27,037 mijë lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 5, nga anëtarët e NjP, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *Kërkesa e pikës 3.4 te DST, për inxhinier mjedisi drejtues teknik ne licencën e shoqërisë, është një kërkesë ne përputhje me objektin e prokurimit. Përveç faktit qe kemi te bëjmë me një vepër publike te një lloji te veçantë – park, e cila përmban kategori punimesh speciale dhe teknike te rëndësisë se veçantë te mbrojtjes se mjedisit dhe te punimeve te sipërfaqeve te gjelbëruara. I njëjti konstatim vlen edhe për punëtorët e kërkuara, punëtove te thjeshte ndërtimit 15 gjithsej. Ndërsa diferenca e punëtorëve te tjerë për te cilat nuk janë te specifikuar profilet përkatëse janë parashikuar punëtorë te thjeshte jo ndërtimi sikurse për mbledhje lulesh, pemësh, mirëmbajtje te tyre etj.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Pranohet pjesërisht observacioni juaj lidhur me kërkesën për inxhinier mjedisi, kjo referuar tipologjisë së punimeve, dhe faktit që kemi të bëjmë me ambiente të gjelbëruara ku ekspertiza e inxhinierit të mjedisit mund të jetë e nevojshme, por AK të marrë masa në procedura të ardhshme që këtë kërkesë ta mundësojë edhe me inxhinier mjedisi me kontratë ose që të figurojë në listëpagesa, pa qenë e nevojshme të jetë edhe drejtues teknik.

Lidhur me pjesën tjetër të observacionit që lidhet me stafin prej 15 punonjës të thjesht ndërtimi, kjo kërkesë është evazive, jo e argumentuar nga NjP e cila nuk i shërben procedurës, dhe si e tillë nuk pranohet observacioni juaj.

-Lidhur me vlerësimin e ofertave, audituesit do reflektojnë pikën e fundit të gjetjes që lidhet me mjetet, në të cilat nuk është përcaktuar objekti i prokurimit, qëndrim i cili është detajuar në rastet e ngjashme trajtuar më sipër.

23. Tenderi me objekt: “Sistemin asfaltim i rrugës fshatit Spathar (Loti I) Bashkia Librazhd”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës fshatit Spathar (Loti I) Bashkia Librazhd”		
1.Urdhër Prokurimi: 333 dt. 28.03.2023.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: datë 28.03.2023. 1. A. H - (Pergj.Sektori Prokurime) 2. A. H - () 3. J. B - (Sp. Sektori i Projekteve)	3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 333/1 datë 29.03.2023 1. J. M - (Kryetar) 2. D. B - (Anëtar) 3. Xh. B - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur ”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 83,324,105 leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: OE “B. N.” shpk, me ofertë 55,715,412 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 11.05.2023, me afat 4 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 27,608,693 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit : 14.04.2023	9.Burimi Financimit: Grant + Vetëfinancim	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës – 11 OE b)Skualifikuar – 2 OE c) Kualifikuar – 9 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **3.3 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 39 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës **3.6 në DST** e cila kërkon 4 shoferë dhe 4 manovratorë, është kërkesë e cila nuk përputhet me atë të kërkesës së pikës **3.8 të DST** për numrin e mjeteve të kërkuara për të cilat kërkohen shoferët dhe manovratorët. Konkretisht janë kërkuar 12 mjete për të cilat është e nevojshme disponimi i shoferit dhe 10 mjete për të cilat është e nevojshme disponimi i manovratorit. Sa më sipër, konstatohet një mos përputhje dhe mos argumentim nga ana e NJP për hartimin e këtij kriteri. Sa më sipër, kemi një numër të lartë mjetesh të kërkuara, të cilat AK nuk i argumenton me volumet konkrete në raport me periudhën 4 mujore të kërkuar për zbatimin e punimeve dhe njëkohësisht se si do drejtohen këto mjete kur është kërkuar ky numër i kufizuar drejtuesish.

3.Gjithashtu, në pikën **3.7/b të DST**, NjP ka përcaktuar se *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre.* Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.* Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

3.1.Kërkesa e pikës **3.7/c e DST**, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesë janë kosto të panevojshme për

OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikim të padrejtë për OE.

Vlerësimi i ofertave: 1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** e cila kërkon nga OE të paraqesë deklaratë sipas shtojcës 8 për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021 dhe 2022 në të gjitha vendet ku operatori ekonomik ka ushtuar aktivitet. Në shtojcën përkatëse, mungon deklarimi nga ky OE.

A.1.Lidhur me shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur pranë AK, rezultuan mangësi të OE si vijon:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e detyrimeve vendore pranë Bashkisë Librazhd për vitin 2022. Pavarësisht se ky OE ka lidhur disa kontrata përgjatë vitit 2022 pranë këtij AK, nuk rezulton apo nuk provohet me dokumentacion se ka likuiduar detyrimet vendore.

3.OE nuk përmbush kriterin për 1 manovrator nga 4 të kërkuar. Për manovratorin R. S, është paraqitur një leje manovrimi e lëshuar nga Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë që mban vitin 2004. Leja e manovrimit për këtë punonjës është në kundërshtim me nenin 3 të Urdhrit nr. 200, datë 16.05.2019 *“Për miratimin e rregullores “për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”* i cili përcakton se:

a) “Dëshmia e Aftësisë Profesionale” (DAP), dokument që provon se personi zotëron njohuri të mjaftueshme teorike dhe praktike mbi përcaktimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes nga aksidentet në punë dhe njohurive teknike dhe profesionale për përdorimin e makine

si dhe pikës 1 germa (a) të nenit 15 të urdhrimit të mësipërm i cili përcakton se:

a) Dëshmia e Aftësisë Profesionale është lëshuar nga Shoqata Kombëtare e Ndërtuesve para datës 23.3.2010, ajo do të pranohet të rinovohet nëse është në origjinal dhe në përputhje me praktikën protokollare të kësaj shoqate dorëzuar në DPSHTRR.

Sa më sipër, manovratori disponon një dokument të parinovuar i cili nuk është në fuqi në momentin e aplikimit.

4.OE nuk përmbush kriterin e pikës **3.8 të DST** për 2 nga mjetet e kërkuara dhe konkretisht:

-Për 1 rrul asfalti gome me peshë minimumi 5 Ton. Është paraqitur mjeti Ham Grw i cili rezulton sipas deklaratës doganore me kapacitet 4.6 Ton i cili është poshtë kapacitetit të kërkuar.

-Për mjetin kamionçinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 Ton, është paraqitur mjeti me targa AA853PK, i cili rezulton se ka policën e sigurimit jashtë afateve të vlefshmërisë prej datës 17.01.2023.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e NjP.

Ndikimi: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **55,715 mijë lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 5, nga anëtarët e NjP, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *1. Kërkesa e pikës 3.5 të DST, për inxhinier ndërtimi profili transport, është një kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit dhe është kërkuar si staf mbështetës dhe jo si drejtues teknik në licence, çka mund të plotësohet nga OE të interesuar edhe nëpërmjet një kontrate të thjeshtë pune. Duke patur në konsideratë që kemi të bëjmë me asfaltim rruge të një zone rurale, kemi gjykuar*

dhe argumentuar qe është e nevojshme qe kompania e cila do te zbatoje punimet te ketë te punësuar edhe një inxhinier ndërtimi profili transport.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Pranohet observacioni juaj lidhur me kërkesën për 1 inxhinier ndërtimi profili transport, duke qenë se kjo kërkesë ndër të tjera ka përcaktuar edhe mundësinë që ky inxhinier të disponohet me kontratë pune, pa qenë e detyrueshme të jetë edhe drejtues teknik në licencën e shoqërisë.

24. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe veprave të artit të Bashkisë Librazhd”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe veprave të artit të Bashkisë Librazhd”		
1.Urdhër Prokurimi: 184 dt. 16.02.2023.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Datë 16.02.2023. 1. S. K - (Pergj.Sektori Prokurime) 2. A. H - () 3. J. B - (Sp. Sektori i Projekteve)	3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 184/1 datë 16.02.2023 1. H. H - (Kryetar) 2. Xh. B - (Anëtar) 3. D. B - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e Thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 4,163,394 leke pa tvsh.	6.Oferta fituese: BOE “G.K” shpk & “V.K” shpk, me ofertë 4,104,859 - Lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 30.03.2023 me afat 28 ditë.	7.Diferenca me fondin limit: 58,535 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit : 02.03.2023	9.Burimi Financimit: Grant	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender – 1 OE b)Skualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar - 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve.

Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **3.3 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 18 punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës **3.7/b të DST**, NjP ka përcaktuar se *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre.* Lidhur me këtë kërkesë, sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.* Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

3.Kërkesa e pikës **3.7/c e DST**, e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese,

vetëm për të shtuar në të objektin që prokurohet. Këto kërkesë janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikim të padrejtë për OE.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e NjP si dhe anëtarët e KVO.

Ndikimi: Ul konkurrencën.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 5, nga anëtarët e NjP, janë paraqitur observacionet e administruara në KLSH me nr. 316/5 dhe 316/6 prot., datë 02.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: **1. Kërkesa e pikës 3.11 te DST:** “Leje / Autorizim për përdorim civil te lendeve plasëse te lëshuar nga autoritetet shtetërore ne një nga format ligjore ne fuqi”, është kërkesë ne përputhje me objektin e prokurimit, zërat e punimeve dhe specifikimet teknike te kërkuara. Gjithashtu për cdo procedure prokurimi Titullari i AK, ka ngritur grupe pune te veçantë për përlllogaritjen e fondit limit, hartimit te kriterëve te veçanta teknike, listës se mjeteve, grafikut te punimeve etj. Njësia e Prokurimit mbështetur ne analizën teknike dhe ligjore te këtij komisioni ka përcaktuar edhe ne DST, formulimin e kriterëve teknike te veçanta ne DST, sikurse kriteri 3.11 ne DST.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Pranohet observacioni juaj. Siç është cituar tek gjetja, audituesit kanë sqaruar se zërat për përdorimin e lëndëve plasëse janë minimal, ku kërkesat për autorizime për përdorim lëndësh plasëse mund të jenë të tepërta. Të konsiderohet shmangia e këtyre kriterëve.

25. Tenderi me objekt: “Blerje mallra për mirëmbajtje të rrugëve rurale”, me këto të dhëna:

“Blerje mallra për mirëmbajtje të rrugëve rurale”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.308, datë 23.03.2023	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.308, datë 23.03.2023	3.Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr.308/1, datë 23.03.2023
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”	1. S. K –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. B. K - (Anëtar) 3. M. D – (Anëtar)	1. J. M – (Kryetar) 2. A. P - (Anëtar) 3. D. B– (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 4'561'690- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: B.O.E ‘H’ sh.p.k dhe “E.L PF ofertë 4'151'340 pa tvsh - Lekë, me lidhje kontrate datë 27/04/2023	7.Diferenca me fondin limit: 410,350 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 03.04.2023	9.Burimi Financimit: Grant	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për vlerësimin e ofertave.

Situata: Vlerësimi i ofertave: 1-Sipas kriterëve të përgjithshme në DST nuk ka dorëzuar vërtetimin që operatori ekonomik nuk është në proces falimenti (statusi aktiv) sipas DST kriteret e përgjithshme të kualifikimit/përzgjedhjes.

2- Sipas kriterëve të përgjithshme në DST operatorët ekonomik nuk kanë paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore.

3- Sipas kriterëve të përgjithshme në DST operatorët ekonomik nuk kanë paraqitur vërtetim për shlyerjen e energjisë elektrike.

4- Sipas kriterëve të përgjithshme në DST operatorët ekonomik nuk kanë paraqitur vërtetim nga APP që subjektet nuk kanë qenë të ndaluar gjatë tre viteve të fundit për të marrë pjesë në procedura prokurimi.

5- Sipas kriterit “kapaciteti teknik” pika 2.3.1 tek kriteret e veçanta në DST operatori ekonomik “E.L” PF për punët e ngjashme ka sjell vetëm faturën tatimore të shitjes dhe jo vërtetim nga Autoriteti për përmbushjen e procedurës.

6-Sipas kriterëve të përgjithshme në DST operatorët ekonomik nuk kanë paraqitur vërtetim nga gjykata për anëtarët e shoqërive dhe për shoqëritë.

7-Sipas kriterëve të veçanta në DST pika 3.1“H” shpk nuk ka paraqitur certifikatën ISO sipas kërkesave në DST.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO.

Ndikimi: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **4,151 mijë lekë** pa TVSH..

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

26. Tenderi me objekt: “Rikonstrukcion në tregun e qytetit”, me këto të dhëna:

“Blerje mallra për mirëmbajtje të rrugëve rurale”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.217, datë 22.02.2023	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.217, datë 22.02.2023	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.217/1, datë 22.02.2023
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ‘E hapur e thjeshtuar ‘	1. S. K –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. J. B - (Anëtar) 3. A. P –(Anëtar)	1. J. M – (Kryetar) 2. Ç. V - (Anëtar) 3. D. B– (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 2’597’441- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: O.E Z.K ofertë 2’545’104 pa tvsh - Lekë, me lidhje kontrate datë 27/04/2023	7.Diferenca me fondin limit: 52,337 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 16.03.2023	9.Burimi Financimit: Grant	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i Kriterëve: 1.Pika 3.3. Operatori ekonomik duhet të ketë stafin e nevojshëm për kryerjen e këtij investimi një punësim mesatar minimumi prej 11 (njëmbëdhjete) persona duke përfshirë dhe stafin drejtues dhe teknik, **për periudhën nëntor 2022-janar 2023.**

Kjo kërkesë nuk është në përputhje me pikën 6 germa (ç) të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 09.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhën kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës, OE të disponojë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës **3.7/b e DST** e cila përcakton se “Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre”. Lidhur me këtë kërkesë,

sqarohet se ajo është e pa plotë dhe jo në përputhje me paragrafin e fundit të pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 të cituar më sipër, e cila përcakton se "Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve". Sa më sipër, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të disponojnë OE.

3. Kërkesa e pikës 3.7/c e DST e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që për mjetet e marra me qira, në objektin e kontratës të specifikohet objekti dhe afati i saj. Pikërisht pjesa në të cilët kërkohet që kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t'u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikimin e tyre.

Vlerësimi i ofertave: 1-Sipas kriterëve të veçanta në DST pika 3.4 operatori fitues nuk ka paraqitur dokumentacionin për inxhinierin e ndërtimit profil struktura.

2-Sipas kriterëve të veçanta në DST pika 3.7 për mjetin kamionçinë me targa AA682AS me kapacitet mbajtës 3.5 ton certifikata për transport mallrash specifikohet vetëm për llogari të vet dhe jo për palë të treta dhe qiradhënie. Ky mjet është marrë me qira nga operatori.

3- Sipas kriterëve të veçanta në DST pika 3.7 për mjetin me targa AA525DJ me kapacitet mbajtës mbi 10 ton certifikata për transport mallrash specifikohet vetëm për llogari të vet dhe jo për palë të treta dhe qiradhënie. Ky mjet është marrë me qira nga operatori.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO.

Ndikimi: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **2,545 mijë lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Pika 4.4. Mbi zbatimin e kontratave të punëve dhe shërbimeve publike.

1. Mbi zbatimin e Kontratës së Punimeve Civile "Ndërtim i ujësjellësit të Fshatit Polis Gostimë, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd".

Kontrata "Ndërtim i ujësjellësit të Fshatit Polis Gostimë, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd", është nënshkruar me nr. 5330 prot., datë 11.10.2021, ndërmjet Bashkisë Librazhd, përfaqësuar nga z. B. P në cilësinë e Titullarit të AK (i autorizuar) dhe BOE "M dhe Sh" SHPK, përfaqësuar nga z. E. B dhe z. Y. B, me vlerë 77,721,107 lekë me TVSH. Leja e infrastrukturës është miratuar me nr. 522, datë 13.12.2021.

Financimi i kësaj kontrate është përcaktuar me vlerë 5,152,916 lekë për vitin 2022, 5,156,467 lekë për vitin 2023 dhe 51,518,194 lekë për vitin 2024. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 5 muaj, referuar datës së fillimit të tyre. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria "N. S" SHPK, përfaqësuar nga z. E. N, me të cilin është nënshkruar kontrata nr. 5331 prot., datë 11.10.2021. Për kolaudimin e punimeve është përzgjedhur z. N. M, me të cilin është nënshkruar kontrata nr. 1941 prot., datë 11.04.2023.

Njoftimi për fillimin e punimeve është protokolluar në Bashkinë Librazhd me nr. 6553 prot., datë 15.12.2021. Bazuar në ditarin përkatës, punimet kanë filluar me datë 15.12.2021. Me datë 13.04.2022, ka patur pezullim punimesh të cilat kanë rifilluar me datë 19.05.2022. Me datë 24.05.2022, punimet janë pezulluar përsëri, kanë rifilluar me datë 31.10.2022 dhe kanë përfunduar me datë 09.12.2022.

Gjatë periudhës fillim punimesh 15.12.2021 deri me datë 13.04.2022, ka patur ndërprerje punimesh për arsye të motit të papërshtatshëm në tre raste me 16 ditë gjithsej, ndërsa gjatë periudhës nga data 19.05.2022 deri 24.05.2022 dhe 31.10.2022 deri 09.12.2022, nuk ka patur ndërprerje për arsye të motit.

Pezullimi i punimeve është bërë për shkak se banorët e zonës kanë penguar marrjen e ujit në kaptazhin nr. 1. Për këtë qëllim është miratuar amendamenti nr. 2029/1 prot., datë 24.05.2022. Duke marrë në konsideratë shtesën e periudhës sipas amendamentit të kontratës, duke zbritur si dhe ndërprerjet për shkak të motit, punimet janë realizuar për 5 muaj, brenda afatit të parashikuar.

Situacioni përfundimtar është hartuar me vlerë 77,721,107 lekë. Akti i kolauditimit është mbajtur me datë 14.04.2023. Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve është lëshuar me datë 18.04.2023, nga grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga z. Xh.B, znj. A. H dhe z. A.P.

Nga auditimi u konstatuan mangësi si më poshtë:

1. Titulli i gjetjes:	Referencë e gabuar e çmimit për zë të ri punimi, si dhe mos respektim i specifikimeve teknike.
Situata:	<p>Nga auditimi i dokumentacionit teknik sipas kontratës “Ndërtim i ujësjellësit të Fshatit Polis Gostimë, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd”, u konstatua se sipas zërit I.1.1 “Gërmim dheu me ekskavator me goma 0.25 m³, me gjerësi 2 m, tokë e zakonshme me shkarkim në mjet”, në preventiv është parashikuar sasia 1238 m³. Bazuar në librin e masave dhe situacionin përfundimtar, kjo sasi paraqitet e realizuar në masën 9996 m³. Në procesverbalin e ndryshimit të volumeve të datës 11.04.2022, përcaktohet: Për zërin I.1.1 “Gërmim dheu me ekskavator me goma 0.25 m³, me gjerësi 2 m, tokë e zakonshme me shkarkim në mjet”, ishte parashikuar sasia 1238 m³, ndërsa nga matjet që janë bërë në fakt janë 9996 m³, pra 8758 m³ më shumë. Kjo diferencë vjen për faktin se në projektin fillestar, duke parë dhe profilet tërthorë nuk ishin parashikuar hapje traseje rruge për linjën e tubave të transmetimit, kështu që është parë i nevojshëm ndryshimi.</p> <p>Në librezë masash sipas zërit “Hapje traseje për kalimin e tubit të çelikut” është përcaktuar sasia për zonën 2, në sasinë 6030.5 m³, zonën 3, në sasinë 2654 m³ dhe zonën 4, në sasinë 648.3 m³.</p> <p>Procesi i punimit hapje trase rruge, nuk përfshihet në punimet e gërmimit në kanal, por gërmime në seksion të lirë. Po ashtu, bazuar në volumet e përshkruara, sasia e materialit të gërmuar nuk është transportuar, duke mos argumentuar hedhjen e materialit në mjet (përfshirë zonën 3). Gjerësia e seksioneve të gërmimit është raportuar për seksione mbi 2 m.</p> <p>Bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, ky zë punimi duhet të referohej sipas analizës 3.87/b “Gërmim dheu me ekskavator me goma 0.25 m³, në kanale me gjerësi mbi 2 m, tokë e zakonshme kat. III, me shkarkim në tokë”, zë i cili ka çmim 282 lekë/m³. Çmimi sipas preventivit dhe situacionit përfundimtar është 360 lekë/m³. Si pasojë e referencës së gabuar të çmimit, nga ana e Kontraktorit BOE “M dhe Sh” SHPK, është përfituar më tepër vlera 572,676 lekë [(360 lekë/m³ – 282 lekë/m³) x 7342 m³], vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik.</p> <p>Nga verifikimi sipas zërave III.3.5, V.2.5 dhe VI.3.5 “Rrethim me zgarë metalike të galvanizuar...”, u konstatua se materiali i përdorur nuk është zgarë metalike e galvanizuar, pro rrjetë teli dhe rrjetë gabion. Punimet konsistojnë në rrethimin e depos së ujit dhe 2 kaptazheve, në sasinë 271 m² (162 + 58 + 51). Vlera (271 m² x 4,500 lekë/m²).</p>

	Duke zbritur çmimin e tubave për m ² (afërsisht) 4 kg, me çmim 98 lekë/kg, me vlerë 392 lekë/m ² (970 kg x 98 lekë/kg), si dhe rretë teli e galvanizuar me çmim 1,306 lekë/m ² , konstatohet se nga çmimi i certifikuar 4,500 lekë/m ² , duhet të likuidohej me çmim 2,802 lekë (4,500 – 392 – 1,306). Vlera 460,158 lekë [271 m ² x (4,500 lekë/m ² – 2,802 lekë/m ²)], i është certifikuar padrejtësisht Kontraktorit BOE “M dhe Sh” SHPK dhe përbën dëm ekonomik. Tek mbikalimi i përroit, në një distancë 50 m, nuk janë përfunduar punimet për mbulimin e tubacionit të çelikut.
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7. VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu III, pika 4.
Ndikimi:	Realizim i punimeve me çmim më të lartë, duke rritur koston e tyre.
Shkaku	Mos argumentimi i ndryshimit të proceseve të punës.
Rëndësia:	E mesme
1.1 Rekomandim	Bashkia Librazhd, të marrë masat për zbritjen e vlerës 1,032,834 lekë , nga garancia e punimeve, Kontraktorit BOE “M dhe Sh” SHPK , për punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike, si dhe referencë e gabuar e çmimit për një zë punimi.

2. Titulli i gjetjes:	Dokumentacioni i dosjes teknike i pa plotësuar.
Situata:	Nga verifikimi i sasive të raportuara në librin e masave, sipas kontratës Ndërtim i ujësjellësit të Fshatit Polis Gostimë, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd”, për gjërmim traseje rruge, nuk është përcaktuar thellësia e gjërimit, por vetëm gjerësia në fillim dhe fund të piketës dhe gjatësia ndërmjet piketave. Nga auditimi i dosjes teknike, u konstatua se nuk është paraqitur dokumentacioni i vizatimeve të azhurnimit të linjave.
Kriteri:	Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2015 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 9. b
Ndikimi:	Vështirësi në identifikimin e saktë të volumit të punimeve të realizuara.
Shkaku	Neglizhencë në plotësimin e dokumentacionit teknik.
Rëndësia:	E mesme
2.1 Rekomandimi:	Bashkia Librazhd të kërkojë nga mbikëqyrësit e punimeve plotësimin e dosjes teknike për objektet në zbatim, hap pas hapi dhe konformë kërkesave ligjore.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve Shoqëria “N.S”.

2. Mbi zbatimin e kontratës “Ndërtim i Parkut Qendror, Bashkia Librazhd”, faza e parë.

Kontrata “Ndërtim i Parkut Qendror, Bashkia Librazhd”, është nënshkruar ndërmjet Bashkisë Librazhd, përfaqësuar nga z. B. P dhe BOE “E SHPK dhe L.K SHPK”, me nr. 4948 prot., datë 22.09.2021, me vlerë 36,204,188.7 lekë. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria “N.S” SHPK, me të cilën është nënshkruar kontrata nr. 3360 prot., datë 17.06.2021. Për kolaudimin e punimeve është kontraktuar OE “Gj.P”. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 3 muaj, referuar miratimit të lejes së ndërtimit.

Leja e infrastrukturës është miratuar me nr. 575, datë 26.09.2022. Njoftimi për fillimin e punimeve është bërë me nr. 94 prot., datë 03.10.2022. Nga ana e Kontraktorit dhe mbikëqyrësit

të punimeve është hartuar relacioni protokolluar në Bashkinë Librazhd me nr. 4521 prot., datë 10.10.2022, për disa mangësi të konstatuara në projektin e zbatimit. Po ashtu është mbajtur një procesverbal i ndryshimit të volumeve të disa zërave të punimeve dhe është hartuar preventivi me volume të saktësuara rakorduar me shtesa dhe pakësim.

Njoftimi për përfundimin e punimeve është bërë me shkresë të protokolluar në Bashkinë Librazhd nr. 12 prot., datë 04.01.2023. Situacioni përfundimtar është certifikuar me vlerë 43,445,025.8 lekë.

Bazuar në ditarin e punimeve, punimet kanë filluar me datë 04.10.2022 dhe kanë përfunduar me datë 04.01.2023, brenda afatit të parashikuar në kontratë.

Akti i kolaudimit është hartuar nga Kolaudatori z. Gj.P, me datë 16.12.2022, para përfundimit të punimeve (data konsiderohet gabim njerëzor, pasi kontrata për kolaudimin është nënshkruar me datë 16.02.2023). Procesverbali i marrjes në dorëzim të përkohshëm, është mbajtur nga grupi i përbërë nga z. Xh.B, znj. A.H dhe z. A.P, me datë 08.05.2023.

Nga auditimi u konstatuan mangësi si më poshtë:

1. Titulli i gjetjes:	Punime të certifikuar dhe të realizuara pa respektuar specifikimet teknike.
Situata:	<p>Nga verifikimi i punimeve sipas kontratës “Ndërtim i Parkut Qendror, Bashkia Librazhd”, janë konsatuar mangësi si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga verifikimi në objekt rezulton se sipas zërit 14.15 “F.V puseta plastike 40 x 40 x 40 cm, kapak të fortë RC 1084+1086” me çmim preventivi 3,200 lekë/copë, rezulton se pusetat janë furnizuar dhe vendosur me dimensione 30 x 30 x 30 cm. - Nga verifikimi sipas zërit 6.d.5 “F.V pemë dekorative Bli 16-18 cm”, rezulton se janë vendosur pemë me diametr 5 cm. Çmimi i preventivit dhe situacionit përfundimtar për këtë zë është 15,400 lekë/copë. Në kushtet e mos plotësimit të plotësimit të specifikimeve teknike, referenca e çmimit duhet të merrej bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, zëri 3. An164 “F.V fidanë pemë dekorative”, ku paraqitet çmimi 10,704 lekë/copë. Vlera 98,616 lekë [21 copë (15,400 lekë/copë – 10,704 lekë/copë)], është certifikuar më tepër Kontraktorit BOE “E SHPK dhe L.K SHPK”, vlerë e cila përbën dëm ekonomik. - Nga verifikimi sipas zërave 2.d.3, 6. d.3, 13.c.3 “F.V S.” u konstatua se janë vendosur 17 copë, ndërsa janë certifikuar 23 copë. Vlera 144,000 lekë (6 copë x 24,000 lekë/copë), i është certifikuar më tepër Kontraktorit BOE “E SHPK dhe L.K SHPK” dhe përbën dëm ekonomik. - Nga verifikimi sipas zërave 4.b.5, 6.b.5, 7.d.6 dhe 8.b.5 “Rrafshim betoni me kuarc me ngjyrë”, është certifikuar sasia 1259.6 m² (201 m² + 912 m² + 50 m² + 96.6 m²). Nga verifikimi në objekt, rezulton se është realizuar rrafshim me kuarc me ngjyrë vetëm sipas zërit 8.b.5 (punime për rrugicën qendrore), në sasinë 96.6 m². Vlera 837,360 lekë (1163 m² x 720 lekë/m²), është certifikuar më tepër kontraktorit BOE “E SHPK dhe L.K SHPK” dhe përbën dëm ekonomik.
Kriteri:	<p>Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.</p> <p>Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.</p>
Ndikimi:	Përfitim i padrejtë i kontraktorit, për punime të cilat nuk plotësojnë specifikimet teknike.
Shkaku	Mos ndjekja e kontratës me korrektësi.
Rëndësia:	E mesme

1.1 Rekomandim	Bashkia Librazhd të marrë masa për zbritjen e vlerës 1,079,976 lekë , nga vlera e sigurimit të kontratës Kontraktorit BOE “E SHPK dhe L.K SHPK” , për punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike.
---------------------------	--

3. Mbi zbatimin e kontratës “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse në Bashkinë Librazhd”.

Kontrata e punimeve civile “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse në Bashkinë Librazhd”, është nënshkruar me nr. 4434 prot., datë 05.10.2022, ndërmjet Bashkisë Librazhd përfaqësuar nga z. B.P dhe Kontraktorit “A. C” SHPK, me vlerë 11,428,050 lekë. Afati për përfundimin e punimeve është përcaktuar 40 ditë.

Për menaxhimin e kontratës është emëruar z. Xh.B. Për kolaudidimin e punimeve është përzgjedhur OE “Z. K” SHPK, me të cilin është nënshkruar kontrata nr. 5599 prot., datë 13.12.2022. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur OE “N. S”.

Njoftimi i fillimit të punimeve është bërë me nr. 95 prot., datë 05.10.2022. Bazuar në ditarin e punimeve dhe njoftimin përkatës, punimet kanë përfunduar me datë 15.11.2022, brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Situacioni përfundimtar është certifikuar me vlerë 11,426,435.6 lekë me TVSH. Akti i kolauditimit është mbajtur me datë 15.12.2022. Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve është lëshuar me datë 15.12.2022.

1. Titulli i gjetjes:	Punime të certifikuar dhe të pa realizuara në sasinë e raportuar.
Situata:	<p>Sipas kontratës “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse në Bashkinë Librazhd”, janë konstatuar mangësi si më poshtë:</p> <p>Nga verifikimi i punimeve për realizimin e veshjes së kanalit me beton sipas zërit II.A.1. Struktura monolite betoni C 16/20 për kanale” nga piketa 0+000 deri 1+260 rezulton se skarpatat e kanalit janë realizuar me gjatësi mesatare 65 cm, ndërkohë që në librin e masave kjo gjatësi përcaktohet gjatësia 73 cm. Sipërfaqja e seksionit tërthor të llogaritur është 0.296 m², ndërkohë që nga korrektimi rezulton 0.272 m², me një diferencë 30 m³ [(0.296 m² -0.272 m²) x 1260 ml] beton si dhe zhavorr. Vlera 330,300 lekë (30 m³ x 11,010 lekë/m³) i është certifikuar më tepër Kontraktorit “A C” SHPK, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.</p> <p>-Sipas zërit “Shtresë zhavorr lumi t=10 cm”, është certifikuar më shuma sasia 201 m² (0.16 m x 1260 m), me vlerë 56,682 lekë (201 m² x 282 lekë/m²), vlerë e cila përbën dëm ekonomik.</p> <p>- Sipas zërit “gërmim dheu” është certifikuar më shumë sasia 41 m³ (201 m² x 0.2 m), me vlerë 29,263 lekë (41 m³ x 723 lekë/m³), vlerë e cila përbën dëm ekonomik.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.</p> <p>Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.</p>
Ndikimi:	Përfitim i padrejtë i kontraktorit, për punime të cilat nuk plotësojnë specifikimet teknike.
Shkaku	Mos ndjekja e kontratës me korrektësi.
Rëndësia:	E mesme

1.1 Rekomandim	Bashkia Librazhd të marrë masa për zbritjen e vlerës 416,245 lekë , nga vlera e sigurimit të kontratës Kontraktorit “A. C” SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në sasinë e raportuar.
-------------------	---

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve Shoqëria “N. S”.

Pika 5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

-Për periudhën 01.01.2022 – 30.04.2023 janë miratuar 15 Leje Ndërtimi tipologjia e të cilave në përgjithësi është për objekte banimi. Nga 15 lejet e ndërtimit të miratuara, 5 janë për objekte mbi 250 m² dhe 10 leje nën 250 m². (*Lista e lejeve sipas aneksit nr. 5, bashkëlidhur projektraportit të auditimit*)

-U audituan lejet e ndërtimit mbi 250 m² dhe konkretisht:

Titulli i gjetjes: Mangësi me policat e sigurimit të projektuesve. Përlllogaritje e gabuar e TNI me efekt financiar për buxhetin e Bashkisë Librazhd.

Situata 1: Sipas regjistrimit elektronik nr. 535 në emër të zhvilluesit I.B, me datë aplikimi 30.01.2022, për objektin: *“Zgjerim Aktiviteti, “Strukturë akomoduese” Ndërtim shtëpi pushimi kurative malore 2 kate + papafingo”*.

-Për inxhinierin gjeolog A.M, i cili ka hartuar projektin dhe relacionin konstruktiv të këtij objekti, mungon polica e sigurimit të projektuesve për mbulimin e përgjegjësisë profesionale, në kundërshtim me pikën 1, germa (g) të nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar.

Situata 2: Sipas regjistrimit elektronik nr. 538 në emër të zhvilluesit S.H, me datë aplikimi 14.02.2022, për objektin: *“Prishje objekti ekzistues 2 kat dhe ndërtim objekti 2 kate + 1 kat nëntokë”*.

-Në planvendosje nuk pasqyrohet rievimi topografik, në të cilën evidentohet gjendja ekzistuese e pronës dhe objekteve përreth. Mungesa e të dhënave përshtirë objektet me të cilat kufizohet, krijon problematikën e mos verifikimit të respektimit të distancave ndërmjet objekteve.

-Për inxhinierin gjeolog R.B, i cili ka hartuar projektin dhe relacionin konstruktiv të këtij objekti, mungon polica e sigurimit të projektuesve për mbulimin e përgjegjësisë profesionale, në kundërshtim me pikën 1, germa (g) të nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar.

-Polica e sigurimit për mbulimin e përgjegjësisë profesionale për arkitektët dhe inxhinierët e studios projektuese N.G shpk, rezulton se ka afat vlefshmërie deri me datë 25 Janar 2022, ndërkohë data e aplikimit për lejen e ndërtimit është 14 Shkurt 2022.

Situata 3: Sipas regjistrimit elektronik nr. 589 në emër të zhvilluesit Sh.H, me datë aplikimi 30.09.2022, për objektin: *“Prishje e objektit ekzistues dhe Ndërtim Banese individuale 2 Kate + 1 Kat Nëntokë”*.

-Polica e sigurimit për mbulimin e përgjegjësive profesionale për arkitektët dhe inxhinierët e studios projektuese N.G shpk, rezulton se ka afat vlefshmërie deri me datë 25 Janar 2022, ndërkohë data e aplikimit për lejen e ndërtimit është 30 Shtator 2022.

Situata 4: Sipas regjistrimit elektronik nr. 623 në emër të zhvilluesit S.L, me datë aplikimi 09.01.2023, për objektin: “*Objekt 1 kat bodrum nëntokë, 1 kat shërbim dhe 1kat banesë*”.

-Leja nuk ka mangësi.

Situata 5: Sipas regjistrimit elektronik nr. 625 në emër të zhvilluesit L.H, me datë aplikimi 09.02.2023, për objektin: “*Objekt 1 kat me 2 kate nëntokë*”.

d.Sipas përllogaritjes së TNI të bërë nga llogaritari, subjekti ka likuiduar vlerën prej 1,314,550 lekë sipas vërtetimit bankar.

Për TNI, përllogaritja është bërë mbi preventivin e punimeve.

-Vlera e preventivit është 43,818,323.45 lekë x 3% koeficienti i tarifës = 1,314,549.7 lekë.

-Lidhur me përllogaritjet e mësipërme, rezulton se është kryer në kundërshtim me legjislacionin përkatës konkretisht:

Neni 46 i ligjit nr. 28/2017 “Për disa ndryshimet dhe shtesa në Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar ku citohet: *Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet e reja që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet sipas legjislacionit për taksat vendore.*

Ligji mbi të cilin do bëhet përllogaritja do jetë ligji nr. 9632, datë 30.06.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 7 pika 1 e të cilit përcakton se: *Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.*

Neni 9, pika 2 e ligjit 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 9632, datë 30.06.2006 “Për sistemin e taksave vendore” përcaktohet se:

Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4% deri 8% të të çmimit të shitjes për metër katror.

Sipas projektit dhe relacionit arkitektonik, kati i parë (përdhes) është njësi shërbimi dhe 2 kate nëntokë (parkim)

-Sipas paketës fiskale për vitin 2023, baza e taksës për objektet e reja për njësi tregtimi dhe shërbimi është 6%.

-Çmimi i shitjes sipas UKM nr. 3, datë 28.12.2016 për Bashkinë Librazhd është 44,000 lekë.

-Sipas VKM-së nr. 168, datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018 të Këshillit të Ministrave, “për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, Aneksi nr. 1, sipas të cilit çmimi referues për Bashkinë Librazhd është 44,000 lekë. Në aneksin nr. 2 të këtij vendimi, në gërmën **a** përcaktohet se çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve, dhe germa b përcakton se çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të

mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

Përlllogaritja rezulton si më poshtë:

- 1.Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit nëntokë $1013.5 \text{ m}^2 \times 44,000 \times 6\% \times 0.7 = 1,872,948$ lekë;
- 2.Kati në kuotën 0.00 sipërfaqe $272 \text{ m}^2 \times 44,000 \times 6\% \times 1.5 = 1,077,120$ lekë;

Sa më sipër, vlera e përlllogaritur nga TNI për ndërtimit e ri, është 2,950,068 lekë dhe jo 1,314,550 lekë sa është përlllogaritur nga personi përgjegjës. Diferenca prej 1,635,518 lekë, e pallogaritur në mënyrë të saktë, përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Librazhd.

Ndikimi: Projektim nga studio që nuk mbulojnë përgjegjësinë me polica sigurimit. Mungesë të ardhurash për Bashkinë Librazhd në vlerën **1, 635,518 lekë** nga përlllogaritja e gabuar e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Librazhd.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim 1: 1.Nga DPZHT të merren masa për vlerësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e lejeve, duke i dhënë rëndësi edhe policave të sigurimit, pasi në mënyrë të përhapur ato janë jashtë afateve të vlefshmërisë dhe nuk mbulojnë përgjegjësinë profesionale të projektuesve.

Rekomandim 2: 1.Nga DPZHT dhe Drejtoria e Taksave, të bashkërendohet puna për nxjerrjen e njoftimit detyrimit ndaj subjektit L.H për arkëtimin e shumës **1,635,518 lekë**, detyrim që rrjedh nga përlllogaritja e gabuar e taksës së ndikimit në infrastrukturë, vlerë që përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Librazhd.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Zj. B.B - Drejtor i Urbanistikës
2. Z. J. M – Kontrollues
- 3.Zj. J. B – Specialiste

Pika 6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)

Titulli i Gjetjes: Mos aplikim i masave administrative për shkeljet e konstatuara.

Situata: Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit Vendor, për periudhën 01.01.2022 -31.12.2022, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.

1.Për periudhën objekt auditimi 01.01.2022 deri 31.12.2022 IMTV është drejtuar nga K/inspektor Sh.G, i cili rezulton me arsim oficer ushtarak, dhe inspektor L.T me arsim të mesëm.

Për sa më sipër, konstatohet se IMTV Bashkia Librazhd, përgjatë periudhës objekt auditimi, ka rekrutuar stafin në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i cili përcakton se:

<i>Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.</i>

-Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, janë mbajtur 7 akte konstatimi nga të cilat 6 për punime pa leje dhe 1 konstatim për kryeje punimesh në përputhje me deklaratën. Rezulton të jenë nxjerrë 3 vendime gjobe dhe 2 vendime për prishje ndërtimi. Nuk ka vendim për pezullim punimesh.

2.Për aktivitetin e vitit 2022, rezulton se janë mbajtur 7 procesverbale konstatimi, nga të cilat janë nxjerrë 3 vendime gjobe. Nuk ka vendime për pezullimin e punimeve dhe për prishjen e tyre.

Rezulton se nga 7 procesverbale konstatimi, Kryeinspektori i IMT në kundërshtim me nenin 5, germa b, ç dhe d të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar dhe nenit 52 “Kundërvajtjet administrative” pika e të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” nuk ka marrë masat e duhura për përmbushjen e detyrimeve ligjore, duke mos vendosur gjoba në 3 raste, duke mos pezulluar punimet si dhe duke mos prishur ndërtimet e kundërligjshme.

3.Lidhur me gjobat e vendosura, konstatohet sërish mangësi në veprimtarinë e IMTV, pasi masa e gjobës për 3 subjektet e gjobitura, është aplikuar gabim, pasi me ligjin nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në nenin 52, pika 1 germa (e), është ndryshuar si më poshtë:

<i>e)kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi dhe me....</i>
--

Në këto kushte masa e gjobës e caktuar 50,000/ 300,000/ 500,000 lekë është masë e cila nuk mbështetet në ligj, pasi me ndryshimet e cituara më sipër, masa e gjobës përlllogaritet sipas vlerës së punimeve të kryera pa leje, dhe në çdo rast kur kemi të bëjmë me ndërtim për qëllime fitimi, masa e gjobës është jo më pak se 35,000 lekë për metër katror.

-Lidhur me këto mangësi, audituesit kanë sqaruar, se do duhej që në stafin e IMTV-së të kishte staf të kualifikuar, sidomos me profil inxhinierik, pasi me ndryshimet e ligjit nuk kemi më minimum gjobe në vlerë të përcaktuar, por kërkohet ekspertizë dhe staf i kualifikuar për të nxjerrë përlllogaritjet dhe nxjerr masën e gjobës në përputhje me dispozitat ligjore.

4. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar.

5. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

6.Nga kontrolli i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi, k/inspektori i IMT, nuk ka përcjellë Kallëzime Penale ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimore pa leje nga organet përkatëse, në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar.

7.Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori/ët kanë nxjerrë disa vendime për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje, por rezulton se nuk ka marrë apo pasqyruar asnjë masë apo procesverbal për ekzekutimin e vendimit të prishjes së këtyre ndërtimeve.

8.Lidhur me konstatimet e mësipërme, në asnjë rast nuk disponohej një dosje e hapur për subjektin kundërvajtës, por procesverbalet e mbajtura dhe aktet që ka nxjerrë inspektorati, ishin vetëm nëpër blloqe, duke mos pasur një praktikë estetike të administrimit të dokumentacionit.

9.Nga kontrolli i dokumentacionit, u konstatua se procedurat nuk dispononin fotot e konstatimit, të cilat janë të nevojshme për dokumentimin e kundërvajtjes së kryer. Mungesa e fotografive të kundërvajtjes, është veprim në kundërshtim me nenin 41 “Të drejta të tjera të inspektorit”, germa (a) të ligjit me nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton se:

Inspektori, brenda objektit dhe qëllimit të inspektimit, ka edhe këto të drejta

a)të kryejë fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjediseve, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, mjediseve, objekteve, mjeteve të transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave, përbërësve dhe çdo sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit.

10.Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori, për periudhën objekt auditimi nuk ka miratuar planet mujore të punës, veprim ky në kundërshtim me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, dhe pika 2 e nenit 106 të Rregullores së Bashkisë Librazhd, miratuar me vendimin nr. 5311, datë 06.12.2019 të Titullarit.

11.Lidhur me gjobat e vendosura nga IMT për vitin 2022, rezulton se asnjëra prej tyre nuk është arkëtuar, dhe njëkohësisht nuk është bërë asnjë kërkesë në gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv.

12.Në lidhje me gjobat e nxjerra përgjatë vitit 2020 – 2021, rezulton se janë në total 19 gjoba me vlerë 2,100,000 lekë, nga të cilat 12 i takojnë vitit 2020 me vlerë 920,000 lekë dhe 7 gjoba janë të vitit 2021 me vlerë 1,120,000 lekë. Janë likuiduar 8 gjoba të vitit 2020 me vlerë 760,000 lekë, dhe janë debitor 4 gjoba në vlerë 160,000 lekë. Janë likuiduar 3 gjoba të vitit 2021 me vlerë 630,000 lekë dhe janë debitor 4 gjoba me vlerë 550,000 lekë.

Lidhur me gjobat e pa likuiduara, rezulton se për asnjërën prej tyre, nuk janë bërë kërkesë padi drejtuar gjykatës për kthimin e tyre në titull ekzekutiv. Kryeinspektori i IMT, është mjaftuar vetëm me përcjelljen e tyre pranë Zyrës së Financës e cila ka bërë kontabilizimin e tyre, dhe nuk ka asnjë procedurë tjetër të ndjekur nga punonjësit e Bashkisë Librazhd për ndjekjen e procedurave tjera ligjore për arkëtimin e këtyre gjobave. Për 4 gjobat e vitit 2020 dhe 1 gjobë e vitit 2021, është tejkaluar afati 2 vjeçar, duke bërë që këto gjoba të parashkruhen, veprime të cilat ndikojnë në të ardhurat e Bashkisë Librazhd.

Kriteri: Ligji 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 5 germa (a, b, ç, d, f), neni 11; Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 51 “Inspektimi”; neni 41 “Të drejta të tjera të inspektorit”, germa (a) të ligjit me nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; pika 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; pika 2 e nenit 106 të Rregullores së Bashkisë Librazhd, miratuar me vendimin nr. 5311, datë 06.12.2019 të Titullarit.

Ndikimi: Ndikon në ndërtimet e reja në mos përputhje të planit rregullues. Shmangen detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Shkaku: Mos përmbushje e detyrave të ngarkuara me ligj nga kryeinspektori, dhe mungesa e stafit të kualifikuar.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim 1: Kryeinspektori i IMT-vë Bashkia Librazhd, të marrë masa në të gjitha rastet në vijim, për nxjerrjen e vendimeve të gjobave për të gjitha rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje, ose në shkëlqje të lejes, të kryhet pezullimi i punimeve me aktin përkatës si dhe të nxirren vendimet për prishjen e tyre.

Rekomandim 2: IMT Bashkia Librazhd, të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, si dhe të përgatitet në mënyrë periodike çdo 3 muaj informacioni drejtuar IKMT.

Rekomandim 3: IMT Bashkia Librazhd, të hapë dosje individuale për secilën procedurë, duke shmangur praktikën e mbajtjes së dokumenteve nëpër blloqe, dhe të dokumentojë në çdo rast praktikën e kontrollit apo kundërvajtjes me foto të situatës së konstatuar.

Rekomandim 4: Kryeinspektori i IMT në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për hartimin e kërkesave drejtuar Gjykatës për kthimin e gjitha gjobave në titull ekzekutiv për të shmangur kalimin e afatit dhe parashkrimin e tyre.

Rekomandim 5: Kryetari i Bashkisë Librazhd, të synojë rekrutimin e stafit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit me personel të kualifikuar, mundësisht me inxhinierë, kjo për të mundësuar një kontroll sa më efektiv dhe cilësor të territorit për objektet që ndërtohen në zbatim të lejeve të ndërtimit dhe atyre pa lejet përkatëse.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Sh.G – Kryeinspektor i IMT, Bashkia Librazhd.

Pika 7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

- 7.2. ***Realizimi i programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.***
- 7.3. ***Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm***

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm në Bashkinë Librazhd, u konstatua si më poshtë vijon:

1. Shkresa përcjellëse nr. 512/8 Prot, datë 19.09.2022 e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës, protokolluar në zyrën e protokollit të Bashkisë Librazhd, me nr 4193 prot., date 21.09.2022.
2. Eshte hartuar plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve sipas shkresës nr. 4193/1 prot date 10.10.2022 (brenda afatit 20 ditë) për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit.
3. Shkresa kthim-përgjigje (brenda afatit 6-mujsh) së bashku me Raportin për zbatimin e rekomandimeve të lëna, nuk është dërguar në KLSH.

Nga auditimi u konstatua se:

1. Me shkresën nr.4193/1 prot, datë 10.10.2022 “Kthim përgjigje për zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të KLSH, Bashkia Librazhd ka respektuar afatin 20 ditor duke dërguar në KLSH, plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
2. Bashkia Librazhd nuk ka respektuar afatin prej 6-mujsh “Kthim përgjigje për zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të KLSH” në kundërshtim me ligjin 154/2014 datë

27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 30 “Rekomandimet e KLSH dhe ecuria e zbatimit”.

3. Nga KLSH janë lënë gjithsej **25** rekomandime, të grupuara në:

- **8** masa organizative;
- **3** masa shpërblim dëmi;
- **6** masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike në përputhje me parimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit të fondeve publike (të ardhura të munguara).
- **8** masa disiplinore;

Nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **8** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 2 janë zbatuar, 3 masë është në proces zbatimi dhe 3 nuk janë zbatuar.

Pra janë zbatuar **25%** e masave organizative **37%** janë në proces zbatimi dhe **37%** nuk janë zbatuar.

- Për shpërblimin e dëmit janë lënë **3** rekomandime për 3 subjekte në vlerën 1,204,469 lekë dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim në vlerën 976,500 lekë dhe pa zbatuar 2 rekomandime në vlerën 227,969 lekë.

- Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë 6 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht. nga të cilat, 3 janë zbatuar, 2 masë është në proces zbatimi dhe 1 nuk është zbatuar.
- Për masa disiplinore për punonjësit e institucionit janë lënë **8** rekomandime dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 6 janë zbatuar, dhe 2 nuk janë zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si vijon:

2.7.3. *Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2021, Njësia e Auditit të Brendshëm (*këtu e vijon NJAB*) ka funksionuar me *1 drejtues* dhe *1 punonjës*, kurse sipas strukturës organizative të përcaktuar nga Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 1033 datë 31.12.2020, NjAB është miratuar me *3-punonjës* nga këto *1- drejtues* dhe *2- punonjës*. Struktura me *3- punonjës* është nga viti 2016, në vitin 2018 (Korrik) është plotësuar me *2- punonjës* dhe vazhdon edhe në vazhdim.

Për periudhën 2021 realizimi i planit është në masën 66.6%. NjAB në hartimin e planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuara, por nuk ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve. Në të gjitha dosjet e auditimit mungojnë: projektdrafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit me të gjitha elementët e tij; Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim “*vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm*”, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të dhënë një opinion për funksionimin e kontroleve në çdo sistem e për të qenë më të qarta rekomandimet; Në disa raste formulimi i gjetjeve ka mangësi, pasi situata e përshkruar është i karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë hallka që nuk ka funksionuar dhe mosveprimet konkrete, në ndonjë rast nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kujt viti i referohet, si apo nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i detajuar i mospërputhshmërisë apo raportimit financiar për problematikën e konstatuar nga auditimi; Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirpërcaktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra “në zbatim të akteve ligjore”, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve,

të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem, në të gjitha rastet nuk është përcaktuar nivelin i rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët). Projektraporti i përcjellë subjektit të audituar nuk është shoqëruar me Formatin e sugjeruar të Plan-Veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Në disa raste nuk është në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar; Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera në fakt nga Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 mungojnë auditimet në sistemin e prokurimeve, në sistemin e pagesave sistemin e raportimit të pasqyrave financiare, në sistemin administrimin dhe menaxhimin e aseteve etj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, neni 12, shkronja “d”, neni 19 dhe neni 20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në MAB miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”, Kapitulli II 2.4.1 “Auditimi i përputhshmërisë” dhe 2.4.2 “Auditimi financiar”; Kapitulli III, pika 3.5; Kapitulli IV pika 4.1.1 “planifikimi i një angazhimi auditimi”, pikës 4.1.11 dhe 4.1.12; kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” pika 6.1 “Niveli i dokumentimit”.

1.1. Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Librazhd në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në zbatim të procedurave për rekrutimin e punonjësve, të marrin masa për plotësimin me 3 punonjës të Njesisë së AB, siç është miratuar dhe në strukturën organizative të bashkisë.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se:

Nga auditimit i Bashkisë Librazhd për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 struktura e Njesisë së AB vazhdon të jetë e plotësuar vetem me 2 punonjës.

Zbatimi:Rekomandimi 1.1 nuk është zbatuar.

1.2. Rekomandimi:

Njësia e Auditit të Brendshëm të kryejë një planifikim të auditimeve duke marrë në konsideratë frekuencën e kryerjes të auditimeve, të realizojë auditime në fusha me risk të lartë dhe të thelluara, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimit i Bashkisë Librazhd për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 struktura e Njesisë së AB nuk ka përcaktuar fushat më me risk në këtë institucion dhe nuk janë respektuar të gjitha proceset sipas Manualit të Auditit të Brendshëm.

Zbatimi: Rekomandimi 1.2 nuk është zbatuar

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se realizimi i buxhetit për vitin 2021 nga 1,400,833 mijë lekë të planifikuara është realizuar 1,220,553 mijë lekë ose në masën 87%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 602 “Shpenzime operative” në masën 74%, pra kemi planifikim me rezervë të tij dhe zërit 230-231 “Shpenzime për investime” në masën 72%, nga mos realizimi i projekteve në vlerë të plotë. Për vitin 2021, janë kryer ndryshime në rritje të planit fillestarë, në dy raste me VKB në vlerën 17,258 mijë lekë, gjë që tregon se në planin fillestarë këto fonde nuk janë marrë në konsideratë, të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përllogaritjes

së kostos së produkteve, në një mjet jo real, të qëndrueshëm dhe efektiv. Detyrimet e papaguara për vitin 2021 sipas bilancit janë në shumën 26,300,554 lekë ose në masën 1.9 % të shpenzimeve të planifikuara, të cilat kanë ardhur duke u ulur, krahasuar me vitin 2020, ku detyrimet ishin në shumën prej 55,842,835 lekë. Detyrimet e papaguara sipas bilancit të vitit 2021 nuk rakordojnë për shumën 8,700,647 lekë me raportimin në MFE, që i përket e detyrimeve të prapambetura për investime të pa financuara nga Ministritë e linjës dhe FZSHH, të cilat nuk janë përfshirë në raportim. Të ardhurat janë realizuar për vitin 2021 në masën 88%, ndërsa vlera e debitorëve të akumuluar ndër vite për taksa e tarifa vendore, paraqitet në nivele relativisht të larta, në shumën 97,568 mijë lekë. Referuar këtyre treguesve të të ardhurave të realizuara, konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2021 është bërë në masën më të madhe prej 90% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar dhe transferta e kushtëzuar e transferta specifike) dhe 10% nga të ardhurat e veta. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42, me Udhëzimin e MFE nr.09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3.

2.1. Rekomandimi:

Bashkia Librazhd gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit paraardhës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent,të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak,një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura,të hartojë një grafik duke zbatuar rradhën e pagesave.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar gjatë vitit 2022 gjatë fazës së planifikimit ka marrë në konsideratë faktorët për realizimin e buxhetit. Janë argumentuar shpenzimet buxhetore dhe është kryer planifikim mbi baza reale.

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 është zbatuar plotësisht.

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjendja kontabël (kosto historike) për vitin 2021 e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” është e analizuar për 337 objekte inventari në vlerën 3,737,881,027 lekë. Nga verifikimi i analitikëve të kësaj llogarie rezulton se nuk është zbritur vlera e ujësjellësve që sipas VKB duhej të transferohej tek Ujësjellës SHA Librazhd, për 33 ujësjellës në vlerën 452,014,176 lekë, me ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes,

paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

3.1. Rekomandimi:

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për transferimin e Aseteve që sipas VKB-së, të cilat i janë kaluar “Ujësjetës Kanalizime” sh.a me akte në dorëzim të firmosur nga të dy palët si dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur vlerën 452,014,176 lekë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërme rezulton se është zbatuar sipas VKB përkatëse nr.109 datë 28.12.2022, nr.23 datë 03.04.2023, nr. 120 datë 26.10.2018, nr.38 datë 22.01.2016 janë kryer veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave.

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 është zbatuar plotësisht.

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, nga 535 objekte inventari të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llog. 211 “*Pyje plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” dhe llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, në vlerën 4,689,952,520 lekë, Bashkia Librazhd për 19 objekte janë pajisur me titull pronësie, ndërsa për 12 objekte është në proces regjistrimi dhe për **504 objekte inventari, nuk posedon titull pronësie**, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 “*Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme*”, Kreu VI “*Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme*”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.

4.1. Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Librazhd të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për rregjistrimin në ASHK Drejtoria Elbasan dhe nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim paisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërme nga auditimit i periudhës 01.01.2022-31.12.2022 rezulton se, Bashkia Librazhd nuk ka kryer rregjistrimin e pronave në ASHK Drejtoria Elbasan.

Zbatimi: Rekomandimi 4.1 nuk është zbatuar

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjendja kontabël (kosto historike) e llogarisë 212 “*Ndërtesa konstruksione*” është e analizuar për 186 objekte (aktive) në vlerën 935,305,353 lekë, nga verifikimi i analitikëve të kësaj llogarie rezulton se për 24 objekte në vlerën 437,153,554 lekë, shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivitetit por janë trajtuar si aktive më vete. Trajtimi i tyre si aktive më vete ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre, që në fakt duhet të paraqiteshin më pak për 24 objekte dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në

kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

5.1. Rekomandimi:

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione”, të saktësojë vlerat e këtyre objekteve duke shtuar shpenzimet për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre për 24 raste në vlerën 437,153,554 lekë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm rezulton se nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar janë marrë masa për saktësimin e vlerës rekomandimi i mësipërm është në proces zbatimi.

Zbatimi: Rekomandimi 5.1 është në proces zbatimi.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjendja kontabël (kosto historike) e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” është e analizuar për 337 objekte (aktive) në vlerën 3,737,881,027 lekë, nga verifikimi i analitikëve të kësaj llogarie rezulton se për 31 objekte në vlerën 912,323,589 lekë, shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivitetit por janë trajtuar si aktive më vete. Trajtimi i tyre si aktive më vete ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre, që në fakt duhet të paraqiteshin më pak për 31 objekte dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

6.1. Rekomandimi:

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, të saktësojë vlerat e këtyre objekteve duke shtuar shpenzimet për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre për 31 raste në vlerën 912,323,589 lekë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm rezulton se nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar janë marrë masa për saktësimin e vlerës rekomandimi i mësipërm është në proces zbatimi

Zbatimi: Rekomandimi 6.1 është në proces zbatimi.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH rezulton se:

Nga Bashkia Librazhd është respektuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve (shkresa nr. 357/2, datë 11.2.2020).

Nuk është respektuar afati që brenda periudhën 6 mujore, Bashkia Librazhd duhet të informojë mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Librazhd, nuk është raportuar në këshillin e njësisë (Këshillin Bashkiak).

Është hartuar “Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve” në të cilën janë përcaktuar strukturat dhe personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

Gjithashtu rezultoi se:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar **7 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 7 masa dhe janë në proces zbatimi 2 masa.

b. Për masa mungesë të ardhurash janë rekomanduar 4 masa me vlerë **7,649,032 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat është zbatuar 1 (një) masë, janë në proces zbatimi 3 masa me vlerë 7,649,032, nga e cila likuiduar vlera 4,680,000 lekë dhe mbetur për likuidim vlera 7,459,032 lekë.

c. Për masa disiplinore, nuk janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j), ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm.

7.1. Rekomandim:

Kryetari i Bashkië Librazhd të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr.1115/6, datë 11.02.2021 “Për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Librazhd”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre respektivisht për:

-2 **masa** organizative, në proces zbatimi

-3 **masa** mungesë të ardhurash me vlerë 7,649,032 nga e cila likuiduar vlera 4,680,000 lekë dhe mbetur për likuidim vlera 7,459,032 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se:

Sipas programit të auditimit nr. 512/1 datë 27.05.2022 në Bashkinë Librazhd është kryer auditimi i zbatimit të rekomandimeve.

Në bazë të auditimit të zbatimit të rekomandimeve për vitin 2022 kemi këtë situatë.

Masa Mungesë të Ardhurash:

Rekomandim : Bashkia Librazhd, nëpërmjet Drejtorisë së Ardhurave Vendore të marrë masa, që për 6 subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisjen me autorizime për liçenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, duke mbetur debitorë në vlerën 5,400,000 lekë, të kryhen veprimet e arkëtimit përkatësisht nga: “S. G.” shpk në vlerën 900,000 lekë, “M.O.” shpk në vlerën 900,000 lekë, “H.” shpk në vlerën 900,000 lekë, “K” shpk në vlerën 900,000 lekë, “S.G” shpk në vlerën 900,000 lekë, “D,M” shpk në vlerën 900,000 lekë, Në rastet, kur këto subjekte nuk paraqiten për arkëtimin e plotë të tarifës së liçencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Verifikim 2022:Për zbatimin e këtij rekomandimi Drejtoria e të ardhurave vendore ka marrë masat për 6-gjashtë subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisjen me autorizime për liçensapër tregtim me pakicë të karburanteve të subjekteve të cilësuar në Raportin e KLSH-së. Këto subjekte janë njoftuar me shkresë nr. 6497 prot datë 10.12.2021, “Njoftim për pagesë” faturë për arkëtim prej 900,000 lekë. Mbasnjoftimit për pagesë Drejtoria e të Ardhurave vendore ka dërguar Njoftim vlerësimi me nr. 587 prot datë 7.02.2022 për shumën prej 5,400,000 lekë, ku nga subjektet e cilësuar në raportin e KLSH-së kanë arkëtuar 4,600,000

mijë lekë, duke mbetur për arkëtim vlera 800 mijë lekë, konkretisht: subjekti SMG. për shumën 400 mijë lekë; S. G për shumën 400 mijë lekë.

Verifikim 2023: Lidhur me rekomandimin e mësipërm rezulton se subjektet debitorë kanë shlyer detyrimet ndaj Bashkisë Librazhd sipas faturave të arkëtuara, "S. G", dt 10.01.2023 shuma 400,000 lekë dhe "S.G" dt 11.01.2023 shuma 400,00 lekë.

Zbatimi: Rekomandimi është zbatuar plotësisht

Rekomandim : Bashkia Librazhd nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Librazhd, që të mos pajisë me çertifikata legalizimi dhe hipotekore subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit, pa kryer pranë Bashkisë Librazhd pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet, që përfitojnë nga legalizimi. Drejtoria e të Ardhurave Vendore të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese, bazuar në legjislacionin tatimor deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e paraqitur si debitorë në vlerën 7,379,032 lekë

Verifikim 2022: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Librazhd për zbatimin e këtij rekomandimi ka dërguar shkresë nr. 3541 prot datë 28.06.2021 "Kërkesë për vendosje barrë hipotekore të pasurisë së paluajtshme", shkresë nr. 182 port datë 12.01.2022 "kërkesë për bashkëpunim". Drejtoria e të Ardhurave Vendore po ndjek të gjitha procedurat ligjore dhe nënligjore për vjeljen e shumës prej 7,379,032 lekë të ndikimit në infrastrukturë, zbatimi i këtij rekomandimi është në proces zbatimi.

Verifikim 2023: Lidhur me rekomandimin e mësipërm rezulton se gjatë vitit 2022,2023 janë kryer pagesa për taksën e ndikimit në infrastrukturë në shumën 129,472 lekë.

Zbatimi: Rekomandimi është në proces zbatimi

Rekomandim : Bashkia Librazhd nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtorisë Juridike, Inspektoriati Vendor të Mbrojtjes së Territorit dhe Policisë Bashkiake, të marrë masa në radhë të parë për kontabilizimin e gjobave të aplikuara për ndërtime pa leje dhe shkeljet e ndryshme të kryera nga subjektet private dhe në radhë të dytë të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 270,000 lekë.

Verifikim 2022: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në koordinim me IMT Bashkia Librazhd dhe Policisë Bashkiake ka azhornuar gjobat, kontabilizimi dhe vjelja e tyre është në proces. Për gjobën prej 30,000 lekë është bërë ankimim në gjykatë dhe është rrëzuar gjykata. Gjopa prej 450.000 lekë, nuk është 450.000 lekë sa cilësuar në Raportin Përfundimtar të KLSH-së por është 50,000 lekë dhe kjo shumë është arkëtuar. Në total nga vlera e gjobave prej 270,000 lekë është arkëtuar vlera 80,000 lekë, duke mbetur për likuidim vlera 190,000 lekë.

Verifikim 2023:

Lidhur me rekomandimin e mësipërm rezulton se gjatë vitit 2022,2023 janë kryer pagesa nga debitorët për gjobat e vendosura nga IMT në shumën 100,00 lekë.

Zbatimi: Rekomandimi është në proces zbatimi

Masa Organizative:

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Librazhd të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin të aktiveve në llog. 211 "Pyje, Plantacione" dhe nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të kryejë zbatimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në Pasqyrat Financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik në mbyllje të vitit ushtrimor 2021.

Verifikim 2022: Për zbatimin e rekomandimit 5.1 të cilësuar në Raportin e KLSH-së është ngritur grup pune por zbatimi i këtij rekomandimi por që akoma nuk është përfunduar, pasi është në proces zbatimi dhe brenda vitit. Do të bëhen sistemime të nevojshme kjo në bazë të inventarizimit që do të bëhet.

Verifikim 2023: Situata për rekomandimin e mësipërm është po e njëjtë me vitin 2022 është në proces zbatimi.

Zbatimi: Rekomandimi është në proces zbatimi

Rekomandim: Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre e ekzistencës fizike.

Verifikim 2022: Drejtoresha e Kadastrës dhe Planifikimit të Territorit dhe punonjësit e Sektorit të aseteve, ka marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi dhe brenda vitit ky rekomandimi cilësuar në Raportin e KLSH-së do të gjej zbatim (është në proces zbatimi)

Verifikim 2023: Situata për rekomandimin e mësipërm është po e njëjtë me vitin 2022 është në proces zbatimi.

Zbatimi: Rekomandimi është në proces zbatimi

7.2. Rekomandim:

Kryetari i Bashkisë Librazhd të marrë masa të menjëhershme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi e KLSH.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm rezulton se Bashkia Librazhd nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve .

Zbatimi: Rekomandimi 7.2 nuk është zbatuar

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, date 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21- 33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nga **Titullari i njesisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe

procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,204,469 lekë pa TVSh**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rikonstruksioni i kanalit vaditës të Mesit, Gizavesh, Dorëz”*, Bashkia Librazhd, me vlerë të kontratës 59,995,025 lekë me tvsh, fituar nga bashkimi i OE “K” SHPK & “L” SHPK & “K.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 976,500 lekë pa tvsh, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4619 prot datë 20.10.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe bashkimit i OE “K” SHPK & “L” SHPK & “K.”.

1.1. Rekomandimi:

Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **976,500 lekë pa tvsh** nga bashkimi I OE “K” SHPK & “L” & “K.” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.469 prot datë 20.10.2020, me objekt *“Rikonstruksioni i kanalit vaditës të Mesit, Gizavesh, Dorëz”*, Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore sipasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2022

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 1.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezulton se ky rekomandim është pranuar dhe është njoftuar subjekti me shkresën nr. 4586 prot., datë 13.10.2022 për ekzekutimin vullnetar të detyrimit të krijuar ndaj Bashkisë Librazhd.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 është zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Ndërtim miniparku i qytetit pranë Argjinaturës së Lumit Shkumbin (Faza II dhe faza III)”*, Bashkia Librazhd, me vlerë të kontratës 16,470,664 lekë me tvsh, fituar nga bashkimi i OE “M” SHPK & “Sh” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 126,560 lekë pa tvsh, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2106 prot datë 08.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe bashkimi të OE “M” SHPK & “Sh” SHPK.

2.1.Rekomandimi:

Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **126,560 lekë pa tvsh** nga bashkimi I OE “M” SHPK & “Sh” SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.2106 prot datë 08.04.2021, me objekt *“Ndertim miniparku i qytetit pranë Argjinaturës së Lumit Shkumbin”(Faza II dhe faza III)*, Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2022

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 2.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezulton se ky rekomandim është pranuar nga Bashkia nuk është marrë asnjë masë për shlyerjen e këtij detyrimi nga operatori.

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 nuk është zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me llogaritjen dhe pagesën Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë të ndërtimeve të reja për periudhën

objekt auditimi, rezulton se në një rast kjo taksë për Vendimin nr. 452, datë 19.05.2021 me zhvillues H.N, për objektin “Rikonstrukcion Objekt ekzistues me 1 kat +papafingo” me sipërfaqe 266.4 m² është llogaritur më pak për vlerën **101,409 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Librazhd, në kundërshtim me pikën 1 e nenit 17 të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” me ndryshimet.

3.1 Rekomandim:

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **101,409 lekë**, si rezultat i keq llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Brenda datës 31.12.2022

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 3.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezulton se ky rekomandim është pranuar nga Bashkia nuk është marrë asnjë masë për shlyerjen e këtij detyrimi nga operatori.

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 nuk është zbatuar

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIENCË, DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore (2011-2021) në vlerën gjithsej 85,373,491 lekë, janë debitorë 524 subjektet e biznesit të vogël e biznesit të madh në vlerën 47,213,808 lekë, 5792 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 38,159,683 lekë. Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimin të detyrimeve në zbatim të kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime.

Edhe pse vazhdojnë procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 524 subjekte debitorë në vlerën 49,815 mijë lekë, janë aktiv 383 subjekte ose 73 % e totalit të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa, në vlerën 39,612 mijë lekë ose 79 % e vlerës së debitorëve. Ndaj këtyre subjekteve për asnjë rast nuk është zbatuar pika 2 e nenit 89, e ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, nuk është kërkuar kallëzim penal ndaj subjekteve problematike debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

1.Rekomandimi:

Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën **85,373,491 lekë**.

Brenda dates 31.12.2022

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk ka marrë masa për uljen e detyrimeve të debitorëve. Nga auditimi i periudhës 01.01.2022-31.12.2022 kemi rritje të debitorëve.

Zbatimi: Rekomandimi 1 nuk është zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Elbasan janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK. Konkretisht për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2021, nga grupi i auditimit sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezultojnë nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **263 persona** me vlerë **9,593,857 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Librazhd, sipas aneks nr. 2/1, rezultojnë se nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkisë Librazhd, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3.

2.1. Rekomandimi:

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **9,593,857 lekë** ndaj **263 personave**, si rezultat i mos arkëtimin të vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje (ish-ALUIZMI).

Brenda datës 31.12.2022

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin nga auditimi i kryer rezultojnë se janë kryer pagesa nga debitorët në vlerën 748,599 lekë diferenca e mbetur është në vlerën 8,845,258 lekë

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 është në proces zbatimi.

2.2.Rekomandim:

Kryetari i Bashkisë Librazhd nëpërmjet bashkëpunimit institucional t'i kërkojë ASHK-së që të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Brenda datës 31.12.2022

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm, Bashkia Librazhd ka pasur bashkëpunim me ASHK për vendosjen e bllokimeve në kartelat e pronës.

Zbatimi: Rekomandimi 2.2 është zbatuar plotësisht.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se nga Drejtoria e Pyjeve, janë lidhur 53 kontrata për dhënie me qira, për shfrytëzim të fondit pyjorë, për sipërfaqen 81.525 ha dhe për 87.496 km, për vlerën vjetore 12,235,694 lekë, në zbatim të tarifave VKM nr. 1064, datë 07.01.2013 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave, për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave.

Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga qiraja për shfrytëzim të fondit pyjor, për periudhën objekt auditimi, u konstatua se 8 subjekte nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës edhe pse Drejtoria e të Ardhurave, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar neni 12, germën “g”, dhe kushtet e kontratave të lidhura, subjektet që nuk kanë likuiduar detyrimet e kontratave me listë janë dërguar Drejtorisë së Financës për kontabilizim dhe janë debitorë në vlerën **2,600,718 lekë** që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Librazhd, sipas tabela aneks nr. 2/4, bashkëlidhur.

3.1 Rekomandim:

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore të marrin masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga subjektet të vlerës 2,600,718 lekë, duke njoftuar subjektet për detyrimin që kanë ndaj bashkisë.

Brenda datës 31.12.2022

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me Rekomandimin 3.1 nga auditimit i kryer rezulton se janë kryer pagesa nga debitorët në vlerën 2,491,718 lekë diferenca e mbetur është në vlerën 109,000 lekë.

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 është në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Në përfundim të punës audituese në terren dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit mbi gjetjet e konstatuara nga grupi i KLSH, kanë rezultuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, shkelje të cilat kanë konsistuar në:

a. Në 9 procedura prokurimi, kriteret nuk janë në përputhje me dispozitat e LPP dhe llojin e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar mospjesëmarrjen e OE në procedurë.

b. Në 4 procedura prokurimi, OE/BOE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi ka kriteret të cilat nuk janë plotësuar dhe nga KVO janë vlerësuar si të rregullt. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurën tjetër me kushte me të favorshme, kjo me qëllim përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondit të prokuruar në vlerën **102,226 mijë lekë**. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim më ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “**Për prokurimin publik**”, neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”.

4.1. Rekomandim:

Kryetari i Bashkisë Librazhd, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurave), për hartimin e specifikimeve teknike dhe

kritereve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE.

Menjëherë dhe vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 4.1. nga auditimi i procedurave të prokurimit për vitin 2022 rezulton se grupet e punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve janë ngitur me ekspertë të fushës në përbërje

Zbatimi: Rekomandimi 4.1 është zbatuar plotësisht

4.2. Rekomandim:

Kryetari I Bashkisë Librazhd, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik në kushtet e mosplotësisht të të gjitha kritereve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur përdorimin pa efektivitet të fondeve me vlerë 102,226 mijë lekë.

Menjëherë dhe vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 4.2 nga auditimi i procedurave të prokurimit për vitin 2022 rezulton se përgjithësisht janë plotësuar kriteret e vendosura në DST nga operatorët fitues.

Zbatimi: Rekomandimi 4.2. është zbatuar plotësisht

C. MASA DISIPLINORE:

C/I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin Civil:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, gjerat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar për kontratën individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Librazhd, që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për 3 (tre) punonjës, si më poshtë:

1.S.O, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

2.S.K, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Juridik i Prokurimeve.

3.D.T, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të IT.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me 156 kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 3, “Parimet e përzgjedhjeve”, nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, neni 83, “*Njoftimi i fituesit*”.

Nga verifikimi rezultoi se: Me urdhër nr.1066 datë 30.12.2022 të titullarit të Bashkisë Librazhd është dhenë masë disiplinore “Vërejtje” për punonjësën zj.S.O.

Me urdhër nr.1062 datë 30.12.2022 të titullarit të Bashkisë Librazhd është dhenë masë disiplinore “Vërejtje” për punonjësën zj.S. K.

Me urdhër nr.1065 datë 30.12.2022 të titullarit të Bashkisë Librazhd është dhenë masë disiplinore “Vërejtje” për punonjësën z.D.T.

Zbatimi: Rekomandimi C/I është zbatuar plotësisht

C/II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me kontratë pune:

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar për kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjës në lidhje me këto shkelje, ”, **i rekomandohet Kryetarit të Bashkisë Librazhd** që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “*Vërejtje*” deri në “*Largim nga puna*”, për **6 (gjashtë)** punonjës, si më poshtë:

1.M.G me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Transportit, Tregut, Parkingjeve.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*”, neni 3, “*Parimet e përzgjedhjeve*”, nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 “*Autoriteti ose enti kontraktor*”, neni 98, “*Anulimi i një procedure*”, neni 76, “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, neni 92, “*Shqyrtimi i ofertave*”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 82, “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, neni 83, “*Njoftimi i fituesit*”.

2.B.B me detyrë Drejtoresh e Drejtorisë së Planifikimit e Zhvillimit të Territorit,

3.S. A me detyrë Juriste në Sektorin e Prokurimeve,

4.J.B me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Planifikimit e Zhvillimit të Territorit,

5.E.P me detyrë N/ Kryetare e Bashkisë.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimin të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullari i AK për zhvillimin e një procedure tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*”, neni 3, “*Parimet e përzgjedhjeve*”, nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 “*Autoriteti ose enti kontraktor*”, neni 98, “*Anulimi i një procedure*”, neni 76, “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, neni 92, “*Shqyrtimi i*

ofertave”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i 157 ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”.

Nga verifikimi rezultoi se: Me urdhër nr.1064 datë 30.12.2022 të titullarit të Bashkisë Librazhd është dhënë masë disiplinore “Vërejtje”për punonjësen zj.B.B.

Me urdhër nr.1066 datë 30.12.2022 të titullarit të Bashkisë Librazhd është dhënë masë disiplinore “Vërejtje” për punonjësin z.M.G.

Me urdhër nr.1067 datë 30.12.2022 të titullarit të Bashkisë Librazhd është dhënë masë disiplinore “Vërejtje”për punonjësen zj.E.P.

Për punonjëset zj.S.A. dhe zj.J.B nuk është dhënë masë disiplinore sipas rekomandimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Zbatimi: Rekomandimi C/II është në zbatuar pjesërisht

Titulli i gjetjes: Bashkia Librazhd nuk ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Situata: Në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, neni 15, “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronjat “a” dhe “b”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pazbatuara.

Bashkia Librazhd ka detyrimin për zbatimin e tyre si më poshtë vijon:

a. Janë lënë 8 Rekomandime për “Masa Organizative”, të cilat janë pranuar nga subjekti, për të cilat rikërkohet zbatimi për 3 masa nuk janë zbatuar;

b. Janë lënë 3 Rekomandime në vlerën totale 1,204,469 lekë për “Masa për shpërblim dëmi”, të cilat janë pranuar nga subjekti dhe mbeten për t’u zbatuar, pasi deri tani është zbatuar pjesërisht 1 masë në vlerën 227,969 lekë dhe janë pa zbatua 2 masa, në vlerën 976,500 lekë.

c. Janë lënë 6 Rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike në përputhje me parimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit të fondeve publike (të ardhura të munguara).për të cilat rikërkohet zbatimi për 1 masë të pazbatuar .

ç. Janë lënë 8 Rekomandime masa disiplinore të cilat janë pranuar nga subjekti, për të cilat rikërkohet zbatimi për 2 masa të pa zbatuar.

Trajtuar gjerësisht në Akt Verifikimin nr. 1, datë 26.05.2023

Kriteri: Ligji nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma j; Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Ndikimi/Efekt: Moszbatimi i Rekomandimeve, ndikon në uljen e efektivitetit të shërbimeve institucionale dhe pengon për përmirësimin e tyre në dobi të komunitetit, në mospërdorimin me eficientë të fondeve të saj si dhe në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Librazhd.

Shkaku: Mosndjekja e gjitha procedurave nga ana e njëjësive përgjegjëse të Bashkisë Librazhd, për të mundësuar zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Librazhd të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 4193 Prot, datë 10.10.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e masave të pa zbatuara dhe ato pjesërisht të zbatuara gjithashtu të përshpejtojë zbatimin e masave në proces si më poshtë:

Nga sa më sipër, KLSH rikërkon që Bashkia Librazhd të përshpejtojë masat për zbatimin e të gjitha rekomandimeve të cilat në këtë raport auditimi janë cilësuar se janë në proces zbatimi (përshkruar më lart).

Gjithashtu KLSH rikërkon nga Bashkia Librazhd, marrjen e masave për zbatimin e të gjitha rekomandimeve të cilat në këtë raport auditimi janë cilësuar se janë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si më poshtë vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

(Në vijim janë 3 rekomandime të pa zbatuara nga Bashkia Librazhd, të cilat rikërkohen për zbatim)

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Librazhd në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në zbatim të procedurave për rekrutimin e punonjësve, të marrin masa për plotësimin me 3 punonjës të Njesisë së AB, siç është miratuar dhe në strukturën organizative të bashkisë.

Në vijimësi

Zbatimi:Rekomandimi 1.1 nuk është zbatuar

1.2. Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm të kryejë një planifikim të auditimeve duke marrë në konsideratë frekuencën e kryerjes të auditimeve, të realizojë auditime në fusha me risk të lartë dhe të thelluara, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Në vijimësi

Zbatimi: Rekomandimi 1.2 nuk është zbatuar

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Librazhd të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për rregjistrimin në ASHK Drejtoria Elbasan dhe nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim paisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Librazhd të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj,të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për rregjistrimin në ASHK Drejtoria Elbasan dhe nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi,buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim paisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatimi: Rekomandimi 4.1 nuk është zbatuar

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

(Në vijim janë 3 rekomandime, prej të cilave 2 të pa zbatuara dhe 1 i zbatuar pjesërisht nga Bashkia Librazhd, të cilët kërkohen për zbatim)

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbeshtetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, date 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21- 33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nga **Titullari i njesisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,204,469 lekë pa TVSh**, si më poshtë:

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **976,500 lekë pa tvsh** nga bashkimi I OE “K” SHPK & “L” & “K.” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.469 prot datë 20.10.2020, me objekt “Rikonstruksioni i kanalit vaditës të Mesit, Gizavesh, Dorëz”, Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 është zbatuar pjesërisht

2.1. Rekomandimi:Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **126,560 lekë pa tvsh** nga bashkimi i OE “M” SHPK & “Sh” SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.2106 prot datë 08.04.2021, me objekt “Ndertim miniparku i qytetit pranë Argjinaturës së Lumit Shkumbin”(Faza II dhe faza III), Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore,si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 nuk është zbatuar

3.1 Rekomandim:Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **101,409** lekë, si rezultat i keq llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 nuk është zbatuar

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIENCË, DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

(Në vijim është 1 rekomandim i pa zbatuar nga Bashkia Librazhd, i cili rikërkohen për zbatim):

1.Rekomandimi:Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën **85,373,491 lekë.**

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 nuk është zbatuar

C. MASA DISIPLINORE

(Në vijim janë 2 masa disiplinore të pa zbatuara nga Bashkia Librazhd, të cilat rikërkohen për zbatim)

C/II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me kontratë pune:

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar për kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjës në lidhje me këto shkelje, ”, **i rekomandohet Kryetarit të Bashkisë Librazhd** që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga puna**”, për:

1.S.A me detyrë Juriste në Sektorin e Prokurimeve,

2.J.B me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Planifikimit e Zhvillimit të Territorit,

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullari i AK për zhvillimin e një procedure tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i 157 ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Librazhd nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim. Sektori i burimeve njerëzore nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurma e auditimit dhe rregullorja për parandalimin e konflikteve të interesit. Nuk është hartuar rregjistër i rrishtit, duke mos marrë masa për evidentimin e rrishtit që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre.

Nuk është hartuar Kodi i Etikës, duke mos pasur një dokument i cili të njihet dhe zbatohet nga institucioni lidhur me etikën e punonjësve në punë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim nënin 16, 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualin e MFK, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, Udhëzimi nr. 16, datë 20.07,2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të rrishtit në njësitë publike”, ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1/1 germa (b), VKM nr. 306 datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 8-18 të raportit përfundimtar të auditimit).

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Librazhd, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve të marrin masa për hartimin e regjistrit të rrishtit të secilës strukturë dhe të gjithë institucionit. Të hartohet gjurma e auditimit për veprimtaritë kryesore të institucionit, kodi etikës rregullorja për parandalimin e konflikteve të interesit.

Struktura e Burimeve Njerëzore, të evidentojnë nevojat e stafit për trajnime dhe të hartojë dhe zhvillojë programe trajnimi për ruajtjen dhe ngritjen profesionale të tij.

Deri më 31.10.2023

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit i Njësisë së Auditit të Brendshëm u konstatuan se kjo strukturë nuk është e plotësuar me numrin e plotë, pasi ka dy punonjës, nga tre punonjës që kërkon kuadri ligjor në fuqi.

Plani Strategjik për periudhën 2023-2025, si dhe raporti vjetor i veprimtarisë audituese për vitin 2022 nuk janë përgatitur dhe dërguar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”.

Nuk është kryer vlerësimi i rrishtit sipas fushave të aktivitetit në Bashkinë Librazhd, për nevojën e planifikimit të auditimeve dhe nuk janë kryer auditime për zbatimin e rekomandimeve të lënë më parë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 8-18 të raportit përfundimtar të auditimit).

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1. Rekomandim: -Kryetari i Bashkisë Librazhd dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrin masa për plotësimin me tre punonjës të Njësisë së Auditit të Brendshëm.

-Njësia e Auditit të Brendshëm të planifikojë auditime tematike për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna më parë, si dhe të dërgojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave raportin vjetor të veprimitarisë audituese dhe planin strategjik.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të zërave të shpenzimeve të buxhetit për vitin 2022 u konstatuan diferenca midis vlerës së planifikuar dhe asaj të realizuar. Zërat e shpenzimeve buxhetore janë realizuar në vlerën 1,163,563 mijë lekë nga 1,399,989 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 83%.

Peshën kryesore specifike në këtë mosrealizim e ka zëri 230-231 “Shpenzime për investime”, i cili është realizuar në masën 50%, i cili ka ardhur nga mos realizimi dhe finalizimi me kontratë të 11 projekteve të planifikuara, si dhe nga mos prokurimi i fondeve për 16 projekteve të tjera të planifikuara. Këto investime kanë kaluar për realizim dhe financim me fonde të trashëguara në vitin 2023, me përjashtim të katër projekteve jo prioritare dhe kalimi i fondeve të tyre për financimin e një investimi në rrugë rurale.

Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën 9,977,393 lekë ose në masën 0.15 % të shpenzimeve të planifikuara, të cilat janë ulur krahasuar me fund vitin 2021, që ishin në shumë të konsiderueshme prej 19,778,698 lekë, por konstatohen se janë krijuar detyrime të reja gjatë vitit 2022, në vlerën 1,143,282 lekë. Gjithashtu konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën më të madhe prej 81.5% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar dhe transferta e kushtëzuar e transferta specifike) dhe 18.5% nga të ardhurat e veta. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 43, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40/h,42; me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1-2.5, faqe 19-31 të raportit përfundimtar të auditimit).*

3.1. Rekomandim: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues, të marrin masa që gjatë hartimit dhe zbatimit të buxhetit për zërat e shpenzimeve, realizimi i shpenzimeve buxhetore të bëhet në përputhje me planifikimin e hartuar. Për kontratat e investimeve publike, të realizohet zhvillimi i procedurës, lidhja e kontratave dhe zbatimi i tyre në kohë, duke eliminuar vonesat të cilat sjellin mos realizimin e fondeve publike të planifikuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2. Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrin masa për mos krijim të detyrimeve të reja të prapambetura, si dhe të hartojnë grafik për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, duke respektuar radhën e pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,662,464 lekë, por për këtë llogari nuk ka analizë të detajuar se cilat janë aktivet që përfaqëson kjo llogari. Mungesa e analizës për vlerën 4,662,464 lekë ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 47-62 të raportit përfundimtar të auditimit).*

4.1. Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar Kryetari i Bashkisë Librazhd të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 211 “Pyje, Plantacione”. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nëpërmjetë dokumentacionit të financiar të trashëguar, të nxjerrë të dhënat e nevojshme për aktivet e hyra e veprimet me to për llogarinë 211 “Pyje, Plantacione” në vite, për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerën e paraqitur në PF për këtë llogari.

Brenda datës 31.12.2023

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën zero lekë, kur në fakt nga testimi i kryer për kontratat e investimeve rezulton se ka kontrata në proces.

Nga auditimi i kontabilizimeve të veprimeve ekonomike për kontratat e investimeve me shtrirje kohore likuidimi përtej vitit ushtrimor rezulton se llogaria 231 “Shpenzime për investime në proces” është debituar dhe kredituar për vlera pjesore të paguara, duke e mbyllur këtë llogari në mënyrë të gabuar pa u kapitalizuar aktivi deri në vlerë të plotë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën zero lekë, kur ka investime në proces, kështu në fund të vitit 2022 konstatohet se nga 14 kontrata projektsh kanë mbetur pa u mbyllur për vlerën prej 6,221,225 lekë, vlerë e cila duhet ti përkiste gjendjes debitorë llog. 231 “Shpenzime për investime në proces”, me datë 31.12.2022. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 2 Klasa 2 si dhe kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 47-62 të raportit përfundimtar të auditimit).

5.1. Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Librazhd pagesat e vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në përfundimin e investimit dhe, pas realizimit të punimeve ti kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivitetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 47-62 të raportit përfundimtar të auditimit).

Brenda datës 31.12.2023

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 26 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022 – 30.04.2023 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 21 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator, si mos argumentim i kriterit, mos lidhje e ngushtë e kriterit me natyrën dhe vlerën e kontratës, etj., veprime jo në përputhje me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 2, 39, 40, 82 si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar neni 26, 39, 40. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1-4.3, faqe 62-108 të raportit përfundimtar të auditimit)

6.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Librazhd, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publike, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 26 procedurave të prokurimit publik të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022 – 30.04.2023, në 18 raste kualifikim i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pavarësisht se në përgjithësi është kualifikuar dhe lidhur kontratë me ofertën ekonomikisht më të favorshme, pra me vlerë më të ulët. Kualifikimi në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta, është në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2023, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2 “Qëllimi”, neni 3 “Parimet të përgjithshme” dhe neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1-4.3, faqe 62-108 të raportit përfundimtar të auditimit)

7.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Librazhd, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të kualifikimit të operatorëve ekonomik, në kushtet e mos plotësimit të kriterëve, edhe në rastet e ofertave me vlerën më të ulët.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në auditimin për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, në tre raste personat përgjegjës që administrojnë procesin në sistemin *e-leje*, i kanë miratuar pa plotësuar dokumentacionin e rregullt sektorial për ndërtimin, pasi janë evidentuar mangësi që lidhen me policat e sigurimit për projektuesit, pasi në mënyrë të përhapur ato janë jashtë afateve të vlefshmërisë dhe nuk mbulojnë përgjegjësinë profesionale të projektuesve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” neni 15 pika 1, germa (g). ((*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 113-115 të raportit përfundimtar të auditimit*))

8.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit, të jap miratim vetëm për lejet e ndërtimit të cilat kanë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor. Gjithashtu të vlerësohet si dokumentacion i rëndësishëm edhe policat e sigurimit për projektuesit.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, për periudhën objekt auditimi ka funksionuar me punonjës të cilët nuk plotësojnë kriteret lidhur me formimin arsimor.

Nga auditimi i veprimtarisë së kësaj strukture u konstatua se në 3 raste nuk është aplikuar masa administrative dënim me gjobë për subjektet kundërvajtësi, si dhe nuk janë nxjerrë aktet e pezullimit. Në 4 raste mungojnë vendimet e prishjes për ndërtimet pa leje. Nuk disponohet asnjë akt kontrolli për objektet e ndërtuara me leje ndërtimi dhe mungon korrespondenca me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Kryeinspektori nuk ka miratuar plane mujore dhe vjetore të punës, nuk administrohen dosje për praktikantët e ndjekura nga IMT, si dhe nuk dokumentohen me foto praktikantët e mbajtura. Lidhur me gjobat e vendosura nga IMT për vitin 2022, rezulton se asnjëra prej tyre nuk është arkëtuar dhe njëkohësisht nuk është bërë asnjë kërkesë në gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv. Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me Ligjin 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 5 germa (a, b, ç, d, f), neni 11; Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 51 “Inspektimi”; neni 41 “Të drejta të tjera të inspektorit”, germa (a) të ligjit me nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; pika 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; pika 2 e nenit 106 të Rregullores së Bashkisë Librazhd, miratuar me vendimin nr. 5311, datë 06.12.2019 të Titullarit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 115-118 të raportit përfundimtar të auditimit*).

9.1. Rekomandim: Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Librazhd, të marrë masa që për të gjitha rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje, ose në shkelje të saj, përveç nxjerrjes së vendimeve të gjobave, të vijohet me veprimet e mëtejshme për pezullimin e punimeve, vendimin për prishjen e tyre, deri në kallëzim penal, sipas përcaktimeve ligjore për secilin rast.

9.2. Rekomandim: IMT të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse, me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, si dhe të përgatitet në mënyrë periodike çdo 3 muaj informacioni drejtuar IKMT.

9.3. Rekomandim: IMT Bashkia Librazhd, të hapë dosje individuale për secilën procedurë, duke shmangur praktikën e mbajtjes së dokumenteve në blloqe, si dhe të dokumentojë në çdo rast praktikën e kontrollit apo kundërvajtjes me foto të situatës së konstatuar.

9.4. Rekomandim: Kryeinspektori i IMT në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për hartimin e kërkesave drejtuar Gjykatës për kthimin e gjitha gjobave në titull ekzekutiv, për të shmangur kalimin e afatit dhe parashkrimin e tyre.

9.5. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Librazhd, të marrë masa që struktura e IMT të përbëhet nga punonjës të cilët plotësojnë kriteret e formimit arsimor, sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i librit të masave sipas kontratës “Ndërtim i ujësjellësit të Fshatit Polis Gostimë, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd”, për zërin gjermim traseje në rrugë, nuk është përcaktuar thellësia e gjermimit, por vetëm gjerësia në fillim dhe fund të piketës dhe gjatësia ndërmjet piketave. Nga auditimi i dosjes teknike, u konstatua se nuk është paraqitur dokumentacioni i vizatimeve të azhurnimit të linjave. Mangësia në dokumentacion, krijon vështirësi në identifikimin e volumit të punimeve të realizuara në fakt. Nga verifikimi i punimeve në objekt rezulton se tek mbikalimi i përroit, në një distancë 50 m, nuk janë përfunduar punimet për mbulimin e tubacionit të çelikut. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2015 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 9. b. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4, faqe 108-113 të raportit përfundimtar të auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Bashkia Librazhd të kërkojë nga mbikëqyrësit e punimeve plotësimin e dosjes teknike për objektet në zbatim, hap pas hapi dhe konformë kërkesave ligjore.

Në vijimësi

10.2. Rekomandimi: Bashkia Librazhd, në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të kërkojnë mbulimin e tubacionit tek mbikalimi i përroit, para përfundimit të periudhës së riparimit të defekteve.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Bashkia Librazhd ka në përgjegjësinë e saj administrative rreth 4379 (katërmijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) pasuri të paluajtshme publike, në pronësi dhe në përdorim, nga të cilat janë të regjistruara në ASHK vetëm 112 (njëqind e dymbëdhjetë) prej tyre, ndërsa të paregjistruara vazhdojnë të mbeten 4267 (katërmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) pasuri. Bashkia Librazhd nuk ka marrë masa të plota për regjistrimin e të gjitha pronave dhe pasqyrimin e tyre në inventarin e pasurive dhe në kontabilitet, nuk ka ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, dokumentacioni i cili është i nevojshëm për të realizuar regjistrimin e tyre; nuk ka kryer rakordim me ASHK Librazhd për asetet e ish komunave, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e këtyre objekteve; nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuara dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer detyrimin e trojeve në funksion të ndërtesës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, kreu IV i tij, përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike, shtetërore (nenet 35 - 41)”, UMF-së Nr.30, Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30; ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.20, Datë 28.12.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë Librazhd”, neni 50. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 31-47 të raportit përfundimtar të auditimit*).

11.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë masat që me specialistë të fushës të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, si dhe për krijimin e regjistrit të aseteve.

Deri më 30.11.2023

11.2. Rekomandim: Sektori i Menaxhimit të Aseteve si dhe Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, të marrë masa dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin duhur për regjistrim në

ASHK të aseteve. Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Deri më 30.11.2023

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se për vitin 2022 Sektori i Menaxhimit të Aseteve si dhe Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit në Bashki ka regjistruar në ASHK Librazhd në total 112 prona (sipas aneksit nr. 3/9, pika 3, bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit). Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për pronat e certifikuara Bashkia Librazhd nuk ka kryer procesin e vlerësimit, çka e vështirëson procesin e kontabilizimit. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16); VKB Nr.20, Datë 28.12.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë Librazhd”, neni 50 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 31-47 të raportit përfundimtar të auditimit*).

12.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës të ndërmar të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin 112 pronave të regjistruara në ASHK Librazhd pa vlerë, si dhe pas procesit të vlerësimit të bëjë paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në pasqyrat financiare të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Bashkia Librazhd nëpërmjet procedurës së ankandit, për periudhën janar-dhjetor 2022 ka lidhur 15 (pesëmbëdhjetë) kontrata për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor me afat 10-vjeçar, për periudhën 2022-2032, me objekt të ndryshëm përdorimi, ku shumica e tyre janë për veprimtari turistike (sipas aneksit nr. 2/1 bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit).

Parcelat e dhëna në përdorim nga fondi pyjor janë pjesë e listës së pronave të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Librazhd, por këto kontrata janë lidhur në kushtet e mos plotësimit të plotë të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm. Kontratat nuk janë të shoqëruara me certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë dhe hartën treguese e cila duhet të lëshohet nga ASHK Librazhd. Gjithashtu në dosjen e praktikës së lidhjes së kontratave mungon plani i rievimit, i cili duhet të bëhet nga një topograf i licencuar dhe në të përcaktohen të dhënat e pronës, vendndodhja dhe kufijtë e saj, të cilët janë elementë të rëndësishëm në lidhjen e një kontrate. Në dosje bashkëlidhur gjendet vetëm kontrata dhe një kopje harte nxjerr nga ASIG, e cila nuk përbën element kryesor në legjitimimin e pronës/asetit objekt qiraje.

Konstatohet se në të gjitha kontratat e lidhura, për sipërfaqen e rrugë kalimit nga rruga kryesore deri në sipërfaqen e marrë me qira, e cila është pjesë e fondit pyjësor/kullor kombëtar në shërbim të qiramarrësit, nga Bashkia Librazhd nuk janë llogaritur detyrime si servitut kalimi për qiramarrësin, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhet. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 31-47 të raportit përfundimtar të auditimit*).

13.1. Rekomandim: Bashkia Librazhd të ndërpresë praktikën e lidhjes së kontratave për dhënie me qira të fondit pyjor/kullor, në rastet kur nuk plotësohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm ligjor për këtë qëllim.

13.2. Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masa që në lidhjen e kontratave për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor, së bashku me sipërfaqen e dhënë me qira, të tarifohet edhe servituti e kalimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Asetet e dhëna me qira, të jenë të pajisura me certifikatën e pronësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

A.1. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

14. Gjetje nga auditimi: Bashkia Librazhd është audituar nga KLSH në vitin 2022 dhe në përfundim të procesit të auditimit, me shkresën nr. 512/8 Prot, datë 19.09.2022 është dërguar raportit përfundimtar i auditimit si dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes. Rekomandimet e dhëna nga KLSH, si dhe statusi i zbatimit të tyre nga Bashkia Librazhd është si vijon:

a. Janë lënë tetë rekomandime për “*Masa Organizative*”, të cilët janë pranuar nga subjekti, dy rekomandime janë zbatuar, tre janë në proces zbatimi dhe tre nuk janë zbatuar;

b. Janë lënë tre rekomandime për “*Masa për shpërblim dëmi*”, në vlerën totale 1,204,469 lekë (për tre operatorë ekonomik), të cilët janë pranuar nga subjekti, por nuk ka vlera të arkëtuara nga Bashkia Librazhd. Prej tyre, një rekomandim është zbatuar pjesërisht, pasi nga Bashkia Librazhd BOE “K” SHPK & “L” & “K”, është njoftuar me shkresën nr. 4586 prot., datë 13.10.2022 për ekzekutimin vullnetar të detyrimit 976,500 lekë. Ndërsa dy rekomandime në vlerën 227,969 lekë rezultojnë të pa zbatuara.

c. Janë lënë gjashtë rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe përdorimin e tyre me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet (të ardhura të munguara), prej të cilëve një është i pazbatuar dhe dy rekomandime janë në proces zbatimi.

ç. Janë rekomanduar tetë masa disiplinore të cilat janë pranuar nga subjekti, dy prej të cilave janë pa zbatuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 119-127 të raportit përfundimtar të auditimit*).

14.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 4193 Prot, datë 10.10.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre. Të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përsheptuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si vijon:

Menjëherë

A. Masa organizative

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Librazhd në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në zbatim të procedurave për rekrutimin e punonjësve, të marrin masa për plotësimin me 3 punonjës të Njesisë së AB, siç është miratuar dhe në strukturën organizative të bashkisë.

Në vijimësi

1.2. Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm të kryejë një planifikim të auditimeve duke marrë në konsideratë frekuencën e kryerjes të auditimeve, të realizojë auditime në fusha me risk të lartë dhe të thelluara, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Në vijimësi

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Librazhd të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrimin në ASHK Drejtoria Elbasan dhe nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim paisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Librazhd të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrimin në ASHK Drejtoria Elbasan dhe nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim paisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. Masa për shpërblim dëmi

(Në vijim janë 3 rekomandime, prej të cilave 2 të pa zbatuara dhe 1 i zbatuar pjesërisht nga Bashkia Librazhd, të cilët kërkohen për zbatim):

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, date 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21- 33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,204,469 lekë pa TVSh**, si më poshtë:

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **976,500 lekë pa TVSH** nga bashkimi i OE "K" SHPK & "L" & "K" shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.469 prot datë 20.10.2020, me objekt "Rikonstruksioni i kanalit vaditës të Mesit, Gizavesh, Dorëz", Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **126,560 lekë pa tvsh** nga BOE "M" SHPK & "Sh" SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.2106 prot datë 08.04.2021, me objekt "Ndërtim miniparku i qytetit pranë Argjinaturës së Lumit Shkumbin"(Faza II dhe faza III), Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësive vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1 Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **101,409 lekë**, si rezultat i keq llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhurat e munguara.

(Në vijim është 1 rekomandim i pa zbatuar nga Bashkia Librazhd, i cili ri kërkohen për zbatim):

1.Rekomandimi:Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën **85,373,491 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. Masa disiplinore

C/II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me kontratë pune:

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar për kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjësit në lidhje me këto shkelje, ", **i rekomandohet Kryetarit të Bashkisë Librazhd** që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve

të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga puna**”, për:

1.S .A me detyrë Juriste në Sektorin e Prokurimeve,

2.J.B me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Planifikimit e Zhvillimit të Territorit,

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullari i AK për zhvillimin e një procedure tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*”, neni 3, “*Parimet e përzgjedhjeje*”, nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 “*Autoriteti ose enti kontraktor*”, neni 98, “*Anulimi i një procedure*”, neni 76, “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, neni 92, “*Shqyrtimi i ofertave*”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i 157 ndryshuar, neni 82, “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, neni 83, “*Njoftimi i fituesit*”.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,529,055 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik sipas kontratës “Ndërtim i ujësjellësit të Fshatit Polis Gostimë, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd”, u konstatua se sipas zërit I.1.1 “Gërmim dheu me ekskavator me goma 0.25 m³, me gjerësi 2 m, tokë e zakonshme me shkarkim në mjet”, në preventiv është parashikuar sasia 1,238 m³. Bazuar në librin e masave dhe situacionin përfundimtar, kjo sasi paraqitet e realizuar në masën 9,996 m³. Në procesverbalin e ndryshimit të volumeve të datës 11.04.2022, përcaktohet: Për zërin I.1.1 “Gërmim dheu me ekskavator me goma 0.25 m³, me gjerësi 2 m, tokë e zakonshme me shkarkim në mjet”, ishte parashikuar sasia 1,238 m³, ndërsa nga matjet që janë bërë në fakt janë 9,996 m³, pra 8,758 m³ më shumë. Kjo diferencë vjen për faktin se në projektin fillestar, duke parë dhe profilet tërthorë nuk ishin parashikuar hapje traseje rruge për linjën e tubave të transmetimit, kështu që është parë i nevojshëm ndryshimi.

Në librezë masash sipas zërit “Hapje traseje për kalimin e tubit të çelikut”, është përcaktuar sasia për zonën 2, në sasinë 6030.5 m³, zonën 3, në sasinë 2,654 m³ dhe zonën 4, në sasinë 648.3 m³.

Procesi i punimit hapje trase rruge, nuk përfshihet në punimet e gërmimit në kanal, por gërmime në seksion të lirë. Po ashtu, bazuar në volumet e përshkruara, sasia e materialit të gërmuar nuk është transportuar, duke mos argumentuar hedhjen e materialit në mjet (përrjashtuar zonën 3). Gjerësia e seksioneve të gërmimit është raportuar për seksione mbi 2 m. Bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, ky zë punimi duhet të referohej sipas analizës 3.87/b “Gërmim dheu me ekskavator me goma 0.25 m³, në kanale me gjerësi mbi 2

m, tokë e zakonshme kat. III, me shkarkim në tokë”, zë i cili ka çmim 282 lekë/m³. Çmimi sipas preventivit dhe situacionit përfundimtar është 360 lekë/m³. Si pasojë e referencës së gabuar të çmimit, nga ana e Kontraktorit BOE “M dhe Sh” SHPK, është përfituar më tepër **vlera 572,676 lekë** [(360 lekë/m³ – 282 lekë/m³) x 7342 m³], vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik.

Nga verifikimi sipas zërave III.3.5, V.2.5 dhe VI.3.5 “Rrethim me zgarë metalike të galvanizuar...”, u konstatua se materiali i përdorur nuk është zgarë metalike e galvanizuar, por rrjetë teli dhe rrjetë gabion. Punimet konsistojnë në rrethimin e depos së ujit dhe 2 kaptazheve, në sasinë 271 m² (162 + 58 + 51). Vlera (271 m² x 4,500 lekë/m²). Duke zbritur çmimin e tubave për m² (afërsisht) 4 kg, me çmim 98 lekë/kg, me vlerë 392 lekë/m² (970 kg x 98 lekë/kg), si dhe rrjetë teli e galvanizuar me çmim 1,306 lekë/m², konstatohet se nga çmimi i certifikuar 4,500 lekë/m², duhet të likuidohej me çmim 2,802 lekë (4,500 – 392 – 1,306). Vlera 460,158 lekë [271 m² x (4,500 lekë/m² – 2,802 lekë/m²)], i është certifikuar padrejtësisht kontraktorit BOE “M dhe Sh” SHPK dhe përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4, faqe 108-113 të raportit përfundimtar të auditimit).

1.1. Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat për zbritjen e vlerës **1,032,834 lekë**, nga garancia e punimeve kontraktorit **BOE “M dhe Sh” SHPK**, për punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike, si dhe referencë e gabuar e çmimit për një zë punimi.

Brenda periudhës së garancisë së punimeve

2. Gjetje nga auditimi: Sipas kontratës “Ndërtim i Parkut Qendror, Bashkia Librazhd”, janë konstatuar mangësi si më poshtë:

- Nga verifikimi në objekt rezulton se sipas zërit 14.15 “F.V puseta plastike 40 x 40 x 40 cm, kapak të fortë RC 1084+1086”, me çmim preventivi 3,200 lekë/copë, rezulton se pusetat janë furnizuar dhe vendosur me dimensione 30 x 30 x 30 cm.

- Nga verifikimi sipas zërit 6.d.5 “F.V pemë dekorative Bli 16-18 cm”, rezulton se janë vendosur pemë me diametër 5 cm. Çmimi i preventivit dhe situacionit përfundimtar për këtë zë është 15,400 lekë/copë. Në kushtet e mos plotësimit të specifikimeve teknike, referenca e çmimit duhet të merrej bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, zëri 3. An164 “F.V fidanë pemë dekorative”, ku paraqitet çmimi 10,704 lekë/copë. **Vlera 98,616 lekë** [21 copë (15,400 lekë/copë – 10,704 lekë/copë)], është certifikuar më tepër kontraktorit BOE “E SHPK dhe L SHPK”, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.

- Nga verifikimi sipas zërave 2.d.3, 6. d.3, 13.c.3 “F.V S.” u konstatua se janë vendosur 17 copë, ndërsa janë certifikuar 23 copë. **Vlera 144,000 lekë** (6 copë x 24,000 lekë/copë), i është certifikuar më tepër Kontraktorit BOE “E” SHPK dhe “L” SHPK” dhe përbën dëm ekonomik.

- Nga verifikimi sipas zërave 4.b.5, 6.b.5, 7.d.6 dhe 8.b.5 “Rrafshim betoni me kuarc me ngjyrë”, është certifikuar sasia 1259.6 m² (201 m² + 912 m² + 50 m² + 96.6 m²). Nga verifikimi në objekt, rezulton se është realizuar rrafshim me kuarc me ngjyrë vetëm sipas zërit 8.b.5 (punime për rrugicën qendrore), në sasinë 96.6 m². **Vlera 837,360 lekë** (1163 m² x 720 lekë/m²), është certifikuar më tepër kontraktorit BOE “E” SHPK dhe L SHPK” dhe përbën dëm ekonomik. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4, faqe 108-113 të raportit përfundimtar të auditimit).

2.1. Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masa për zbritjen e vlerës **1,079,976 lekë**, nga vlera e sigurimit të kontratës, kontraktorit BOE “E SHPK dhe L SHPK”, për punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike.

Brenda periudhës së garancisë së punimeve

3. Gjetje nga auditimi: Sipas kontratës “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse në Bashkinë Librazhd”, janë konstatuar mangësi si më poshtë:

Nga verifikimi i punimeve për realizimin e veshjes së kanalit me beton sipas zërit II.A.1. Struktura monolite betoni C 16/20 për kanale” nga piketa 0+000 deri 1+260 rezulton se skarpatat e kanalit janë realizuar me gjatësi mesatare 65 cm, ndërkohë që në librin e masave kjo gjatësi përcaktohet gjatësia 73 cm. Sipërfaqja e seksionit tërthor të llogaritur është 0.296 m², ndërkohë që nga korrektimi rezulton 0.272 m², me një diferencë 30 m³ [(0.296 m² -0.272 m²) x 1260 ml] beton, si dhe zhavorr. **Vlera 330,300 lekë** (30 m³ x 11,010 lekë/m³) i është certifikuar më tepër kontraktorit “A” SHPK, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.

-Sipas zërit “Shtresë zhavorr lumi t=10 cm”, është certifikuar më shuma sasia 201 m² (0.16 m x 1260 m), me **vlerë 56,682 lekë** (201 m² x 282 lekë/m²), vlerë e cila përbën dëm ekonomik.

- Sipas zërit “gërmim dheu” është certifikuar më shumë sasia 41 m³ (201 m² x 0.2 m), me vlerë **29,263 lekë** (41 m³ x 723 lekë/m³), vlerë e cila përbën dëm ekonomik. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4, faqe 108-113 të raportit përfundimtar të auditimit).

3.1. Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masa për zbritjen e vlerës **416,245 lekë**, nga vlera e sigurimit të kontratës Kontraktorit “A” SHPK, për punime të certifikuar, por të pa realizuara në sasinë e raportuar.

Brenda periudhës së garancisë së punimeve

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se më datën 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore progresive për periudhën 2011-2022, janë krijuar debitorë në vlerën **96,164,783 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e planifikuar, por e pa arkëtuar nga Bashkia Librazhd. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 27,208,335 lekë nga 74 subjekte debitor të biznesit të madh, detyrimi prej 15,809,650 lekë nga 303 subjekte debitor të biznesit të vogël, detyrimi prej 3,924,422 lekë nga 96 ndërtesa social ekonomike, detyrimi prej 10,260,919 lekë nga 283 raste për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara, detyrimi prej 38,961,457 lekë nga taksapaguesit familjar.

Vetëm për vitin 2022, vlera e detyrimeve të pa arkëtuar për taksat dhe tarifave vendore është 29,754,569 lekë, ose 31% e totalit të detyrimeve progresive. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 18,646,196 lekë nga 46 subjekte debitor të biznesit të madh, detyrimi prej 3,594,774 lekë, nga 175 subjekte debitor të biznesit të vogël, detyrimi prej 1,948,955 lekë nga 92 ndërtesa social ekonomike, detyrimi prej 2,011,853 lekë nga 49 raste për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara, detyrimi prej 3,552,791 lekë nga taksapaguesit familjar. Ndaj subjekteve debitorë për asnjë rast nuk është zbatuar pika 2 e nenit 89, e ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave nuk është kërkuar kallëzim penal ndaj subjekteve problematike debitorë ndër vite dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet

e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 3-47 të raportit përfundimtar të auditimit).*

1.1. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjek të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën 96,164,783 lekë, nga debitorët e privat dhe familjar.

Deri më 31.12.2023

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se nga Drejtoria e Pyjeve janë lidhur 68 kontrata për dhënie me qira, për shfrytëzim të fondit pyjorë, 13 prej të cilave nuk kanë paguar në mënyrë të plotë detyrimet kontraktuale në vlerën totale prej **2,983,140 lekë**, e cila konsiderohet **e ardhur e planifikuar, por e pa arkëtuar nga Bashkia Librazhd**, sipas të dhënave në aneksin nr. 2, bashkëlidhur raportit të auditimit.

Veprimet e mësipërme për mos pagesën e vlerës së qirasë, janë në kundërshtim me detyrimet kontraktuale midis Bashkisë Librazhd dhe qiramarrësve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 3-47 të raportit përfundimtar të auditimit).*

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Librazhd dhe Drejtoria e të Ardhurave, të marrin masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga 13 subjektet debitor, sipas të dhënave në aneksin nr. 2, bashkëlidhur raportit të auditimit, të vlerës së qirasë prej 2,983,140 lekë, si rezultat i mos pagesave të plota të detyrimeve kontraktuale në kontratat për dhënie me qira për shfrytëzim të fondit pyjor.

Deri më 31.10.2023

3. Gjetje nga auditimi: a. Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në një rast, për subjektin L.H, metodologjia e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është e saktë, duke sjellë që vlera e kësaj takse të llogaritet më pak nga vlera e duhur, në shumën prej **1,635,518 lekë**, vlerë e cila konsiderohet **e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Librazhd**.

Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të ishte llogaritur 2,950,068 lekë, por në fakt është llogaritur 1,286,014 lekë nga Bashkia Librazhd, sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues.

Në llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë është përdorur metoda e gabuar e llogaritjes mbi bazë preventivi, në kundërshtim me nenin 9, pika 2 të ligjit nr. 95/2018, pasi llogaritja bëhet mbi bazën e çmimit të shitjes, e cila në paketën fiskale për vitin 2023 është 6% për ambientet e dedikuara për biznes. Sipërfaqet e objektit llogariten njëkohësisht me koeficientin e përcaktuar në VKM nr. 168, datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018 të Këshillit të Ministrave për të nxjerrë vlerën përfundimtare të taksës që duhet të paguajë zhvilluesi.

b. Në paketën fiskale të Bashkisë Librazhd, në pikën 5.1 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, nënndarja 5.1.4, përcakton se taksa për ndërtimet për qëllime apo njësi shërbimi është 6% e çmimit të shitjes/m²... Në këtë përcaktim, mungon përlllogaritja që duhet bërë në rastet kur ndërtimet e reja janë edhe për qëllime banimi që kryhen nga shoqëritë e ndërtimit, duke rritur mundësinë e interpretimit të gabuar në rast të kërkesave për leje për objektet e kësaj tipologjie, veprime jo në përputhje me nenin 9, pika 2 e ligjit 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 9632, datë 30.06.2006 “Për sistemin e taksave vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 113-115 të raportit përfundimtar të auditimit).*

3.1. Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, personit të ngarkuar për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, për objektet e reja që kanë tipologjinë e mësipërme, taksa të përlllogaritet bazuar në çmimin e shitjes. Në paketën fiskale të përcaktohet qartë taksa e ndikimit në infrastrukturë, ku krahas ndërtimeve për qëllime apo njësi shërbimi, të shtohet edhe për qëllime banimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej **1,635,518 lekë** ndaj subjektit L.H, për llogaritje të gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Librazhd.

Deri më 31.10.2023

E. MASA ADMINISTRATIVE

- Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Librazhd, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara nga:**

- **Shoqëria “N.S”** me përfaqësues ligjor z. E.N, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektet “Ndërtim i ujësjellësit të Fshatit Polis Gostimë, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd”, “Ndërtim i Parkut Qendror, Bashkia Librazhd, faza e parë” dhe “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse në Bashkinë Librazhd”.

Në mënyrë të përmbledhur mangësitë paraqiten si më poshtë:

- Nga auditimi i dokumentacionit teknik sipas kontratës “Ndërtim i ujësjellësit të Fshatit Polis Gostimë, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd”, u konstatua se për një zë të ri punimi është bërë referencë e gabuar e çmimit, veprim nga i cili, nga ana e kontraktorit është përfituar më tepër vlera 572,676 lekë. Nga verifikimi sipas zërave III.3.5, V.2.5 dhe VI.3.5 “Rrethim me zgarë metalike të galvanizuar...”, u konstatua se materiali i përdorur nuk është zgarë metalike e galvanizuar, pro rrjetë teli dhe rrjetë gabion. Nga llogaritjet rezulton përfitim i padrejtë nga ana e kontraktorit me vlerë 460,158 lekë.

- Nga verifikimi i punimeve sipas kontratës “Ndërtim i Parkut Qendror, Bashkia Librazhd”, janë konstatuar mangësi në lidhje me zërin “F.V puseta plastike 40 x 40 x 40 cm, kapak të fortë RC 1084+1086”, të cilat nuk janë vendosur me dimensionet e parashikuara.

Pemët e mbjella nuk kanë diametrin e parashikuar, diferenca e çmimit të pemëve të vendosura me ato të përcaktuara në manualët e çmimeve të punimeve të ndërtimit me vlerë 98,616 lekë është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori. Nuk janë vendosur 6 stola me vlerën 144,000 lekë, si dhe zërat 4.b.5, 6.b.5, 7.d.6 dhe 8.b.5 “Rrafshim betoni me kuarc me ngjyrë”, sasia 1163 m² nuk është realizuar sipas specifikimeve, me pasojë përfitim të padrejtë të kontraktorit me vlera 837,360 lekë.

- Sipas kontratës “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse në Bashkinë Librazhd”, kanali nuk është ndërtuar sipas dimensioneve të paraqitura në librezë masash dhe situacion përfundimtar, për zërat “Struktura monolite betoni C 16/20 për kanale”, “Shtresë zhavorr lumi t=10 cm” dhe “Gërmim dheu”, duke shkaktuar përfitim të padrejtë nga ana e kontraktorit me vlerë 416,245 lekë.

Veprime në kundërshtim me:

-Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.

VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4, faqe 114-118, të raportit përfundimtar të auditimit).

F. MASA DISIPLINORE

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; nenin 64 shkronjën g të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; neni 11, kreun IV dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Librazhd, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore (**në proporcion me shkeljen e kryer**), për punonjësit të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi në raportin përfundimtar të auditimit.

G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, Bashkia Librazhd pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Në zbatim të nenit 15, shkronja (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra nga ana Juaj, të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe, për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkesë. Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi, duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe nisjen e procedurave disiplinore e administrative, apo hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e demit dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit **brenda 6 muajve** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve.